

# DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 406 • SHTATOR 2024



“NË FENË E TË PARËVE”

SHKOLLA, VENDI KU MUND TË  
JETËSOHET URDHRI I PARË HYJNOR

MUHAMEDI A.S. DHE  
ABSURDITETI I “KURANISTËVE”

# Pjesë nga Mevludi Sherifi

Emine emnin e ka nëna e Mustafasë  
Abdullahun shejti babë e ka pasë

Kur Muhamedi u afrua për me ardhë  
Shumë alamete u bëjshin pak pa ardhë

Atij mueji që leu shejti i thonë Rebi  
Dymbëdhjetën natë prej atij muaji n'Arebi

Ajo natë që leu shejti ishtë e hënë  
Dëgjo për at' natë çudë alamete u bënë

Tha Eminja pashë at' natë çudi një dritë  
Sikur dielli për dritare kur rrezitë

Si vetim shpejt duel prej shpije çudë u bë  
Gjithë dynjaja me këtë nur që dritë u bë

Prej Medine n'Shami sherif gjithçka ka  
Pash tanë shehret dhe katundet gjithë sa ka

Dhe tha n'hava ishte shtrua një dyshek  
Emnin sundus shtrues' i tij ishte melek

Dhe i pash tha tri bajraqe ishin zbritë  
Një mbi Qabe një n'mashrik dhe një n'magrib

Mirë e dita se po vjen hajri'njerëzisë  
Merr prej dore sundin e gjithë batilisë.

### EDITORIAL

- 4 “(Ai) më dërgoi mua si mësues e lehtësues”

### AKTUALITET

- 5 Postenverizmi, serbizmi dhe neokolonializmi në kryqëzatë kundër shqiptarisë  
Milazim Krasniqi
- 9 “Në fenë e të parëve”  
Hajrudin S. Muja
- 13 Shqiptarët dhe konvertimet fetare  
Xhafer Sadiku



### FETARE

- 18 Muhamedi a.s. dhe absurditeti i kuranistëve  
Dr. Muhamed Stublla
- 22 Roli i Mevludit në ruajtjen e vlerave tona fetare e kombëtare  
Resul ef. Rexhepi
- 26 Vështrim në një ngjarje, që nxit rivlerësimin e leximit të jetës së Pejgamberit a.s.  
Muhamed Sytari
- 28 Mrekullia juridike e legjislacionit islam (2)  
Dr. Ejup Haziri
- 32 Shkolla, vendi ku mund të jetësohet urdhri i parë hyjnor  
Mr. Sead Paqarizi
- 36 Familja ideale në këndvështrimin kuranor  
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi



- 40 Deizmi, besim apo arsytim?  
Mr. Adnan Shala
- 44 Obskurantizmi social dhe alegoria e shpellës  
Granit Sadiku
- 49 Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (6)  
Hazir D. Selmani



### FAMILJE & EDUKIM

- 52 Këshilla në lidhje me sfidat e edukimit të fëmijëve  
MSc. Zamira Bushati
- 56 Reciprociteti, kusht për ruajtjen e familjes  
Mr. Artan Musliu


### KULTURË

- 59 Në kujtim të 40-vjetorit të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe  
Akad. Feti Mehdiu
- 61 Kadare, një “Ismail”, kurban i komunizmit  
Nada Dosti



### AKTIVITETE

- 64 Myftiu Tërnavë priti në takim anëtarin e Asamblesë të shtetit të Nju Jorkut, z. Charles D Fall



#### DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore  
Nr. 406 • viti 38 • Shtator 2024  
• Sefer / Rebiul-Evvel 1446  
• çmimi 1 €

#### Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,  
Prishtinë

#### Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi  
Anëtarë:  
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,  
Mr. Muharrem Tërnavë,  
Mr. Vedat Shabani.  
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri  
Redaktor artistik & teknik:  
Bashkim Mehani

#### Adresa

“Dituria Islame”,  
rr. “Bajram Kelmendi” nr. 182,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +384 38 224 024  
E-mail: redaksia@dituriaislame.net  
www.dituriaislame.net  
Shtypi:  
“IliriPrint”, Prishtinë



*“Ai është që arabëve të pashkolluar-analfabetë ua dërgoi një peygamber nga mesi i tyre, që ua ka lexuar ajetet e Kuranit dhe i ka pastruar (nga gjendjet e gabuara), ua ka mësuar Librin (Kuranin) dhe urtinë (dijeninë e thellë), meqë, ata më parë, në të vërtetë, kanë qenë në humbje të plotë.” (El Xhumuah, 2)*

## “(Ai) më dërgoi mua si mësues e lehtësues”

Në rolin e tij prej një të dërguari, Muhamedi a.s., mbetet njeriu që bëri ndryshimet më të thella në rrjedhat e historisë. I lindur në një shoqëri injorante (xhahilije), e cila pos lajthitjes nga besimi i drejtë e shthurjes së skajshme morale, vuante edhe nga jetesa në një errësirë e privim diturie, që realisht kishte pllakosur çdo cep të saj. Të imagjinosh mundësinë e ndryshimit dhe të guxosh të mendosh për reformim të saj, në sytë e të gjithë vrojtuesve dukej si një iluzion që s’do bëhej kurrë realitet. Megjithatë, aty lindi një njeri, që guxoi e shpresoi dhe ndryshoi çdo gjë.

Mu në atë shoqëri të pashpresë, Vullneti Hyjnor, përcaktoi të dërgonte Muhamedin, paqja dhe shpëtimi i Zotit qofshin mbi të, si mësues i së mirës dhe udhërrëfyes jetësor. Për ta përshkruar rrethin e tij ku u dërgua dhe misionin e tij në të njëjtën kohë, Allahu tha: *“Ai është që arabëve të pashkolluar-analfabetë ua dërgoi një peygamber nga mesi i tyre, që ua ka lexuar ajetet e Kuranit dhe i ka pastruar (nga gjendjet e gabuara), ua ka mësuar Librin (Kuranin) dhe urtinë (dijeninë e thellë), meqë, ata më parë, në të vërtetë, kanë qenë në humbje të plotë.”* (El Xhumuah, 2).

Në kontekst të komentimit të këtij ajeti, Xhafer ibën Ebi Talibi, si më së miri rrëfeu për diferencën që krijoi ardhja e Muhamedit a.s. në mesin e arabëve. Ai këtë gjë e bëri në prezencën e mbretit etiopas Negus-it (Nexhashiut). Xhaferi r.a. tha: *“O mbret i nderuar! Ne kemi qenë një popull injorant. Adhuronim idhujt, hanim cofëtinat, vepronim vepra amorale, kishim ndërprerë lidhjet tona fafaisnore dhe kishim fqinjësi të prishur. I forti nga ne e gllabëronte të dobëtin. Ne ishim në këtë gjendje gjersa Allahu nuk na e dërgoi te ne një të dërguar nga mesi ynë. E njohim prejardhjen, sinqeritetin, besnikërinë dhe ndershmërinë e tij. Ai na ftoi që ta adhuronim vetëm Allahun, e të hiqnim dorë ne e prindërit tanë nga adhurimi i kujtdo tjetër pos Tij. Na urdhëroi me sinqeritet gjatë të folurit, ruajtje të amanetit, mbajtje të lidhjeve fafaisnore, fqinjësi të mirë dhe të shmangemi nga ndalesat dhe derdhja e gjakut...”*

Ky përshkrim i mahnitshëm e detajues për misionin dhe ndryshimet që solli Muhamedi a.s. në shoqërinë e tij të lajthitur, mbetet njëra prej shumë dëshmime të pashlyeshme historike se ai, me një mision prej mësuesi, gravoji në mendësinë njerëzore vlerat më sublimë nëpërmes misionit të tij prej mësuesi. Mësues, në kuptimin më të thellë e më të plotë të fjalës, ngase i frymëzuar nga Zoti i tij, ai ua tregonte rrugën e drejtë dhe i motivonte për të ndjekur atë, ndërsa në anën tjetër ua tërhiqte vërejtjen nga veset e shëmtuar dhe iu dëftonte për rreziqet e ecjes në rrugën e gabuar në jetë.

Ai thoshte për veten e tij me burrje: *“Allahu nuk më dërgoi mua si stërngarkues e vështirësues, por më dërgoi mësues e lehtësues.”* (Sahihu i Muslimit, 1806). Secili cilësim në këtë thënie profetike, vë në spikamë parimet e palëkundura të misionit të shenjtë të mësuesit. Kushdo që dëshiron të korrë sukses në këtë mision të dëlirë, duhet që të synojë lehtësimin e jetesës së njerëzve e jo stërngarkimin. Ai duhet të derdhë mundin e tij në drejtim të nxitjes e motivimit për të mësuar, mbështetjes së zhvillimit të brezit të ri, aftësimin për jetë dhe përgatitjes së tyre për të ardhmen e tyre.

Muhamedi a.s. lindi më 12 rebiul evvel, për të mbetur lindja e tij si pikë kthese në orientimin e njerëzimit mbarë. Lindi ai njeri, që pas moshës së tij 40 vjeçare do të fillonte detyrën madhore në tokë. Ai, po ua mësonte çdo njeriut të brezit të tij dhe atyre që vijnë më pas, gjer n’Amshim se *“ai – njeriu është epiqendra e universit për të cilin Krijuesi Suprem i ka nënshtruar të gjitha dukuritë dhe potencialet kozmike.”* (Seid I. Ali).

Andaj në këtë fillim shtatori, kur shkollat tona kthejnë dinamikën e mësimdhënies e mësimnxënies, këtij fenomeni iluzues e dëlirësues, e rikthejmë në vëmendjen e secilit mësues atë të dërguar që lindi për të mbetur model i çdo pedagogu deri në përjetësi.

*Mr. Driton Arifi*

# Postenverizmi, serbizmi dhe neokolonializmi në kryqëzatë kundër shqiptarisë

Milazim Krasniqi

Me gjithë përpjekjet abnormale që po mbëjnë islamofobët e çartur, rezultatit e kanë tërësisht dëshpërues për ta. Islami ka rrënjë të thella në identitetin tonë kombëtar dhe ato rrënjë nuk mund t'i shkulë askush. Shqiptarinë (term i Sami Frashërit) nuk mund ta mposhtin armiqtë e saj edhe kur bëhen të gjithë bashkë.

Urrejta e disa grupeve islamofobe ndaj fesë islame ndër shqiptarë e ka burimin te tri burime ideologjike: te deformimi mendor e besimor që ka lënë prapa enverizmi (stalinizmi), te strategjia e Serbisë për t'i çrrënjosë shqiptarët me etiketat e “rrezikut islamik për Evropën kristiane” dhe te platformat neokolonialiste të disa qarqeve klero-fashiste në Perëndim. Brenda këtij trekëndëshi famëkeq është edhe fushata më e re kundër fesë islame në Kosovë.

## INICIATIVA NË THELB ËSHTË POSTENVERISTE DHE ANTIEVROPIANE

Kjo iniciativa e tashme e atyre që u vetëquajtën jo rastësisht si “Grupi i Deçanit” (për të treguar afërsi shpirtërore me manas-

Iniciativa e tashme e atyre që u vetëquajtën jo rastësisht si “Grupi i Deçanit” (për të treguar afërsi shpirtërore me manastirin e Deçanit!) e ka njëfarë vazhdimësie me ato praktika enveriste, por me një ndryshim.

tirin e Deçanit!) e ka njëfarë vazhdimësie me ato praktika enveriste, por me një ndryshim: tash në rastin e Kosovës propagandohet dalja nga feja islame, në favor të krishterimit roman, e jo ndalimi i të gjitha besimeve fetare. Prejardhja ideologjike enveriste-staliniste e disa prej eksponentëve të atij grupi nuk është pa rëndësi për ta kuptuar motivin e tyre. Në esencë ata janë enveristë (më saktë postenveristë), njerëz pa etikë, pa respekt për diversitetin dhe vlerat kombëtare, pa orientim të qartë në kohë dhe në hapësirë, pa dituri elementare mbi besimet fetare dhe ndikimet e tyre në formimin e kombit shqiptar.

Absurditet më vete paraqet fakti se këta fanatikë të çartur, po kërkojnë krishterizimin e shqiptarëve të Kosovës, gjoja në emër të vlerave evropiane, kristiane. Ndërsa realiteti në Evropë është se ka së paku dy shekuj që vetë Evropa është sekulare. Rrymat e mëdha filozofike, kulturore, artistike e ideologjike si Iluminizmi, Romantizmi, Modernizmi, Liberalizmi, Posmodernizmi, Globalizmi, nuk kanë lidhje doktrinare me krishterimin. Në fakt janë opozicion e diskontinuitet me Krishterimin, kanë lindur si produkte të



shkëputjes nga dogma kristiane. I vetmi shtet kristian në Evropë është Vatikani. Pra, nëse këta stalinistë të fantaksur po duan të futen nën ombrellën e Vatikanit, kjo është një iniciativë kryqtare e jo vlerë e sotme evropiane. Evropa e sotme e ka pranuar bashkëjetesën paqësore të kombeve e besimeve fetare të ndryshme. Bile edhe Vatikani, në kohën e papa Gjon Palit II e ka pranuar Islamin si fe monoteiste dhe e ka proklamuar bashkëjetesën paqësore me Islamin. Prandaj këta kryqtarë të vonuar nuk kanë asnjë mbështetje në realitetin fetar, filozofik, shoqëror, kulturor, ideologjik të sotëm evropian (përveç të rrymat islamofobike e klero-fashiste). T'ia faturosh Evropës së sotme se ka projekt për krishterizimin e popujve, është fyerje për vlerat e tashme të qytetërimit të saj.

### **INICIATIVA NË THELB ËSHTË ANTIKOMBËTARE**

Ky grup injorant po kërkon largimin nga feja islame, gjoja edhe në emër të identitetit kombëtar, në emër të kombit shqiptar. Kjo gjë zbulon jo vetëm injorancën e paditurinë e tyre, po edhe pafytyrësinë e tyre të papërshkrueshme. Të gjitha faktet e njohura e të verifikuara në rrjedhë të shekujve XIX e XX, dëshmojnë se shqiptarët myslimanë, si shumica absolute e etnisë shqiptare, kanë luajtur rolin vendimtar në formimin e kombit tonë shqiptar. Ideologët kryesor të

**Hoxha Tahsini e Sami Frashëri ishin ideologët e kombformimit, Abdyl Frashëri e Ymer Prizrenit ishin krerët e Lidhjes së Prizrenit, Vehbi Dibra e Ismail Qemali ishin legjitimuesit e proklamuesit kryesorë të shtetit shqiptar. Pra, në themelet e kombformimit dhe të shteti shqiptar janë kontributet e personaliteteve që kanë qenë pjesëtarë të fesë islame.**

Rilindjes Kombëtare, organizatorët e Lidhjes së Prizrenit, themeluesit e shtetit shqiptar, bartësit e rezistencës irredentiste në Kosovë e në viset e tjera dhe deri te lufta çlirimtare në Kosovë (1999-1998) në Luginën e Preshevës (2000) e në Maqedoninë e Veriut (2001), kanë qenë shqiptarë të besimit islam. Natyrisht lëvizja kombëtare dhe ngjarjet kombëtare kanë qenë të përbashkëta, por shumica absolute kanë qenë të kësaj provenience, gjë që është e vetëkuptueshme. Thënë thjesht: pa kontributin vendimtar të shqiptarëve të besimit islam, kurrë nuk do të mund të formohej një komb shqiptar dhe as shtet shqiptar. Shqiptarët ortodoks, pa atë unitet brenda kombëtar me myslimanët e katolikët, do t'i ekspozoheshin zhdukjes fizike, ose asimilimit nga Greqia. Ndërsa shqiptarët katolikë do t'i ekspozoheshin zhdukjes, projektit asimilues malazez ose arratisë. Pra, aleanca e fortë brenda kombëtare mundësoi formimin e këtij kombi dhe formimin e shtetit shqiptar. Mjafton të lexohet libri i Natali Klejerit, "Në fillimet e nacionalizmit shqiptar", për ta kuptuar rolin e të gjitha grupeve fetare, që nga grupi më i vogël, protestantët shqiptarë, pastaj bektashinjtë, ortodoksët, katolikët e deri te roli vendimtar i myslimanëve suni. Historia nuk mund të ndryshohet, aq me pak mund të deformohet e ardhmja nga disa renegatë të ndytë, që nuk kanë asnjë respekt për vlerat e mirëfillta kombëtare. Për këta renegatë po e

kujtoj këtë shembull, (jo për të tjerët, sepse të tjerët e dinë): Hoxha Tahsini e Sami Frashëri ishin ideologët e kombformimit, Abdyl Frashëri e Ymer Prizrenit ishin krerët e Lidhjes së Prizrenit, Vehbi Dibra e Ismail Qemali ishin legjitimuesit e proklamuesit kryesorë të shtetit shqiptar. Pra, në themelet e kombformimit dhe të shteti shqiptar janë kontributet e personaliteteve që kanë qenë pjesëtarë të fesë islame. Duke qenë myslimanë, ata kanë qenë pa asnjë pengesë iluministë në idetë e kombformimit dhe modernistë në idetë e shtetndërtimit. Pyetja për këta injorantë të pa hair është: nëse ia hiqni kombit shqiptar e shtetit shqiptar themelet, ku do t'i kacavareni kombin e shtetin?! Në historinë e manastirit të Deçanit a?

### INICIATIVA NË THEMEL ËSHTË PROSERBE

Nëse këta kryqtarë të vonuar po vajtojnë për kombin shqiptar, çka nënkupton ndarja prej tyre e Kosovës nga Shqipëria, si laborator për eksperimente kryqtare? Pse nuk e kanë shtrirë iniciativën në të gjitha trojet shqiptare, po vetëm në Kosovë, ku pretendimet religjioze serbe janë me rrezikshmëri të lartë? Sikundër dihet, Serbia në pretendimet e saj të hershme e të sotme e ka si vulë etiketën e “rrezikut islamik” nga shqiptarët e Kosovës dhe mundohet ta paraqesë konfliktin për Kosovën si konflikt ndërmjet kryqit e gjysmëhënës. Dihet po ashtu se Serbia që nga Kongresi i Berlinit ia ka ngarkuar vetes si mision çrrënjosjen e myslimanëve nga Ballkani, shqiptarëve në rend të parë. Ata që nuk ka arrit t'i dëbojë, ka tentuar t'i konvertojë me dhunë në ortodoksi. Në rrokullimë e luftërave ballkanike është tentuar konvertimi i shqiptarëve në ortodoksinë serbe, me ç'rast nuk janë kursyer as katolikët shqiptarë të rajonit të Gjakovës, sigurisht nën frymën e Zakonikut të Car Dushanit, i cili katolikët i trajtonte si heretikë e jo të krishterë. Dihet gjithsesi se Savë Batarja dhe grupi terrorist i tij kanë mbetur në kujtesën shqiptare si kriminelët më të egër, për terrorin dhe dhunën që kanë zbatuar për konvertimin e dhunshëm të shqiptarëve në atë periudhë tragjike. Qoftë dhe vetëm për shkak të asaj traume të tmerrshme nga konvertimi me dhunë nga ana e malazezve e serbëve, iniciativa për

Kalimi masiv  
në Islam i  
shqiptarëve ka  
qenë saktësisht  
si ikje nga  
projektet  
asimiluese të  
Kishës  
Ortodokse,  
sidomos të  
asaj serbe, e  
cila e pati  
fituar  
autonominë  
në vitin 1219  
dhe e cila edhe  
me zakonikun  
e Car  
Dushanit e  
proklamoi  
serbizimin e të  
gjithë atyre që  
nuk ishin  
ortodoks,  
heretikëve dhe  
bogumilëve.

konvertim nuk do të duhej të niseshin kurrë në mesin e shqiptarëve. Por, me gjasë ka diçka edhe më të hidhur në këtë iniciativë, ky grup jo rastësisht e ka quajtur veten “Grupi i Deçanit”. Ka gjasë që kanë synuar ta ndërldhin kauzën e tyre me manastirin e Deçanit, i cili paraqet pikë të fortë për kauzën serbe kundër shqiptarëve të Kosovës. Manastiri i Deçanit edhe sot ka status të veçantë si monument fetar serb (mbrohet nga UNESCO, si monument fetar serb) dhe madje mbrohet edhe me armë të gjata nga KFOR-i. Ndërsa, njëri nga eksponentët më primitivë të “Grupit të Deçanit”, njëfarë Muhamet Shabani, (e ka bërë emrin Belisar!) me vite ka vluar si qulli se si gjoja manastiri i Deçanit është manastir shqiptar dhe se ai është pjesë e identitetit shqiptar. Përkundër që dihen faktet historike se kur e kush e ka ndërtuar manastirin e Deçanit, tipat e tillë të ndërkryer e kanë fiksim patologjik idenë që të thonë se është tempull fetar shqiptar. Nëse manastiri i Deçanit është manastir shqiptar, atëherë i bie që ai i bashkon shqiptarët e serbët në një vëllazëri fetare! Si duket kjo është mënyra e këtij grupi të çoroditur, për t'u afruar me Kishën Ortodokse Serbe. Thënë thjesht, e mbrojnë kauzën e përbashkët të mbrojtjes së krishterimit nga “dhunuesit” shqiptarë myslimanë. Ndërsa e vërteta e pakontestueshme është se nëse hiqet përkatësia islame e shumicë shqiptare nga ekuacioni, mbetet dominuese ortodoksia serbe, sepse numri i vogël i katolikëve nuk mund të jetë konkurruese me ta. Me kurrfarë iniciativash islamofobike për konvertim, numri i katolikëve nuk mund të rritet në mënyrë substanciale, që t'u konkurrojë serbëve për pronësi mbi Kosovën. Askush me mend në kokë nuk duhet të presë konvertim masiv të shqiptarëve myslimanë. Po ashtu historia e katolicizmit në Kosovë është modeste, sepse që nga ndarja e kishave në vitin 1054, këto hapësira kanë qenë nën administrimin fetar ortodoks, nga Bizanti, nga Bullgaria dhe nga Serbia mesjetare. Bile kalimi masiv në Islam i shqiptarëve ka qenë saktësisht si ikje nga projektet asimiluese të Kishës Ortodokse, sidomos të asaj serbe, e cila e pati fituar autonominë në vitin 1219 dhe e cila edhe me zakonikun e Car Dushanit e proklamoi serbizimin e të gjithë atyre që nuk ishin ortodoks, heretikëve dhe bogumilëve.



A e kanë parasysh kjo skotë kryqtarësh të vonuar këtë histori të rëndë? A e kanë parasysh se edhe sot etiketimet më të mëdha të Serbisë kundër Kosovës bëhen pikërisht në këtë linjë, pra duke e paraqitur Kosovën si “rrezik islamik për Evropën”? Edhe nëse motivet nuk i kanë plotësisht të njëjta me Serbinë, rezultati u del i njëjtë: denoncimi i shumicës absolute të shqiptarëve të Kosovë si të pabesë ndaj Evropës.

### INICIATIVA ËSHTË ANTIKULTURORE E EDHE ANTIFETARE

Nuk është aspak e qartë se ku po e shohin diskontinuitetin e shqiptarëve të Kosovës me Evropën këta mashtrues. Identiteti kombëtar dhe kultura kombëtare shqiptare në Kosovë është pjesë përbërëse e identitetit kombëtar dhe e kulturës kombëtare shqiptarë. Gjuha standarde shqipe është zyrtare në Kosovë si edhe në Shqipëri. Letërsia shqipe mësohet në tërë historinë dhe në të gjitha segmente dhe vlerave të saj. Bile mësohen si letërsi edhe autorë e vepra që nuk janë fare letërsi, që nga “Meshari” i Buzukut, “Doktrina kristiane” e Pjetër Budit, “Çeta e profetëve” e Bogdanit, pikërisht për ta mbajtur të fortë atë identitet kombëtar të përbashkët. Gjergj Kastrioti – Skënderbeu është figura qendrore në perceptimet kombëtare shqiptare edhe në Kosovë, me shtatoren monumentale mu në qendër të kryeqytetit të Kosovës. Katedralja “Nëna Terezë”, e ndërtuar pas çlirimit në qendër të Prishtinës, është bërë pjesë e identitetit metropolitan të shtetit tonë të ri. Asnjë subjekt fetar islam nuk është deklaruar kundër këtyre vlerave. Pra, pse imagjinohet problem i paqenë? Identiteti kombëtar shqiptar dhe kultura shqiptare vazhdon të mbetet unike, integrale me mundësi ende të pashfrytëzuara sa duhet që kombi shqiptar të shndërrohet në një komb edhe më të fuqishëm në hapësirat gjeokulturore e gjeopolitike atlantike.

Ajo që do të duhej të na shqetësonte të gjithë shqiptarëve (me gjasë kjo vërtet nuk vlen për “Grupin e Deçanit”) është rreziku nga presionet neokolonialiste, po edhe atyre globaliste mbi identitetin tonë kombëtar dhe mbi kulturën tonë kombëtare. Këto presione janë evidente sidomos në Kosovë, meqë Kosova ende është shtet i papërfunduar dhe ku pretendimet e Serbisë ende janë shumë kërcënuese. Pse ky grup nuk i kanë shqetësim tendencat e tilla, nëse e kanë preokupim kombin shqiptar? Nuk e kanë preokupim për një arsye të vetme: me konceptin e tyre ata vetë janë pjesë e atij projekti neokolonialist, i cili synon ta dobësojë shqiptarizmin në Kosovë, për ta arsyetuar rikthimin e ndikimit të Serbisë në Kosovë. Kjo është e qartë. Argatë të atij projekti janë. Pra, këta mercenarë janë vendosur në hapësirën ndërmjet projekteve religjioze serbe dhe projekteve neokolonialiste islamofobike të disa qarqeve të huaja klero-fashiste. Në shërbim të verbër të tyre. Thënë më së qarti: iniciativa e tyre është në shërbim të diversionit ndaj identitetit kombëtar shqiptar. Nuk ka motive mirëfilli fetare. Po t’i kishte motivet mirëfilli fetare, ata do të kryenin ato procedura të pagëzimit në mënyrë private, për veten e tyre e nuk do të tentonin t’i shndërronin në presion e terror psikologjik ndaj të tjerëve.

### FORMULA E PËRJETSHME

Me gjithë përpjekjet abonormale që po bëjnë islamofobët e çartur, rezultatin e kanë tërësisht dëshpërues për ta. Islami ka rrënjë të thella në identitetin tonë kombëtar dhe ato rrënjë nuk mund t’i shkulë askush. Shqiptarinë (term i Sami Frashërit) nuk mund ta mposhtin armiqtë e saj edhe kur bëhen të gjithë bashkë. Me këtë formulë që e aplikuan me sukses rilindësit tanë të mençëm, ajo është e përjetshme. Kushdo që tenton ta ndryshojë këtë formulë, bëhet armik i shqiptarësisë.



# “Në fenë e të parëve”

## KONTEKSTI HISTORIK I KONVERTIMIT TË SHQIPTARËVE

Hajrudin S. Muja

Teksa baza e identitetit shqiptar është kryesisht gjuha shqipe, e vetmja që bashkon të gjithë shqiptarët, një bazament mbi të cilën ata japin shembullin e bashkëjetesës me edukime të ndryshme fetare, feja është program i Krijuesit, që u mëson krijesave bazat e besimit dhe mënyrën e jetësimit të atij besimi, duke rregulluar raportet e njeriut me Krijuesin, me veten, me familjen, me shoqërinë dhe me kombën e tij. Çdo njeri që adhuron Krijuesin e tij, pavarësisht se cilit drejtim religjioz i takon, ka fe dhe çdo njeri që ka gjuhën, traditën, atdheun ka komb. Në kontekst, feja dhe kombi janë dy faqet e së njëjtës fletë dhe çdo përpjekje për t'i ndarë e për t'i vlerësuar mbi njëra-tjetrën është asgjë më pak se mungesë intelektuale.

Studiuesit më serioz e kanë përkufizuar kombën si një kredo, një shkollë dhe një pseudo religjion, të cilin Perëndimi e krijoi me qëllim që ta plotësojë vakumin ideologjik.<sup>1</sup> Te shqiptarët, është Islami ai që shërbeu si urë lidhëse midis dy pjesëve të së njëjtës etni, që të mos përfundonin në dy kombësi a kombe të ndryshme armiqësore, sikurse përfunduan për shembull kroatët katolikë me serbët ortodoksë; polakët katolikë dhe rusët ortodoksë dhe irlandezët katolikë me irlandezët protestantë.<sup>2</sup>

Sidoqoftë, përpjekjet e organizuara për të konvertuar shqiptarët myslimanë në krishterim, kanë qenë projekte që kanë shpënë ujë në mullirin e të huajve, por çuditërisht kanë pas hyzmeqarë edhe në mesin e vetë shqiptarëve. Mënyra e tyre e arsytimit për një ndërmarrje të tillë në emrin e patriotizmit të shpifur, bashkë me hapësirën që i jep konglomerati mediatik, është kulmi i absurdit, që dëshmon më së shumti se nuk ja kanë haberin rrjedhave historike dhe aq më pak vendit ku mund t'i shpjerë mushka. Kjo 'orgji' e

një grupi të caktuar 'intelektualësh', maksimalisht po përpiqet që "me fakte" të krishterizojë "kombëtarën", duke e mënjanuar islamit si 'fe te huaj'. Në këtë mënyrë, në emër të kombit, me metoda dinake, copëtohet kombi.

Ky është modeli sllav i krijimit të kombeve, ku feja është faktori kryesor i ndarjes. Kjo strategji antifetare dhe anti-kombëtare, është vetëm një "letër e djegur" e disa fanatikëve fundamentalistë e "pseudo shqiptar", të cilët, po që se nuk kursehen nga një rrugë e tillë fataliste, ekziston gjasa reale, që të vetëdigjen në flakën e saj. Sepse shqiptarët, siç i ka vërejtur edhe historiani G. Jaross, së paku deri sot: "shfaqin një komb të fortë, të vetëdijshëm e të gatshëm për të mbrojtur vatrat e tyre."<sup>3</sup>

Në rrjedhat historike janë përfolur dhe janë shënuar përpjekje të tilla, të cilat falë Zotit kanë dështuar, por fatkeqësisht jo pa pasoja. Disa studime përmendin tentativa të ngjashme në kohën e Skënderbeut, kur njerëzit që ishin islamizuar duhej të ktheheshin në fenë e krishterë, sipas mentalitetit, ku feja përcaktonte pasuesit e sulltanit, e këta duhej të dëboheshin tani nga viset arbërore (shqiptare). Kështu edhe në kohën e Pjetër Bogdanit, kur forcat e koalicionit korrën fitore ndaj osmanëve, ata filluan të vrisnin e të digjin vetë shqiptarët, që solli atë shprehjen për shumë kë të njohur: "Ne po i luftojmë turqit, e ju na vrisni si turq". Është e njohur bula "Romanus Pontifex" të cilën Papa Piu IV (16 shkurt 1564) dhe Klementi i VIII-të (1595) vendosën urdhrin për konvertimin e 80 fshatrave të Italisë Jugore, Kalabrisë dhe Sicilisë në rritin lindor (ortodoks) në rritin perëndimor (katolik).<sup>4</sup> Për t'i rezistuar, ata u detyruan të mërgonin prej një vendi në tjetrin, shpesh duke ua vënë

zjarrin të mbjellave të tyre, deri u konvertua shqiptari i fundit atje.

Më e tmerrshmja ishte “kryqëzata e shenjtë” për konvertimin e myslimanëve në ortodoksi gjatë luftërave ballkanike të viteve 1912-1913. Në Pejë ishte formuar një shoqatë e fshehtë e quajtur “Liga” e përbërë kryesisht nga zejtarë e tregtarë, e cila propagandonte me të madhe se feja e të parëve ishte feja ortodokse dhe se kisha e Pejës me atë të Deçanit ishin kishat e stërgjyshërve të tyre. Nëpër fshatra kishin dërguar mësues për ta bindur e detyruar popullatën shqiptare për ndërrimin e fesë.<sup>5</sup> Duke qenë se shoqata nuk pati sukses në misionin e caktuar, shpejt pushoi së ekzistuari, për t’u pasuar pastaj nga dekreti mbretëror i ‘gospodarit’ Nikolla Petroviq dhe autoriteteve ushtarake ‘çlirimtare’ malazeze, sipas së cilit e gjithë popullsia myslimane dhe një pakicë e popullsisë katolike që jetonte në krahinën e Plavë-Gucisë dhe viset e Kosovës detyrimisht duhej të ndërronin fenë dhe të kalonin në besimin ortodoks.

Dekreti hynte në fuqi më 15 mars 1913 dhe duhej të zbatohet brenda një afati dhjetëditor.<sup>6</sup> Filluan me vrasjen e më të mirëve, tetë ulema të njohur, shtatë haxhi (të pasur), dy profesorë, tridhjetë persona të parisë, pesëdhjetëdy burra – trima... dhe njëqind meshkuj të tjerë: “Tanë hafi ja janë çua n’kamë, Zoti i vraftë po nam po bajnë, ni burrë t’mirë kund nuk po e lanë.”<sup>7</sup> Kjo erdhi si pasojë e një ankese të një grupi plavjanësh, të cilët më 5 shkurt 1913 ia kishin dërguar Mbretërisë së atëhershme në lidhje me arrogancën dhe terrorin që ushtria e saj shkaktonte mbi myslimanët e kësaj krahine.<sup>8</sup>

### **PUSHKATIMET NË RACIN TË PLAVËS (VIZATIM)**

Në krye të këtij makabri qëndronin Avro Cemoviç dhe Milivoje Dragoviç, por një rol të rëndësishëm e pati edhe ish-hoxha i mëhershëm i Plavës, mulla Hajro Bajriqi (shpesh i hasur si Balshiq). Mustafa Memiç shkruan se vullnetarisht kishte pranuar konvertimin në ortodoksi dhe përmes korrupsionit dhe parave kishte fituar gradën e majorit, ishte bërë kryetar i gjykatës ushtarake dhe dënonte me vdekje myslimanët e Plavës e të Guçisë që refuzonin të konvertoheshin në ortodoksi. Aktiviteti shpejt u përhap edhe në Pejë e Gjakovë, ku i gjithë potenciali i propagandës politike ishte drejtuar drejt ‘konvertimit vullnetar’, se shqiptarët e mbetur gjallë po konvertoheshin “vullnetarisht” në ortodoksi. Një ushtarak deklaronte se kishte konvertuar në ortodoksë 12.000 myslimanë, ndërkaq



Pushkatimet në Racin të Plavës (vizatim)

pushteti policor e ushtarak i Serbisë më 1913, gënjente Evropën se “shqiptarët po shprehin dëshirë të kalojnë në fenë ortodokse” në fenë e të parëve të tyre.

Në lidhje me këtë ngjarje “Vesnik Srpske Crkve” (mars-prill 1913) kishte botuar letrën e një dëshmitari që shkruante se atë ditë “në Gjakovë ishte gazmend”, aty para kapitenisë ishte tubuar populli, i cili në të kaluarën ishin “katolicizuar dhe<sup>9</sup> shqiptarizuar”, kurse tani kishin ardhur për të kaluar në ortodoksi, për t’u kthyer në “tufën e vet”. Edith Durham e shpjegon më së miri këtë makabër: “Pagëzimet bëhen me tortura. Njerëzit hidhen në ujën e akullt të lumit e pastaj vihen e piqen pranë prushit të zjarrit, derisa kërkojnë mëshirë. Dhe, çmimi për gjithë këtë është kthimi në fenë e krishterë – ortodokse... Shumë nga këta që ishin pagëzuar në tmerr vinin tek unë.”<sup>10</sup>

U deshtë vrasja e priftit katolik patër Luigj Palaj, që të nxitë shtetet evropiane të reagojnë dhe të kërkojnë ndërprerjen e këtij “konvertimi vullnetarë”. Vetë mbreti Nikollë fillimisht u arsyetua se: “Sësstë e mundur të bëhen të gjitha këto nën qeverisjen time. Duhet të jetë që ju keni kërkuar të pagëzoheni me gjithë dëshirë.”<sup>11</sup> Por, kur u zu ngushtë prej fakteve të shumta që s’mund t’i mohonte, në mënyrë hipokrite e mbylli bisedën: “Këtë e bëri Avro (Cemoviç) krye në vete, ngase gjithmonë ishte nën turq.”<sup>12</sup>

Se sa ishin “vullnetarë” këto konvertime na tregon brigadieri Mashan Bozhoviç, që u vendos si përgjegjës ushtarak në fund të prillit 1913. Sipas tij, konvertimi në ortodoksi ishte bërë “për të shpëtuar kokën”, pasi qeveria lokale kishte ushtruar dhunë të

Konvertimi me dhunë shumë shpejt u përhap edhe në Pejë e Gjakovë, ku i gjithë potenciali i propagandës politike ishte drejtuar drejt ‘konvertimit vullnetar’, se shqiptarët e mbetur gjallë po konvertoheshin “vullnetarisht” në ortodoksi.



paparë mbi ta. Prej terrorit kishin qenë të shpëtuar vetëm ata njerëz që ishin paraqitur për konvertim ‘vullnetar’. Kështu, të shumtët që ishin konvertuar, posa u dha urdhër për lirinë e plotë të besimit, njerëzit vraponin në ndonjë lum, ku i fërkonin ato pjesë të trupit të cilat ua kishte prekë popi, aq shumë me rërë, derisa u dilte gjaku.<sup>13</sup> Prej aty shkonin në xhami, ku formonin rendet dhe faleshin, gjë që i tregonte Bozhoviqit më mirë se asgjë, se konvertimi kishte qenë i dhunshëm. Flitet se në një ndërmarrje të këtillë, në Guci, derisa prifti malazez po konvertonte myslimanët në ortodoksi, një plak ‘turk’ (mysliman), që po konvertohej “vullnetarisht”, ndoshta në pavetëdije se çfarë po e priste, i kishte thënë priftit: “Hajt shpejto pak zotni, se erdhi koha e namazit dhe dua të falem.”<sup>14</sup>

Në përkufizim, konvertimi i dhunshëm është adoptim i një religjioni, apo i një filozofie religjioze kundër dëshirës, shpeshherë nën kërcënime të torturës, vuajtjeve dhe të rrezikut për jetë.<sup>15</sup> Si fenomen historik fillon kur feja bëhet instrument i politikës, përkatësisht kur identifikohen institucionet fetare me shtetin, dhe përdoren metoda të konvertimit të dhunshëm, për ta nënshtruar e asimiluar plotësisht popullatën e atij vendi.<sup>16</sup>

Historiani Hasan Bello ka një shkrim me projekte të këtilla nga fundi i shekullit XIX, kur në krahinën e Shpatit dhe në Elbasan u paraqit një lëvizje e cila konsistonte në konvertimin e ortodoksëve nën varësinë e kishës katolike. Kjo lëvizje, krahas arsyeve fetare, kishte në thelb edhe “arsye kombëtare”, që qarqet shqiptare e arsyetonin me zvogëlimin e procesit helenizues në Shqipërinë e Jugut, kurse Stambolli e shihte në disfavor të influencës ruse. Ndërkohë politika italiane e shihte pozitive, pasi përpiquej të interferonte në strukturën religjioze të Shqipërisë së Jugut. Për të ruajtur ekuilibrat, shqiptarët përgatiten një projektligj, që kishte si qëllim të ruante unitetin kombëtar dhe të evitonte armiqësitë që mund të lindnin midis besimtarëve të komuniteteve të ndryshme fetare nga këto provokime. Projektligji nuk kishte asnjë qëllim për të

ushtruar presion mbi personat që konvertoheshin me dëshirë, synonte vetëm parandalimin e fushatës konvertuese të nxitur nga shtetet e huaja, në rastin konkret të Italisë.

Në prag të pushtimit fashist, në marrëveshjen sekrete ‘Ciano – Stojadinoviq’, që u bë në Romë në vitin 1937, u planifikua që Italia të konvertonte në krishterim Shqipërinë bregdetare më së largëti deri në vitin 1949. Për instruktorë ishin caktuar priftërinj malazez (serbë), të cilët kishin përvojë konvertimesh nga viti 1913. Me këtë rast ishte bërë dakordimi serbo-italian që fillimisht shqiptarët të ndiheshin si të krishterë unijatë. Në një dokument i kësaj natyre, na flet për zotërimin e italianëve për të përvetësuar Shqipërinë bregdetare, që pasi ta pushtonin: “fare pak kohë u duhet klerikëve italianë, që ta konvertojnë popullin shqiptar”. Dhe vërtet, më 1940 filluan përgatitjet në dy qendra, por u ndërprejnë për shkak të disa kundërthënieve me Hitlerin<sup>17</sup> dhe fillimin e Luftës së II-të Botërore.

Pas rënies së sistemit monist në Shqipëri, në fillim të viteve të 90-ta, që la pas gjeneratat e rritura me “shqiptari” e pa fe, doli një “analfabetizëm” fetar te shqiptarët, për t’ua dhënë mundësinë grupeve të huaja misionare, që t’ua mësonin “alfabetin e feve”, ashtu si u konvenonte atyre. Këtu mbi kombëtarën u vendos evropianizmi, për të arsyetuar bëmat në adresë së fesë së krishterë, kundër pjesës dominuese myslimane. Misionari i parë i kësaj teze doli shkrimtari i madh Ismail Kadare, i cili islamizimin e shqiptarëve e quante “incident” nga i cili “Shqipëria duhet të çlirohet sa më parë”, duke u kthyer “në fenë e të parëve”, pasi: “islamizimi është fatkeqësi kombëtare e shqiptarëve”<sup>18</sup> dhe se: “prirja e Shqipërisë do të ishte drejt fesë së krishterë...”<sup>19</sup> Në vizionin e tij, kjo ishte mënyra që do të sillte korigjimin e madh historik, që do të përshpejtonte “bashkimin e tij me kontinentin mëmë – Evropën”,<sup>20</sup> pa pyetur nëse Evropa do t’ua japë shqiptarëve trojet që ua dha të tjerëve!? Kjo pastaj solli tezën e Neshat Tozajt, i cili kur u kthye nga Parisi në janar të 1995, kërkoi që në regjistrimin

Islami, ashtu sikurse edhe krishterimi, janë bërë pjesë e historisë sonë kombëtare dhe pikërisht kjo paraqet një begati të trashëgimisë shpirtërore dhe mendore.

e popullsisë t'i kërkohej secilit përkatësia fetare dhe përkatësia kombëtare.<sup>21</sup> Ai shpresonte kështu që besimi mysliman të shuhej përmes këtij regjistrimi, pasi shqiptarët do të shënoheshin të gjithë “të krishterë”. Ishte një regjistrim që u përkrah me të madhe nga Serbia e Greqia dhe kjo të jep të kuptosh se cilët do të ishin përfituesit më të mëdhenj në këtë projekt. Aq më tepër, në projekte të tilla ka qenë angazhuar vazhdimisht Kisha Ortodokse Serbe dhe Akademia Serbe e Shkencave. Atëbotë, vetëm për gjashtë muaj, 45.000 shqiptarë, vetëm gjatë një gjysmë vjetori, zyrtarisht kishin ndërruar emrat për t'u

punësuar në Greqi, 70% e të cilëve ishin myslimanë, kurse pjesa tjetër katolike nga veriu i vendit.<sup>22</sup> Kush përfitonte nga këto konvertime?

Janë të njëjtit që do të përfitojnë edhe nga e ashtuquajtura “Lëvizja e Deçanit”, plani i të cilëve do të dështojë me turp, siç kanë dështuar përpjekjet e tjera gjatë historisë së shqiptarëve. Thirrjet publike për braktisje kolektive të Islamit, fillimisht në ateizëm (përkatësisht në shqiptari) e më pastaj për në krishterim, mund të përkeqësojnë raportin vëllazëror të kultivuar me kujdes të veçantë ndër shekuj. Anëtarët e deklaruar të kësaj lëvizjeje, shumica e të cilëve janë “me një këmbë në varr”, përpiqen të dalin dhe të arsyetohen në debate televizive (debate u thënshin), pa e kuptuar sa qesharakë mbeten para audiencës. Është po ai absurditet të cilën e pati përdorur edhe Enver Hoxha, kur më 1967 e ndaloi ligjërisht fenë dhe e shpalli Shqipërinë si vendin e parë dhe të vetëm ateist në botë, me arsyetimin se po e bënte për të evituar “përçarjen kombëtare”.

Konteksti “fe e të parëve” nuk ka pse lidhet me krishterimin, sepse kthimi “në fenë e të parëve” do të na shpie në politeizëm, madje edhe para saj, fare te fillimi, atje ku Zoti krijoi njeriun që të adhurojë Një të Vetmin Zot – Krijuesin e tij. Këta nuk i urrejnë myslimanët, por imazhin që vetë kanë krijuar për to, dhe ky imazh nuk është i myslimanëve, por i tyri. Dëshën a nuk deshën, Islami ashtu sikurse Krishterimi janë bërë pjesë e historisë sonë kombëtare dhe pikërisht kjo paraqet një begati të trashëgimisë shpirtërore dhe mendore. Përveç kësaj, Islami në 13 vjetet e fundit është rritur për 400 milion besimtarë, si nga rritja natyrore ashtu edhe nga konvertimet

në masë, kurse në Evropë ka arritur shifrën e 44 milionëve që po shumëfishohet dita-ditës dhe prandaj veprimi i lëvizjes nën maskën e “patriotizmit”, “shqiptarisë” dhe të “inkuadrimit evropian”, është thjesht absurd.

Mendja është baza e referimit mbi të cilën ngrihet dhe ndërtohet besimi (bindja), që pastaj të pasojë obligimi dhe përgjegjësia. Në këtë kontekst, përkundër ‘kombëtares’ që trashëgohet, ‘fetarja’ nuk trashëgohet, por zgjidhet pasi të kesh përdorur mendjen, të kesh hulumtuar, lexuar, pyetur, përpunuar e më pas, pasi të jesh bindur, të vendosësh cilën rrugë të marrësh.<sup>23</sup> Pas kësaj bindjeje, konvertimi bëhet vetëm me një të shqiptuar të dëshmisë,<sup>24</sup> por brenda saj qëndron një urdhër i fortë kuranor “Në fe nuk ka dhunë...”<sup>25</sup> Por, të moshuarit gjithmonë kanë thënë se: “kush nuk din të shohë errësirën, nuk sheh dot as dritën...”

Tipave të këtyllë do t'u sillte dobi libri “How to deal with idiots” i filozofit Maxime Rovere, i cili ia ka kushtuar jetën studimit mbi mënyrat e ndërveprimit. Libri shqyrton konceptin e idiotit, duke ofruar strategji për trajtimin e “idiotëve” në jetët tona dhe mënyrat për të evituar mundësinë që mos të jemi ne njëri prej tyre.

- 1 Leon Poliakov: “*The Aryan myth – History of Racist and nationalist Ideas of Europe*”, perkt. Edmund Howard, New York, 1974.
- 2 *Rimëkëmbja*, 9 maj 2001.
- 3 Gazeta SOT, 15 mars 2011.
- 4 Dhori Qiriaz: “*Krishterimi në Shqipëri*”, Tiranë, 2000, f.94, 114.
- 5 Branko Babić: “*Politika Crne Gore u novooslobodjenim krajevima 1912-1914*”, Titograd, 1984, f.234.
- 6 Elmaz B Plava: “*Plava e Guçia në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare – kujtime dhe dokumente historike*”, Tiranë, 2002, f.119.
- 7 Mehmet Bislimi: “*Mehmet Delia – Radisheva (alias: Mehmeti i Vogël)*”, Monografi, Prishtinë, 2011, f.145.
- 8 Zekeria Cana: “*Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar (1912 - 1913)*”, Prishtinë, 1996.dok. #78, f.129.
- 9 Muhamet Pirraku: “*Jo katedrale në emrin e shqiptarisë së imagjinuar*”, Prishtinë, 2003, f.22.
- 10 Edith Durham: “*Njëzet vjet ngatërresa ballkanike*”, Tiranë, 2001, f.241.
- 11 Hivzi Islami: “*Spastrimet etnike – politika gjenocidale serbe ndaj shqiptarëve*”, Pejë, 2003, f.151.
- 12 Čedomir Čulafić: “*Prokletijskih Meterizi*” f.183.
- 13 Ramiz Zekaj, në: [http://www.ircica.org/content\\_images/NL%2078.pdf](http://www.ircica.org/content_images/NL%2078.pdf); 15 shkurt 2008.
- 14 *Bisedë me Z. Xhenad Kastrat*, New York – Shtator 2010.
- 15 Joseph H Fichter: “*Autobiographies of Conversion*” Lewiston, 1987; James Muldoon: “*Varieties of Religious Conversion in the Middle Ages*”, University Press of Florida, 1997.
- 16 Hugh Gibson: “*The Ciano Diaries, 1937 - 1943*”, New York, 1946.
- 17 Hakif Bajrami: “*Naçertania- Program politik serb që shpie në shfarosjen e shqiptarëve*” (1844-1999)”, Prishtinë, 2004, f.263-264.
- 18 *Le Fiegaro*, 3 mars 1992.
- 19 *Start*, 1 nëntor 2008.
- 20 *Ftesë në Studio*, Fyard, 1991, f.40
- 21 *Panorama*, 19 dhjetor 2010
- 22 [www.lajmetari.net/98/Gazeta%20nr.98.doc](http://www.lajmetari.net/98/Gazeta%20nr.98.doc)
- 23 H.Muja: “*Në fenë e të parëve*”, Logos-A Shkup 2013
- 24 *How to Become a Muslim - Meeting Place for Reverts/ www.convertstoislam.com*
- 25 Kurani, 2:254-255.

# Shqiptarët dhe konvertimet fetare

(PLURALIZMI FETAR SHQIPTAR, MODELI QË NJERËZIMI TË JETOJË NË PAQE)

Xhafer Sadiku

Në konvertimet fetare kolektive në Kosovë, nga myslimanë në katolikë, me pretendimin se po kthehen në “fenë e të parëve” dhe për arsye “kombëtare”, se kinse bëhet në të mirë të “shqiptarizmit”, në të vërtetë, në to, nuk ka asgjë të re. Ajo është një lëvizje e vjetër, që daton nga fundi i shekullit XIX, e përdorur nga fqinjët ballkanikë për të përçarë shqiptarët dhe për të realizuar projektet e tyre nacionale. Thelbi i saj është të konsiderojë shqiptarët myslimanë sikur të ishin turq, duke minimizuar kontributin e tyre për atdheun.

## FEJA “E TË PARËVE”

Një studim të hollësishëm për fetë në popullin shqiptar dhe jo vetëm, e kam realizuar në librin “Midis Perandorive dhe Religjioneve” dhe këtu nuk do të ndalem gjatë. Disa momente përgjatë historisë së shqiptarëve janë të mjaftueshme për lëndën të cilën po marrim në analizë.

Me ndarjen e Kishës, në vitin 1054, hapësira etnike shqiptare mbeti nën Kishën e Bizantit, me përjashtim të pjesës Veri-Lindore të vendit që ishte nën juridiksionin e Kishës së Romës. Roma nuk e përballoi dot konkurrencën e ortodoksisë dhe katolicizmi u përfshi nga kriza të përhershme.

Kryqëzata nuk i dëboi pushtuesit serbë nga tokat shqiptare, pasi latinëve u interesonin vetëm qytetet bregdetare dhe ngushticat e Bosforit.

Për të nënshtruar Kishën Lindore, papa organizoi disa kryqëzata, por ishte kryqëzata e katërt kundër Konstadinopolit ajo që solli ndryshime rrënjësore në Bizant. Kryqtarët krijuan Perandorinë Latine që zgjati afro 60 vjet.<sup>1</sup> Gjatë asaj periudhe, ata zhvatën kishat ortodokse duke transportuar në perëndim sasia të mëdha të pasurive, të relikteve të shenjta e të pikturave më të çmuara. Kryqëzata nuk i dëboi pushtuesit serbë nga tokat shqiptare, pasi latinëve u interesonin vetëm qytetet bregdetare dhe ngushticat e Bosforit.<sup>2</sup>

Disa vite më vonë, pjesa bregdetare e Shqipërisë u pushtua nga anzhuinët, që sunduan për 107 vjet. Nën sundimin anzhuin, qytetet bregdetare dhe pronat e paluajtshme të shqiptarëve u bënë të latinëve. Shumë princa shqiptarë të besimit ortodoks, që ishin nën juridiksionin e mbretërisë së anzhuinëve, detyroheshin të konvertoheshin në kishën e Romës.<sup>3</sup> Karli Anzhu dhe mëkëmbësit e tij, katolikët i quanin shqiptarë, ndërsa ortodoksët, për shkak të ritit kishtar, i quanin grekë. Qysh atëherë, shqiptarët ortodoksë, perëndimi katolik i quante grekë dhe më vonë, shqiptarët myslimanë i quante turq.

Marrëveshja e Karli I Anzhu me 20 feudalë shqiptarë, në dhjetor 1274, i detyronte ata të mbështesnin ushtrinë e tij, kundër armiqve të

anzhuinëve. Armiqtë në fjalë ishin ortodoksët, të cilët filluan të kundërvepronin për të dëbuar anzhuinët nga territori i Shqipërisë.

Më 15 prill 1338, dukeshja e Durrësit Anja dhe duka Karli, u shkruanin feudalëve shqiptarë se ishin të gatshëm të tregonin mëshirë dhe të falnin ata që kishin braktisur fenë e tyre, por që ishin penduar e po ktheheshin në besimin e parë. Ata i siguronin Andrea Topisë dhe trashëgimtarëve legjitimitet të tij, shpërblimin vjetor prej 1000 grosh dhe zonën prej Matit deri në Shkumbin, mjaftonte që të ktheheshin sinqerisht në besën e tyre. Si garanci, ata ishin të detyruar të jepnin pengje në duart e mëkëmbësve të Karlit.<sup>4</sup>

Feudalët shqiptarë, për t'i shpëtuar presionit të anzhuinëve u bënë vasalë të Venedikut duke paguar tribut, në këmbim të mbrojtjes nga ana e republikës. Rivaliteti serbo-grek për sundimin e Bizantit, në gjysmën e parë të shek. XIV, favorizoi depërtimin e osmanëve në Ballkan dhe gradualisht edhe në tokat shqiptare. Për të përballuar rrezikun serb mbi Kostandinopolin, Perandori Joanis Paleologu bëri aleancë me osmanët. Më 1345, ai dërgoi një ambasador tek Orhani, në pallatin mbretëror në Bursa, për t'i ofruar dorën e vajzës së tij e për të lidhur aleancë kundër serbëve, që marshonin mbi Kostandinopoli, për të përzënë grekët.

Kishte shqiptarë që kishin marrë më herët fenë myslimane, pasi kontaktet e Islamit me Krishterimin ishin të hershme. Latinët nga Perëndimi dhe sllavët nga Lindja i kishin mbërthyer si në mors shqiptarët. Me ardhjen e osmanëve në Ballkan dukej se pati një lirim të shqiptarëve.

Pas humbjes në betejën e Fushë Kosovës, më 28 qershor 1389, Serbia nën sundimin e Stefanit, birit të Lazarit, u vu nën vasalitetin e Sulltan Bajazitit. Me humbjen e aleancës në betejën e Fushë Kosovës, lufta për hegjemoni midis dy të ardhurve të hershëm, serbëve dhe bullgarëve, kishte përfunduar në favor të atyre që erdhën të fundit, osmanëve.

## PLURALIZMI RELIGJIOZ

Pas marrjes së Konstandinopolit nga osmanët, Sulltan Mehmeti II Fatihu e organizoi popullsinë që sundonte sipas sistemit të mileteve, që ishte me bazë fetare. Shqiptarët, në atë periudhë i përkisnin në shumicë fesë ortodokse, pasi Kisha ishte ndarë katërqind vjet para se osmanët të merrnin Kostandinopolin. Ortodoksia ishte besimi fetar i shumicës absolute të popullsisë që osmanët vunë nën sundimin e tyre.

Toleranca religjioze e osmanlinjve ishte shpallur që në aktet e para të Zotit të ri të Bizantit. Sulltanët bënë koncesione të gjëra: lejuan që në vendet e fituara të formoheshin principata autonome; u lanë pronat pronarëve të vjetër të popujve të nënshtruar dhe u vunë taksa të vogla. Ata i lejuan kristianët të ushtronin lirisht besimin e tyre dhe njohën autoritetin e Patrikanës së Kostandinopojës mbi të gjithë ortodoksët, duke i dhënë asaj të drejtën e mbrojtjes së interesave të besimtarëve të tyre, pranë Portës së Lartë.

Pasardhësit e familjeve fisnike fanariote të ish-Perandorisë Bizantine, duke u bashkuar ngushtë rreth Patriarkanës, formuan një klasë të privilegjuar. Nga ajo fisnikëri, Kisha Ortodokse nxirrte peshkopët e patriarkët e saj, sulltanët zgjidhnin sekretarët kryesorë, përkthyesit e tyre të mëdhenj, ambasadorët e tyre të jashtëzakonshëm pranë fuqive evropiane, e në fund princat kristianë të destinuar të qeverisnin shtetet vasale.

E njëjta sjellje e osmanëve ishte edhe për Kishën Katolike në Perandorinë Osmane, madje nën osmanët ajo u lirua nga presioni i ortodoksisë së Fanarit. Më 1453, nëpërmjet një kapitulacioni, Sulltani u siguroi lirinë e kultit katolik, kapitulacion që mbeti për shekuj baza legale e ekzistencës së katolikëve indigjenë, shtetas osmanë.

Privilegjet e dhëna nga Sulltan Mehmeti II vazhduan edhe në shekujt që do të vinin. Ato u përfshinë edhe në Kartën perandorake të vitit 1856, e njohur nën emrin Hati Humayun, madje edhe më të theksuara. Porta e Lartë e ftonte Patrikanën të mblidhte një ansamble të përbërë prej peshkopëve dhe laikëve dhe të vendoste vetë rregulla, sipas të cilave do të administrohej kulti dhe punët kishtarë të ortodoksëve.

Perandoritë nuk mbështeten mbi themelin e kombësisë. Bazat e tyre janë fetare dhe politike, por, përmbi të gjitha, është ndjenja fetare që sundon.

Në Perandorinë Romake, që nga koha e Kostandinit, kishte sunduar në mënyrë absolute krishterimi dhe ishin goditur paganët, donatistët, arianistët, nestorianët etj.. Baza fetare e Perandorisë Bizantine ishte ortodoksia dhe ishin goditur paganët e më pas katolikët.

Baza fetare e Perandorisë Osmane ishte Islami, por nuk u përjashtuan besimet e tjera fetare. Popullsia që përbënte Perandorinë Osmane ndahej në milete. Ishte risi e madhe, krahasuar me të gjitha perandoritë që kishin

Perandoritë nuk mbështeten mbi themelin e kombësisë. Bazat e tyre janë fetare dhe politike, por, përmbi të gjitha, është ndjenja fetare që sundon.

qenë para saj, madje edhe të atyre që jetuan deri në shekullin XIX.<sup>5</sup>

Mileti fetar mysliman, i cili grupohej rreth Hilafetit osman. Myslimanët e çdo kombi ishin anëtarë të këtij grupimi, gëzonin të drejta të njëjta dhe formonin një bashkësi për një qëllim dhe një ideal.

Mileti fetar kristian që grupohej rreth Patriarkanës së Fanarit. Edhe në këtë millet, ishte po ajo formë: kombe të ndryshme, të drejta të njëjta dhe ideale të përbashkëta.

Gjithë jeta e Perandorisë Osmane zhvillohej brenda në qarkun e këtyre dy lloj grupimeve.

Kështu Rum Mileti-mileti grek jo në kuptimin etnik, por në kuptimin e Kishës ortodokse, varej nga Patrikana e Stambollit. Rum mileti përfshinte të gjitha popullsitë e krishtera të lindjes: grekë, bullgarë, serbë, shqiptarë, vllahë. Kryetari i quajtur millet bashi, ishte patriarku ekumenik, ndërsa struktura e tyre mbështetej në atë të kishës.

Krahas Rum Miletit, u organizua një millet armen. Në krye ishte katolikosi. Katolikët e Gallatës administroheshin nga statusi i veçantë i qytetit, kurse ata të provincave konsideroheshin si të varur nga Rum Mileti. Të nesërmen e pushtimit të Bizantit u organizua mileti hebre (jahudi millet).

Sulltan Mehmedi i Dytë Fatihu, kur mori Kostandinopojën, Patrikut të Kostandinopojës i dha venome të mëdha; i dha të drejtë të çelte shkolla greqisht, spitale dhe të kishte të ardhura nga pasuri të patundshme; të kishte gjykata më vete për të krishterët, të kishte mbrojtje dhe të administronte manastire e biblioteka; të shkruante e të administronte testamente, të pranonte pasuri të patundshme në emrin e patrikanës, të emëronte despotë, episkopë, priftërinj dhe gumenë dhe të kishte një këshillë të madhe në Kostandinopojë, gjysma fetare gjysma laike.

Në Perandorinë Osmane, ortodoksët u integruan shpejt, pasi osmanët ndërjuan një sistem qeverisës të hapur dhe meritokratik. Duke marrë nga përvoja e kalifatit abasid, osmanët shquheshin për aftësitë qeverisëse dhe gatishmërinë e tyre për të punësuar të krishterët dhe myslimanët. Në kohën e Sulltan Muratit të Dytë, vezirët e mëdhenj njiheshin për simpatitë e tyre ndaj të krishterëve.<sup>6</sup>

**Perandoria Osmane kishte sistem religjioz pluralist dhe konvertimet fetare ishin të lira, por bëheshin sipas një procedure të njëjtë për të gjitha besimet. Gallata kishte 200.000 banorë jomyslimanë dhe 60.000 myslimanë. Kishte shumë manastire e spitale për ortodoksët dhe 70 kisha, nga të cilat tre për armenët dhe dy sinagoga hebreje.**

Çdo bashkësi fetare, apo mileti, i lejohej një masë e madhe autonomie. Gjykatat, shkollat dhe sistemet e ndihmës sociale ishin në duart e zyrtarëve fetarë.

Perandoria Osmane kishte sistem religjioz pluralist dhe konvertimet fetare ishin të lira, por bëheshin sipas një procedure të njëjtë për të gjitha besimet. Po t'i referohemi regjistrimit të popullsisë që u bë në kohën e Murat Khan, që sundoi nga viti 1622 deri më 1648, rezultonte se Gallata kishte 200.000 banorë jomyslimanë dhe 60.000 myslimanë. Kishte shumë manastire e spitale për ortodoksët dhe 70 kisha, nga të cilat tre për armenët dhe dy sinagoga hebreje.<sup>7</sup>

Toleranca e Portës në raport me religjionet bazohej në kapitulationet e dhëna prej saj në favor të të krishterëve, duke përfshirë edhe Vikariatit Apostolik të Stambollit.

Deri më 1839, kur u shpallën reformat, organizimi shoqëror në Perandorinë Osmane funksiononte në bazë të sistemit të mileteve, ndërsa sistemi shtetëror mbi ndarjen e territorit në vilajete. Sistemi i qeverisjes së Perandorisë Osmane deri në vitin 1808, kur në fron hipi Sulltan Mahmudi II, ishte një lloj autonomie me një liri, pothuajse të plotë, për popujt e ndryshëm të Perandorisë. Pra, thënë ndryshe, Perandoria funksiononte mbi bazën e parimit federal.

Deri në periudhën e reformave institucionet fetare dhe arsimore funksiononin sipas organizimit të mileteve, ndërsa pas reformave pushteti u centralizua.

Fuqitë e mëdha evropiane, për të arritur qëllimet politike, do të shfrytëzonin edhe mosmarrëveshjet me karakter religjioz. Me gjithë bashkëjetesën fetare që ekzistonte në Shqipëri, ndërmjet komuniteteve fetare pati edhe mosmarrëveshje të nxitur nga klerikë të huaj.

Një konflikt midis katolikëve dhe ortodoksëve, ishte ai për pronësinë e kishës së Vrakës. Konflikti kishte nisur në fillim të viteve 1850 dhe vazhdoi vite me radhë. Katolikët thoshin se kisha ishte e tyrja, ndërsa të njëjtën gjë pretendonin edhe ortodoksët. Për këtë çështje, Arqipeshkvia e Shkodrës pati një korrespondencë të gjerë me konsullatën e Austrisë e të Francës, si dhe me Portën e Lartë.



*Shtrirja e Perandorisë Osmane dhe përhapja e Islamit në botë*

Rasti më tipik ishte në fshatin Rrjoll në Shkodër, fshat me dy komunitete: katolikë dhe myslimanë, që vazhdoi vite me radhë. Më 6 shtator 1882, paria katolike e Rrjollit iu ankua arqipeshkvit të Shkodrës për priftin e fshatit i cili, sipas tyre, nxiste përçarjen midis katolikëve dhe myslimanëve. Ai ndalonte katolikët të komunikonin me myslimanët e vendit dhe të shkonin në shtëpitë e tyre për festa, ndërsa katolikët nuk i lejonte të pranonin vizitat e myslimanëve në festat e Krishtlindjes e Pashkëve. Paria i kërkoi arqipeshkvit të vendoste paqen e shenjtë midis popullsisë dhe të thërriste priftin, se edhe ata do të shkonin të ballafaqoheshin me të, përpara arqipeshkvit. “Popullsia nuk mund të jetojë në armiqësi me myslimanët”, - theksonte paria, - “ka shumë nevojë të jetojë në miqësi, e jo në armiqësi”. Duke theksuar rrezikshmërinë e veprimeve të tilla, i luteshin të ndërhynte në kohë dhe të frenonte priftin, që të mos shkaktonte gjakderdhje.<sup>8</sup>

Politikën e të huajve në Shqipëri e denonconte prifti katolik, prof. D. Gaspër Jakova-Mérturi. Ai i akuzonte se zbatonin aksiomën e njohur politike “përça e sundo”.<sup>9</sup>

### SHQIPTARËT DHE KONVERTIMET FETARE

Shqiptarët si pjesë e Rum Miletit, duke qenë popullsi e vogël krahasuar me grekët, serbët e bullgarët, e ndjenin se nuk kishin peshë krahasuar me këta popuj të njëjtit besim fetar. Shto këtu edhe pozicionin gjeografik të Shqipërisë që

ndodhej në periferi të Perandorisë, vështirësitë për feudalët shqiptarë shtoheshin.

Rasti për të përfutuar u erdhi kur pranë tokave të tyre u shfaqën osmanët. Shqiptarët e parë myslimanë qenë zotërinjtë feudalë që aderuan në Islam vullnetarisht. Konvertimin e klasës sunduese të shqiptarëve në Islam e pasqyronte Jan Muzaka, në historinë e gjenealogjisë së shtëpisë së Muzakajve, që u linte bijve të tij. Midis të tjerave, ai shkruante se djalin e Kostantin Miserrit (Mazarakajos) Sulltani e bëri Pashë të Rumanisë e i dha vajzën e vet për grua.

Me përfshirjen e Shqipërisë në Perandorinë Osmane, fisnikët shqiptarë e ruajtën pasurinë dhe statusin shoqëror, madje këtë të fundit e përmirësuan.

Deri në vitin 1600, të krishterët shqiptarë ishin më shumë se myslimanët. Krahinat, në përgjithësi, ishin të krishterë. Islamizmi ishte përhapur më shumë nëpër qytete, ku gati të gjithë tregtarët e artizanët u konvertuan në Islam.

Islamizmi masiv i shqiptarëve nuk ndodhi kur perandoria osmane ishte në kulmin e fuqisë së saj, por në fund të shekullit XVIII dhe fillim të shekullit XIX. Kjo ishte periudha e dekadencës së Perandorisë Osmane.<sup>10</sup>

Mustafa Kruja, kur fliste për statusin e shqiptarëve në Perandorinë Osmane, shprehej se me t’u kthyer në islamizëm, automatikisht hynë në kategorinë e popullit sovran. Për gjithçka e në gjithçka, ata ishin të barabartë me turqit. Kur përshkruante historinë politike, administrative dhe ushtarake



të Perandorisë Osmane, ai vinte në dukje se në mes të njerëzve të mëdhenj të shtetit e të gjeneralëve me vlerë, numri i shqiptarëve, proporcionalisht, e kalonte atë të të gjithë popujve të tjerë, duke përfshirë edhe vetë popullin turk.

Për tolerancën e Perandorisë Osmane ndaj të krishterëve, ai theksonte se, “*Turqit treguan një tolerancë mjaft të gjerë kundrejt nën-shtetasve të fesë së krishterë, sipas urdhërimeve të Kuranit*”.<sup>11</sup>

Pas vitit 1600, fluksi i të konvertuarve në Islam ishte i madh, saqë Porta e Lartë, në fund të shekullit XVII, nxori “Nizami Xhedid” për të penguar ose ngadalësuar kthimin e të krishterëve shqiptarë në myslimanë.<sup>12</sup>

Sulltan Muradi IV dhe Porta e Lartë që në vitin 1638 e patën abroguar ligjin për mbledhje djemsh të krishterë, për t’i bërë jeniçerë, dhe veçanërisht shqiptarët. Vezir Hysen Qypriili nxori të parin “Nizam Xhedid” që të mos nguceshin të krishterët për tu konvertuar në myslimanë.<sup>13</sup>

## VLERAT DHE MERITAT E ISLAMIT PËR SHQIPTARËT

Besimi islam, që e kishte bërë të vetën shumica e popullsisë shqiptare, luajti rol vendimtar në ruajtjen e shqiptarëve nga asimilimi i kombeve fqinjë. Islamizmi i rezistoi sllavizmit, vetëm nga fakti që qeveria osmane kishte për bazë parimet e Kuranit. Sotir Kolea, njohës i çështjeve shqiptare e në mënyrë të veçantë i gjuhës dhe religjionit, në një përmbledhje për historinë e Shqipërisë së Poshtme, shkruante se shumica e të krishterëve humbën gjuhën, sidomos ndër viset ku myslimanët ishin pakicë. Vetëm në viset ku një pjesë e madhe e popullit kishin pranuar fenë e Muhamedit, “mbeti gjuha shqipe si kishte qenë gjatë shekujve”.<sup>14</sup>

Qysh nga viti 1898, konsujt austro-hungarezë u sugjerorin autoriteteve të tyre eprorë që t’i përdornin bektashinjtë. Madje, konsulli Ippen do të sugjeronte që të mbështetej mbi bektashinjtë duke i subvencionuar, me qëllim që të prekej popullsia nëpërmjet ndikimit të dervishëve të tyre, në Shqipërinë e Mesme dhe në Jug. Perëndimorët, - shkruan Nathalie Clayer, - “dhanë kontributin e tyre për të krijuar këtë imazh të dallimit që ekzistonte midis sunizmit/ bektashizmit, të cilit i korrespondonin një sërë kundërshtish: fanatik/ liberal, turk/shqiptar, aziatik/evropian, etj.”<sup>15</sup>

Që nga koha e Kongresit të Berlinit, elita myslimane propagandonte idetë nacionale. Emrat e Abdyl Frashërit,

Emrat e Abdyl Frashërit, Naim e Sami Frashërit, Mehmet Ali Vrionit, Rexhep Pashë Matit, Ismail Qemal Vlorës, Fadil Pashë Toptanit, Hasan Beg Prishtinës, Esad pashë Toptanit e plot të tjerëve, bashkë me vëllezërit e tyre të krishterë, kanë bërë emër si mbrojtës të kombit shqiptar.

Naim e Sami Frashërit, Mehmet Ali Vrionit, Rexhep Pashë Matit, Ismail Qemal Vlorës, Fadil Pashë Toptanit, Hasan Beg Prishtinës, Esad pashë Toptanit e plot të tjerëve, bashkë me vëllezërit e tyre të krishterë, kanë bërë emër si mbrojtës të kombit shqiptar. Klerikët patriotë, që nga koha e Lidhjes së Prizrenit, dhanë kontribut të madh në të gjitha ngjarjet e mëdha me karakter kombëtar. Hafëz Ymer Prizreni, Hoxha Tahsini, e shumë klerikë bektashianë i kthyen objektet e kultit në vatra të atdhetarizmit dhe ideve kombëtare.

Myslimanë e të krishterë kanë shërbyer, në qeverinë e Perandorisë Osmane dhe i kanë dhënë asaj burra shteti të përmendur dhe dijetarë të zot. Edhe në luftëra, shqiptarët, myslimanë e të krishterë kanë marrë pjesë së bashku. Të krishterët ishin të armatosur si vëllezërit e tyre myslimanë.

Pati shumë shqiptarë që megjithëse jetuan në Stamboll dhe u shkrinë në jetën e shoqërisë osmane, mbetën shqiptarë dhe përbëjnë vargun e njerëzve të mëdhenj shqiptarë që fati historik i hodhi në prehrin e Perandorisë Osmane. Ata, thoshte Syrja bej Vlora, i dhanë dritë e fuqi Shqipërisë.

Nga këta faktorë që u përmendën, duhet theksuar se tentativat e të huajve për të prishur ekuilibrin e shqiptarëve, të vendosur nga historia, do të dështojnë. Pluralizmi fetar i kombit shqiptar është modeli që ai i ofron njerëzimit për të jetuar në paqe e miqësi.

- 1 Revista “*Leka*”, 1944, nr. 4-8, f. 167; *Filmi historik i popullit shqiptar*.
- 2 P. Vincenzo Vannutelli; XIX; *Sguardo All’ Oriente - La Questione religiosa D’ Oriente*, Roma 1894, f. 44.
- 3 Revista “*Diturija*”, tetor 1928, nr. 12, f. 374-384. Theodor Ippen, *Dy shekuj e gjysmë nga histori e Shqipërisë*, 1204-1444.
- 4 Po aty, f. 118-119.
- 5 Xhafer Sadiku, *Midis Perandorive dhe Religjioneve*, Tiranë 2021.
- 6 Mark Mazower - “*Selaniku, qyteti i fantazmave*”, Shtëpia botuese “Dituria”, Tiranë 2011.
- 7 *Studi bizantini*, v. 2. Roma 1927, f. 72-73.
- 8 AQSH, fondi 131, viti 1882, dosja 5, f. 1-4. Letër e pleqësisë së R
- 9 Prof. D. Gaspër Jakova - “*La Questione d’Oriente e l’Albania*”, Froscati, 1905.
- 10 *Oriente moderno*, numër special, Napoli, janar 1998, f. 3.
- 11 Revista “*Hylli i Dritës*”, qershor-gusht 1941, f. 244.
- 12 Abdi Baleta, *Përballja me Islamoobinë*, Tiranë korrik 2006, . 258.
- 13 Revista “*Minerva*”, 16 janar 1934, f. 22-24, Ilo Mitkë Qafëzezi, *Voskopojë e vjetër dhe rrebeshimi i parë 1338-1769*.
- 14 AQSH, fondi 6, dosja 66/1, f. 168-169. Letër e Sotir Kolesë, datë 17 gusht 1940, dërguar Dr. Terenc Toçit.
- 15 Natali Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar*, Tiranë, 2009.

# Muhamedi a.s. dhe absurditeti i “kuranistëve”

Dr. Muhamed Stublla

Nuk imagjinohet Islami dhe myslimanët pa personalitetin e Muhamedit a.s., të cilit i zbriti Kurani, por edhe interpretimi, përkufizimi dhe detajimi i asaj që përmbante Kurani famëlartë, e që ne e quajmë hadith. Interpretimet dhe veprimet e Muhamedi a.s., janë hyjnore, nga Zoti xh.sh.. Për këtë Allahu xh.sh. thotë: *“Dhe ai (Muhamedi) nuk flet nga mendja e tij. Çdo gjë që thotë ai është shpallje që i shpallet”* (En Nexhm. 2-3). Muhamedi a.s., pavarësisht a ishte i gëzuar apo i mërziur, ai ishte besnik, i drejtë, korrekt, jetonte ashtu siç ishte i kënaqur Allahu xh.sh. me të. Kjo është rruga apo jetesja më e mirë që mund ta bëjë dikush. Kush e pranon dhe pason atë, fiton në të dy botët.

Zoti është i mirë, e donë të mirën dhe vetëm me të është i kënaqur. Ai ishte i kënaqur me Muhamedin a.s., dhe me ata që e pasojnë atë. Në Kuran për këtë thuhet: *“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, ashtu që të ju dojë Ai ju dhe t’ua falë mëkatet...!”* (Ali Imran, 31). Dashuria, nënshtrimi, respekti dhe pasimi i Muhamedit a.s., është dashuri, nënshtrim dhe pasim i Allahut xh.sh.. E kundërta, është mohim apo largim nga dashuria dhe mëshira e pakufishme e Allahut xh.sh..<sup>1</sup> Ndërsa, kur Zoti xh.sh. na porositi të largohemi nga të këqijat, rrje-

Ata të cilët refuzojnë hadithin, refuzojnë Muhamedin a.s. dhe Kuranin. Nëse dikush konteston një kauzë apo koncept, duhet ta dimë shkakun e këtij refuzimi, përmes së cilit bëhet vlerësimi, pranimi apo refuzimi i pretendimit përkatës.

dhimisht kuptojmë se Ai nuk është i kënaqur me veprat tona të këqija.

Nevoja jonë për njohjen e Muhamedit a.s., është në dy rrafshje: Në aspektin hyjnor, pasi që, nuk mund të jemi besimtarë myslimanë, pa besuar dhe pasuar Muhamedin a.s. për pejgamber të fundit të Zotit xh.sh.. Dhe, në rrafshin njerëzor, njeriu nuk mund të jetojë i lumtur, me parime edukative e kulturore, të ndiejë vlerën e tij reale dhe njerëzore po që se nuk jeton konform parimeve të jetës së Muhamedit a.s.. Realisht nuk gjeni fe me parime hyjnore e njerëzore që i ngajnë atyre me të cilat ka ardhur dhe thërret Muhamedi a.s.. Nuk mundemi të kemi raporte të mira me Zotin pa e dashur dhe pasuar Muhamedin a.s., andaj, më i rëndësishëm është Muhamedi a.s., sesa vetë jeta jonë, pasi që pa besimin dhe pasimin e tij nuk do të jemi të dashur të Zotit. Ai që e donë dashamirin e Zotit, është i dashur i Zotit xh.sh.. Ata të cilët refuzojnë hadithin, refuzojnë Muhamedin a.s. dhe Kuranin. Nëse dikush konteston një kauzë apo koncept, duhet ta dimë shkakun e këtij refuzimi, përmes së cilit bëhet vlerësimi, pranimi apo refuzimi i pretendimit përkatës. Për këtë, do të sjellim disa nga dyshimet që qarkullojnë nga të ashtuquajturit “gardianët e fesë”, në emër të mbrojtjes autentike dhe të pastërtisë

së saj me një fjalë kuranistët, dhe sigurisht edhe përgjigjet e këtyre dyshimeve sipas parimeve shkencore.

Sipas tyre, Muhamedi a.s., nuk është shëmbëlltyra më e mirë e një të dërguari të Zotit?

Të qenët e Muhamedit a.s. njeriu më i dashur dhe natyrshëm edhe më me ndikim në gjithë historinë, respektivisht, shëmbëlltyra më e përsosur njerëzore, është fakt i pranuar dhe i konfirmuar nga studiues myslimanë dhe shumë jomyslimanë. Natyrshëm, myslimanëve duhet t'ju mjaftojë dëshmia e Zotit xh.sh., i Cili thotë: *“Ju keni shëmbëlltyrën më të lartë në të dërguarin e Allahut...”* (El Ahzab, 21). Përderisa Muhamedi a.s., është modeli më ideal, i dashur për Zotin dhe krijesat e Tij, ti çfarë dëshiron më shumë?! Kush është më i avancuar se ai, që të lakmosh për zëvendësimin e dashurisë dhe pasimit të tij?! Zoti xh.sh. thotë: *“Vërtet, ti (Muhamed), pa dyshim ti je mbi moralin e lartë!”* (El Kalem, 4). Allahu xh.sh. ka thënë: *“mbi”* e nuk ka thënë: *“në”* moralin e lartë, nëse ishte përdorur shprehjen *“në”* do të thoshte je i përzgjedhur në mesin e të mirëve, mirëpo, me shprehjen *“mbi”* do të thotë: morali dhe edukata jote është më e larta, e pakrahasueshme. Nuk ka model që i bënë konkurrencë moralit dhe shëmbëlltyrës së Muhamedit a.s.. Rruga, dashuria dhe pasimi i tij janë suksese të garantuara për dy botët. Ata që ofrojnë apo propozojnë ndryshimin e kësaj figure hyjnore, duhet ta dinë që, nëse nuk e zëvendësojnë me një tjetër figurë më ideale nuk do të kenë sukses. Kush është ajo figurë më ideale që e zëvendëson Muhamedin a.s.? Askush! Muhamedi a.s., është më i përzgjedhuri i të përzgjedhurve, peygamberëve të Zotit, gjithsesi edhe i përzgjedhuri i njerëzve.

Sipas tyre, Muhamedi a.s., ishte i përzgjedhur i Zotit për transmetimin e Kuranit, andaj, na mjaftojnë vetëm mësimet e Kuranit.

Çdo pretendim duhet të vërtetohet. Argumentet për ato pretendime duhet të jenë konform shkencës në të cilën aludon. Prova apo testi i pretendimit është treguesi më i mirë i saktësisë së atyre mendimeve. Pretendimi se nuk kemi nevojë për hadith, respektivisht për mësimet e Muhamedit a.s., me pretekstin se feja është e plotësuar vetëm me Kuranin, duke ju referuar fjalës së Zotit xh.sh.: *“...Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islam in fe...”* (El Maideh, 3), nuk përjashton atë që transmetohet nga Muhamedi a.s., përkundrazi, ai përfshinë edhe Sunetin. Dhuntia më madhështore hyjnore është përzgjedhja dhe dërgimi i Muhamedit a.s., për peygamber. Zoti xh.sh. thotë: *“Dhe shfaq mirësitë me të cilat të bekojë Zoti yt!”* (Ed Duha, 11). Nuk ka mirësi më të madhe sesa ta pasosh përfaqësuesin e mëshirës së Zotit xh.sh., i Cili thotë: *“Ne të dërguam ty (Muhamed) mëshirë për të gjitha krijesat.”* (El Enbija, 107). Ata që i besuan dhe pasuan rrugën e Muhamedit a.s., bekimi dhe mirësitë ndaj tyre do të vazhdojnë edhe në botën tjetër. Veprat shpërblehen në proporcion me normat e tyre,



përderisa pasimi i Muhamedit a.s., është obligim edhe shpërblimi është i nivelit të pa imagjinuar. Zoti xh.sh. thotë: *“...Çfarëdo që t'ju japë i Dërguari, merreni atë, e çfarëdo që t'ju ndalojë, hiqni dorë prej saj...!”* (El Hashër, 7). Përmes këtij ajeti, Zoti xh.sh. në formë urdhërore e të përgjithshme, pa përjashtim, obligon pasimin e tërë asaj që buron nga Muhamedi a.s..<sup>2</sup> Gjithashtu, Allahu xh.sh. thotë: *“Kush i bindet të Dërguarit, në të vërtetë i është bindur Allahut...”* (En Nisa, 80). Bindja dhe nënshtrimi absolut ndaj Allahut, xh.sh. është i kushtëzuar me bindjen dhe pasimin e Sunetit të Muhamedit a.s., pavarësisht kategorisë së urdhrit apo ndalesës.<sup>3</sup> Kjo është forma e vetme e drejtë e kuptimit të ajetit, përndryshe do të ishte i pakuptimtë ky ajet i Kuranit. Në Kuran nuk ekziston asnjë fjalë apo fjali, shkronjë, e madje as edhe një vokal i panevojshëm dhe i paqëllimshëm.<sup>4</sup> Ky ajet obligon të besojmë dhe të praktikojmë tërë atë thesar të fjalëve, veprave, cilësive dhe vetive të Muhamedit a.s..<sup>5</sup> Për shkak të hapësirës, do të mjaftohemi me këto ajete. Mjafton të vërtetohet, qoftë edhe përmes një teksti të vetëm se është obligim pasimi i Muhamedit a.s.. Megjithëse ky urdhër vije nga më shumë se tridhjetë (30) herë në Kuran, ndërsa për urdhrin e pasimit të Muhamedit a.s., në hadithe nuk do të flasim fare, pasi që “gardianet e fesë, kuranistët” kanë dëshirë që të argumentohen vetëm me Kuran. Prova e dytë për saktësinë apo mos saktësinë e pretendimit se a mjafton vetëm Kurani, më së miri i kishin organizuar orientalistët, në kurthin e të cilëve po bien edhe disa myslimanë. Argumentet

logjike për obligueshmërinë e pasimit të Sunetit janë të shumta, e verifikimi i kësaj, ndërlidhet me përgjigjet:

Si do të thirrej ezani po që se nuk do të ishte Suneti? Si do të falej namazi pa hadithe, ndërsa ai është prej shtyllave bazë të fesë, nga sa rekate namaz do t'i falnin besimtarët?

Ndërsa për zekatin, si do t'i dinim kushtet për obligueshmërinë e zekatit, sa do të jetë përqindja vjetore që duhet t'u dhurohet?! Nga sa lopë dhe dele duhet të fillojë dhënia e zekatit?! Në kulturat bujqësore, sa duhet të jetë vlera e rendimentit dhe zekatit?

Detajet e rregullave të agjërimit si do t'i dinim, kur fillon dhe mbaron (agjërimit), kur priset dhe kur nuk priset, kur dhe si të kompensohet etj.?

Haxhi si do të praktikohej vetëm përmes Kuranit, cilat janë kushtet e tij, vendet e caktuara për qëndrim, nga ku fillon dhe ku përfundon tavafi, saji etj.?!?

Këto dhe shumë përgjigje për kushtet parimore të Islamit nuk i gjejmë në Kuran. Ato i gjejmë në hadithe, te Pejgamberi Muhamed a.s.. Kjo fe pa hadithe nuk mund të ishte e kompletuar. Nëse një obligim nuk mund të realizohej pa ndonjë gjë, ajo bëhet obligim, sikurse që është pasimi i Muhamedit a.s.. Pra, si do të ishte feja e kompletuar nëse nuk do ta dinim se si ta praktikonim atë?! Përsosmëria e fesë është me besimin dhe zbatimin në praktikë të Kuranit, fjalëve dhe veprave të Muhamedit a.s..

Sipas tyre, "kuranistëve" transmetimi i mësimëve të Muhamedit a.s., nuk është i sigurt, në fe nuk ka dyshime, prandaj refuzohen mësimet e tij, hadithi.

Pretendimi se nuk është shkencore dhe është e papranuar të punohet me tekste hyjnore nëse përmbajnë edhe një përqindje të pa konsiderueshme të pasaktësisë, është pretendim i gabuar, dhe si i tillë edhe i demantuar nga Kurani famëlartë. Zoti xh.sh., thotë: "... Më pas, nëse burri e ndan sërish gruan (për të tretën herë) nuk mund të martohet me të pa u martuar ajo me një burrë tjetër. Mirëpo, nëse gruaja ndahet nga burri i dytë, atëherë nuk kanë gjynah as ajo e as burri i parë që të martohen sërish me njëri-tjetrin, nëse mendojnë se do t'i respektojnë kufijtë e Allahut..." (El Bekareh, 230). Nga fjala "nëse mendojnë se do t'i respektojnë kufijtë-ligjet e Allahut", Zoti xh.sh., e ka pranuar martesën e tyre, nëse mes tyre dominon vullneti dhe bindja për një martesë të re sipas ligjeve të Zotit xh.sh..<sup>6</sup> Saktësia dhe siguria e haditheve

është shumë më e lartë sesa pretendimi i dy bashkëshortëve se do ta respektojnë ligjin e Zotit xh.sh., në bazë të së cilit premtim, i cili është tepër relativ, Allahu xh.sh., ua lejoi rimartesën edhe pas një të kaluarë të tyre të hidhur. Përmes këtij ajeti, hidhet poshtë pretendimi se ndalohet argumentimi me argumente jo të prera. Po, me argumente jo të prera nuk lejohet të ndërtojmë parime apo baza shkencore, por obligohemi që me argumente, saktësia e të cilave dominon të argumentohemi për ekzekutimin e atyre parimeve apo bazave, veçanërisht nëse niveli i saktësisë së tyre është shumë i lartë. Megjithatë, hadithet e sakta të transmetuara përmes transmetuesve besnikë, të cilët duhet të jenë: të drejtë, myslimanë,<sup>7</sup> moshërritur dhe të mençur,<sup>8</sup> larg elementeve të shthurjes apo degjenerimit, duke mos vepruar mëkate të mëdha dhe gabimet e vogla të mos jenë të vazhdueshme,<sup>9</sup> të pajisur me edukatë, moral dhe parime të mira,<sup>10</sup> të jenë të përpiktë dhe të vëmendshëm kur e dëgjon dhe e plason hadithin. Këta transmetues me këto virtyte që i lakmon secili i mençur dhe korrekt, duhet që përcjelljen e transmetimeve ta bëjnë njëri pas tjetrit, pa ndonjë iluzion apo lëshim.

Po të njëjtit transmetues, transmetojnë edhe Kuranin, atëherë, pse i refuzojnë vetëm transmetimet e haditheve, apo përmes hadithit dëshirojnë të defunksionalizojnë edhe Kuranin? Megjithatë, për t'u siguruar nga gabimet, këta transmetues i nënshtrohen edhe filtrave të kritikës së hadithit (علم علل الحديث), përqendrimi i së cilës fushë është te transmetuesit dhe hadithet e sakta, në mënyrë që edhe hipotetikusht të pamundësohet depërtimi i ndonjë gabimi eventual në hadith, pasi që nga natyra njerëzore, mund të depërtojë ndonjë gabim eventual. Krejt kjo procedurë është në fushën e transmetimit. Ndërsa, kur kalohet te fusha e kuptimit,<sup>11</sup> hadithi i nënshtrohet filtrave apo rregullave të tjera, si: komentimi i hadithit nën harmonizim dhe dritën e Kuranit dhe Sunetit, grumbullimi të gjitha haditheve rreth një teme të caktuar, kuptimi i haditheve nën dritën e shkaqeve,

rrethanave dhe objektivave të hadithit, dallimi mes kuptimit tekstual dhe atij figurativ të hadithit, etj.. Këto rregulla pamundësojnë që objektivi i hadithit të jetë jashtë kontekstit dhe qëllimit të thënies së tij. Pra, mendimi se për shkak të mundësisë së gabimit eventual gjatë transmetimit të haditheve, gjegjësisht të jetës së Muhamedit a.s., nuk lejohet

Shkrimi i haditheve apo jetës së Muhamedit a.s., është realizuar në proporcion me nevojën e shkrimit të tij, saktësisht sikurse u paraqit nevoja e tubimit të Kuranit pas betejës së Jemames, ku u vranë shumë hafëzë të Kuranit. Kjo vonesë e tubimit nuk ndikoi që të ketë gabime në Kuran.



apo nuk obligohemi të praktikojmë mësimet e Muhamedit a.s., është mendim i pasaktë, tendencioz, synon dëmtimin e Sunetit, dhe kështu të arrijë të paraqes dyshime edhe në Kuran. Shkrimi i haditheve apo jetës së Muhamedit a.s., është realizuar në proporcion me nevojën e shkrimit të tij, saktësisht sikurse u paraqit nevoja e tubimit të Kuranit pas betejës së Jemames, ku u vranë shumë hafëzë të Kuranit. Kjo vonesë e tubimit nuk ndikoi që të ketë gabime në Kuran, vendimi për tubimin e tij i ngjante vendimit për tubimin e Kuranit.

Gjithashtu, vlen të theksohet se në Kuran pak prej fjalëve kanë një konotacion të vetëm argumentues,<sup>12</sup> dhe se askush nuk pretendon se ndalohet të punohet me ato fjalë kuranore shumëdimensionale, edhe pse kuptimi i tyre nuk është i prerë, sigurisht nëse njëri nga ato kuptime është i argumentuar, i harmonizuar me ajete dhe hadithe të tjera, të cilat së bashku realizojnë objektivat hyjnore. Saktësinë e haditheve e dëshmojnë edhe format e tjera të transmetimit të hadithit, sikurse që është transmetimi i haditheve, përmes bartjes së juristëve: gjeneratë pas gjenerate, që i ngjanë formës së transmetimit të Kuranit. Në literaturën juridike, gjejmë thujtë të gjitha hadithet të cilat janë referencë argumentuese në temat përkatëse. Kështu kanë vepruar komentuesit e Kuranit, gjatë shpjegimit të tij kanë sjellë hadithet që ndërlidhen apo komentojnë temat që trajtojnë ajetet përkatëse. Njashtu, vepruan historianët, gjatë shkrimit të historisë së Muhamedit a.s., sollën hadithet në konotacionin historik. Të gjitha fushat islame kanë transmetuar hadithet sipas formës apo natyrës së shkencës përkatëse, duke i respektuar kriteret e atyre shkencave. Këto janë argumente që garantojnë saktësinë e haditheve të transmetuara sipas shkencës së hadithit. Mundësia e gabimit në mësimet e Muhamedit a.s., është zvogëluar aq shumë sa që në asnjë

formë, përfundimisht, nuk mund të ndodhë që të punohet me hadithe jo të sakta, kështu që hadithet që nuk kalojnë filtrat e saktësisë mbeten të refuzuara. Pra, hadithet e dobëta, të cilat nuk janë vërtetuar që burim e kanë shpalljen hyjnore, nga Muhamedi a.s., refuzohen, përveçse në orbitën e preferimeve apo mos pëlqimeve në masë të caktuar dhe me kujdes të veçantë. E rëndësishme është pasimi i Muhamedit a.s., pavarësisht se a i referohemi jetës së tij përmes shkencës së hadithit apo të juristëve, dy nga rrugët më të konsoliduara për transmetimin e jetës së Muhamedit a.s.. Rruga e transmetimit është mjet që në mënyrë të sigurt duhet të na dërgojë te qëllimi, e ai është pasimi i Muhamedit a.s.. Muhamedi a.s., është shëmbëlltira më e mirë, e dëshmuar dhe pranuar nga myslimanët dhe jomyslimanët transparent, ai paraqet mesazhin hyjnor. Besimi apo Islami nuk është i plotë pa besimin dhe pasimin e tij, mesazhet e të cilit janë transmetuar me saktësi të pashembullt, të pa parë më herët dhe të pakrahasueshme më pas. Nevoja e njerëzimit, jo vetëm e myslimanëve për Muhamedin a.s., është e jashtëzakonshme. Promovimi i kësaj figure gjenerale, të lartë morale dhe kulturore, të drejtë, promovon dashuri, paqe e lumturi në botën tonë dhe përtej saj. Pa dyshim, se ky personalitet është Pejgamberi Muhamed a.s., i dashuri i Krijuesit dhe krijesave, familjari dhe prijësi shembullor. Botës bashkëkohore, më shumë se kurrë i duhet ta jetësojë këtë shëmbëlltiryre të papërsëritur, të cilës nuk i gjejmë konkurrencë, e assesi ngjashmëri. Askush nuk mund të pretendojë besimin dhe edukatën e Muhamedit a.s..

- 1 Imam Abdurrahman bin Naser e Sadij, *Tejsir el Kerim err Rrahman fi Tejsir Kalam el Menam*. 1/128, 0002.
- 2 Abdulmelik el Kushejri, *Tejsiru-l Kushejri - Letaifu-l ishara*, (Kajro-Egjipt, 2014) 3/560.
- 3 Imam Ebu Mensur el Maturidiju, *Tejsir el Maturidij*, (Bejrut-Liban, 2005) 3/66.
- 4 Mustafa Sadik er Rafiiju, *Ixhaz el Kuran ve el Belagatu en Nebevijetu*, (Bejrut, 5002) 1/157.
- 5 Imam Ibën Rexheb el Hambelit 795 h, *Fethu el Bari*, (Arabia Saudite, Medine, 6991) 1/61.
- 6 Dr. Abdu el Adhim Ibrahim el Mutaiji, *Esh Shubuhath eth Thelethune el Mutheratu Linkar es Sunetu en Nebevijetu*, *Ard ve Tefnid ve Nakdun*, 1999, f. 122.
- 7 El Gazali, Muhamed bin Muhamed, *El Mustesfa fi Ilm el Usul*, (Bejrut, Dar el Kutum el Ilmije, 3141h.) 124.
- 8 Ibën Es Salah, Uthamn bin Abdu err Rrahman, *Marifetu Enva Elum el Hadith*, (Siri, Dar el Fikr, Bejrut, Dar el Fiker el Muasir 1998), f.104.
- 9 El Menevi, Zejnudin Muhamed, *El Jevokit ve ed Durar fi sherh Nuhbeti ibën Haxher*, (Rijad, Mektebetu err Rruzhd, 1999) 2/351.
- 10 El Fejumi, Ahmed, *El Misbah el Munir fi Garib esh Sherh el Kebir*, (Bejrut, El Mektebu el Ilmijeh) 2/569.
- 11 El Kardavi, dr. Jusuf, *Kejfe Neteamel Mea es Sune en Nebevijeh, në kapitullin Mealim ve Davabit Lihusni Fehm es Suneh en Nebevije*, (Kajro, 2013) f. 111- 200.
- 12 Ebu el Hasen el Mevurdit, *Tejsir el Mevurdij en Nuket el Ujun*, (Bejrut-Liban, 2008) 1/35.

# Roli i Mevludit në ruajtjen e vlerave tona fetare e kombëtare

Resul ef. Rexhepi

*Vëllezër nga zjarri ndoni të shpëtoni  
Me zemër të djekme “essalatu” thoni!*

## HYRJE

Sa herë që vjen 12 rebiu’l eveli, myslimanët Sgjithandej nëpër botë, e kujtojnë me kënaqësi duanë e hazreti Ibrahimit, i cili teksa i ngrinte muret e Qabesë me të birin hazreti Ismailin, në një moment iu drejtua Zotit duke e lutur: “Zoti ynë, dërgo ndër ata (pasardhësit tanë, ymetin islam) një të dërguar nga gjiri i tyre që t’ua lexojë argumentet Tua, t’ua mësoj Librin (Kuranin) dhe urtësinë (rregullat e fesë) e t’i pastrojë ata (nga pafesia). Vërtet, Ti je i Gjithëfuqishmi dhe më i Urti Gjithëgjykues!”<sup>1</sup>

Dhe shi për këtë, u dashtë të kalojë një kohë e konsideruar, madje disa shekuj, u dashtë që dielli shumë herë të lindë e të perëndojë, derisa Allahu i Gjithëmëshirshëm ia pranoi lutjen Ibrahimit a.s. dhe e dërgoi atë që shndriti gjithësinë, Tokën dhe qiejt, të gjitha krijesat.

Me dërgimin e Muhamedit a.s., bota do të fitojë një ndriçim të ri, e Muhamedi a.s. me një rast do të deklarojë: “O njerëz, ta dini se unë jam i dërguari i Allahut për të gjithë ju për t’ua prezantuar fenë e vërtetë të Zotit, fe të cilën e kanë pasur të gjithë pejgamberët e Zotit, por që me kalimin e kohës njerëzit e ndryshuan dhe futën shumë gënjeshtër dhe shumë risi të shpikura, ndaj, unë me urdhrin e Zotit po e

Duke qenë se  
Pejgamberi a.s.  
ka gëzuar vend  
meritor në  
zemrat dhe  
shpirtrat e  
besimtarëve,  
madje si  
askush tjetër  
nga krijesat e  
Allahut, poezi  
dhe vargje për  
të kanë thurur  
njerëzit që nga  
koha e Ebu  
Bekrit e tutje.

dëlirë dhe po e pastrojë dhe kështu po ia kthejë origjinalitetin e saj.”

Është, prandaj, dashuria jonë e madhe dhe respekti i pashoq që ndjejmë për Pejgamberin tonë, ajo që na shtynë që atë ta kujtojmë në mënyra të ndryshme, edhe me mevlud e salavate, gjithmonë po edhe në ditëlindjen e tij. Dashuria ndaj Resulullahut ka qenë ajo që i ka shtyrë shumë autorë, shqiptarë dhe të tjerë, që ndër shekuj të thurin bejte e poezi, e që për nga stili dhe karakteri i tyre i lartë, janë thjeshtë të paarritshme.<sup>2</sup>

## MANIFESTIMI I DITËLINDJES SË PEJGAMBERIT A.S. OSE MEVLUDI

Duke qenë se Pejgamberi a.s. ka gëzuar vend meritor në zemrat dhe shpirtrat e besimtarëve, madje si askush tjetër nga krijesat e Allahut, poezi dhe vargje për të kanë thurur njerëzit që nga koha e Ebu Bekrit e tutje, e madje që nga e famshmja “*Talea l-bedru alejna*”. Por, literatura e krijuar për ditëlindjen e Pejgamberit a.s., nuk është qëllimi ynë në këtë rast, por është manifestimi i organizuar për ditëlindjen e Pejgamberit a.s. - Mevludin - siç është i mirënjohur te ne.

Që në fillim duhet konstatuar se, gjatë kohës sa ka qenë gjallë vetë Pejgamberi a.s., madje as gjatë kohës së sahabëve, tabiinëve e tebei-tabiinëve nuk është se ka pasur organizime për të manifestuar ditëlindjen e më të dashurit të Zotit – Muhamed Mustafasë, ashtu siç është manifestuar ndër shekuj ose siç

manifestohet sot, ose, në ndonjë formë tjetër më ndryshe. Megjithatë, shumica dërrmuese e dijetarëve islamë, organizimet e ndryshme për ditëlindjen e Pejgamberit i përkrahin fuqishëm.<sup>3</sup>

Vetë praktika e myslimanëve tash e sa kohë, gjithandej në fshatra e qytete, si në botën islame, ashtu edhe në vendet e tjera, është argumenti më i madh për këtë lloj organizimi.<sup>4</sup> Kjo traditë e krijuar shekuj me radhë nuk bën të nënçmohet, sepse nënçmimi i saj është nënçmim i vetë Pejgamberit a.s.. Sa kohë që, vetë hadithet e Pejgamberit a.s., dëshmojnë se: *“Ymeti im nuk do të bien në ujdi për një çështje që është e gabueshme!”* Ose: *“Atë që myslimanët e vlerësojnë të mirë, edhe tek Allahu do jetë e mirë.”* Rreth (mos)lejimit të organizimit të Mevludit si organizim fetar, është shkruar mjaftueshëm, saqë kushdo që dëshiron mund të gjejë materiale të bollshme dhe bindëse. Do ta përmendi, me këtë rast, vetëm mendimin e Imam Sujutiut, i cili manifestimin që e bëjnë njerëzit duke lexuar Kuran, duke lexuar bejte-vargje kushtuar Pejgamberit, duke rikujtuar momente para dhe gjatë lindjes, mrekullive të tij e deri te kalimi i tij në botën tjetër – Ahiret, duke dërguar salavate e duke bërë dua, i ka konsideruar të lejuara dhe të shpërblyera me sevape nga Allahu i Gjithëmëshirshëm. Për më tepër, kur kjo bëhet me qëllim ibadeti, atëherë shtrohet pyetja, a thua ka ibadet e që Allahu të mos na shpërblejë për të?!

Argument tjetër mund të konsiderohet edhe agjërimi i Pejgamberit që e bënte ditën e hënë. Kur ai qe pyetur se përse e agjëronte atë ditë, ai kishte thënë: *“Atë ditë kam lindur, atë ditë më ka ardhur shpallja dhe atë ditë kam bërë hixhretin!”*<sup>5</sup> Mbi të gjitha, nuk mundemi me këtë rast e të mos e përmendim fjalën e Allahut në Kuran kur thotë: *“Paqja qoftë mbi të ditën kur u lind, ditën kur do të vdesë dhe ditën kur do të ringjallët.”*<sup>6</sup>

Madje, po të njëjtat fjalë të Zotit janë thënë edhe përmes gojës së Isait a.s.: *“Paqja e shpëtimi qoftë mbi mua ditën kur u linda, ditën kur do të vdes dhe ditën kur do të ringjallëm!”*<sup>7</sup>

Sikurse kuptohet, këto dy ajete të Kuranit, argumentojnë respektin meritore të ditëlindjes dhe të vdekjes, si dy momente shumë të rëndësishme ku manifestohet fuqia e Zotit Krijues!

Krahas nga sa u tha më sipër, duhet të jemi koshient e nuk duhet harruar edhe një të vërtetë të pakontestueshme se,

dashuria dhe respekti ndaj Pejgamberit a.s. nuk është i mjaftueshëm vetëm me organizim të manifestimit të mevludit, përkundrazi, dashuria e vërtetë e respekti i sinqertë ndaj Resulullahut tregohet duke e ndjekur synetin e tij, duke e ndjekur rrugën që ai na e trasoi e duke vepruar sipas asaj që ai na udhëzoi. E pra, organizimi i manifestimit të ditëlindjes së Pejgamberit, duhet të shfrytëzohet edhe si një shkas më tepër për të jetësuar synetin e traditën që ai na e trashëgoi.

Prandaj, manifestimi i ditëlindjes së Pejgamberit a.s., ku më shumë e ku më pak, organizohet gjithkund në botë. Vargjet poetike, bejtet, poezitë e ndryshme, ilahitë e kasidet, mevludet e salavatet në qindra gjuhë të botës i dërgohen Muhamed Mustafasë.

## MEVLUDI TE SHQIPTARËT

Sikur në shumë gjuhë të botës, edhe në gjuhën tonë të bukur shqipe, bejte e vargje kushtuar Resulullahut shkruan shumë dijetarë e ulema, madje penat më të ndritura të kohës. Ndër ta do të veçonim: Hasan Zyko Kamberin (shek. XVIII), Muhamed Çamin, Ismail Floqin, hfz. Ali ef. Ulqinakun, Tahir ef. Popovën, hfz. Ali ef. Korçën, hfz. Ibrahim ef. Dalliun, Abdullah ef. Zëmplakun, Sheh Ahmet Shkodrën, Islam Nekovcin, Mehmet ef. Salihun, Ferit Vokopolën, Vexhi Buharanë, Idriz Lamaj, Fahrudin Osmanin, e shumë të tjerë. Në aspektin përmbajtësor, përmes vargjeve të mevludit, e ndjejmë dhe e përjetojmë kalimin e Pejgamberit nëpër fazat e jetës së tij: si qe lindja e tij, si fëmijë bonjak, sinqeriteti i tij në Meke, pranimit i Shpalljes, emigrimi, mrekullitë e tij, rikthimi në Meke dhe kalimi i tij në botën tjetër.

Në aspektin kohor, te ne, këto mevlude shtrihen përgjatë disa shekujve, duke filluar nga Mevludi i Hasan Zyko Kamberit në shek. XVIII, e për të vazhduar deri në ditët tona, dhe, dhëntë Zoti që kjo traditë të vazhdojë deri në Ditë të Kiametit, gjithmonë duke i kënduar Pejgamberit mirë e më mirë.

Në aspektin hapësinor, ndërkaq, Mevludi dhe manifestimi që është organizuar me atë rast, ka qenë i shtrirë në të gjitha viset shqipfolëse, madje jo vetëm te shqiptarët në

Ballkan, po madje edhe te vëllezërit tanë në Diasporë, nga Evropa e deri në ShBA.<sup>8</sup>

Shumica dërrmuese e shteteve arabe, si në nivel shtetëror-geveritar e institucional, ashtu edhe në atë popullor,

Në aspektin hapësinor, Mevludi dhe manifestimi që është organizuar me atë rast, ka qenë i shtrirë në të gjitha viset shqipfolëse, madje jo vetëm te shqiptarët në Ballkan, por edhe te vëllezërit tanë në Diasporë, nga Evropa e deri në ShBA.



organizojnë manifestime të tilla, natyrisht, secila ndryshe nga tjetra, me qëllim që sa ma shumë të ketë organizime kushtuar Pejgamberit a.s.. Në të tilla raste, lexohet Kuran nga lexues eminentë, mbahen fjalë rasti kushtuar Pejgamberit a.s., recitohen poezi, kaside e ilahi, gjithsesi salavate, dua e lutje të ndryshme për të përfunduar me shpërndarjen e ëmbëlsirave...

Dhe kjo është respektuar në përpikëri, sepse ata janë mbështetur në rregullin juridik islam: “*Kushti i vakëfit është sikurse teksti i Ligjvënësit.*” Duhet theksuar edhe një fakt të pamohueshëm se, në kuadër të mejtepeve e më vonë edhe të medreseve, vazhdimisht nxënësit kanë lexuar Kuran dhe kanë kënduar mevlud. Madje, gjatë netëve të mëdha ose datave të rëndësishme islame, kanë organizuar programe fetare të posaçme, ndërkaq gjatë muajit Rebiul`evvel më së shumti kanë kënduar mevlude. Në kuadër të medreseve, gjithmonë kanë ekzistuar seksione të ndryshme të nxënësve për aktivitete të llojllojshme, e në mesin e tyre ka qenë edhe grupi i mevludit.<sup>9</sup>

Mevludi, qoftë si ibadet apo manifestim rasti, në asnjë mënyrë nuk mund të cilësohet si diçka i ndaluar (haram ose mekruh), sikundër që as mund të pretendohet se është ndonjë detyrim (farz, vaxhib apo synet). Ai, sipas Sheriatit, është veprim i lejuar, ai mund të jetë *mendub!* Shpërblehet nga i madhi Zot ai që e organizon, ai që merr pjesë aktive dhe ai që prezanton, sikundër që privohet nga shpërblimi ai që nuk merr pjesë, por jo se ka gjynah. Prandaj, ai që nuk merr pjesë në manifestime të tilla, nuk është se bënë gjynah, por edhe nuk fiton sevap.

Këtë pjesë dua ta përmbyll me fjalët e Ibën Haxher Hejtemiut, i cili ka deklaruar: “*Në natën e Mevludit të gjitha krijesat, melaqet, xhindet e kafshët, si dhe metalet e pashpirt iu japin myzhdë njëri-tjetrit duke u gëzuar se nderi i gjithësisë e ndriçoi botën.*”<sup>10</sup>

Roli i Mevludit në ruajtjen e vlerave tona fetare e kombëtare

Krahas nga sa u tha më sipër, do të theksonim se deri më sot njihen rreth 30 mevlude të shkruara nga personalitete të njohura shqiptare në fusha të ndryshme të fesë dhe të letërsisë, të cilët, me mjeshtërinë e tyre dhe në mënyrë artistike e shembullore thuren lavde e konsiderata, - si për askënd tjetër, - për të Dërguarin e Allahut xh.sh., Muhamedin a.s..

Hartimi dhe manifestimi i mevludit ka luajtur një rol me rëndësi për ruajtjen e identitetit fetar të atij mjedisi ku është shkruar ose kënduar. Ai ka mbajtur gjallë, ka freskuar, ka motivuar dhe ka ushqyer shpirtin e myslimanëve për biografinë e ndritur të Pejgamberit a.s. dhe për mësimet e tij. Dhe jo vetëm kaq, por mevludet përmbajnë edhe vlera të tjera didaktike dhe estetike.

Roli dhe rëndësia që ka luajtur mevludi në ruajtjen e identitetit fetar të shqiptarët më së miri kuptohet nëse i hedhim një vështrim historik e vlerësues zhvillimit të jetës fetare islame në pesë-gjashtë dekadat e fundit të shekullit të kaluar, d.m.th. gjatë kohës së ish-sistemit komunist, kur pjesa dërrmuese e besimtarëve myslimanë ishin jashtë xhamisë, ose, thënë ndryshe, xhamitë gati sa nuk ishin mbyllur. Në këtë kohë, mevludi ishte manifestimi gati i vetëm me të cilin ulemaja komunikonte me besimtarët, në veçanti me ata mysliman që rrinin më larg xhamisë.

Çështje e vërteta, porositë e mevludit tingëllojnë gjithmonë aktuale dhe me peshë, sepse përmes mevludit poeti ka arritur në mënyrë shembullore të shprehë në vargje kushtet dhe detyrimet kryesore të fesë islame, të shpjeguara në mënyrë shumë lakonike, të kuptueshme dhe të thjeshtë, në mënyrë që masa e besimtarëve t'i kuptojë dhe t'i perceptojë sa më lehtë, e rrjedhimisht ato porosi edhe t'i vërë në zbatim praktik.

Hartimi dhe manifestimi i mevludit ka luajtur një rol me rëndësi edhe për ruajtjen e identitetit tonë kombëtar. Hartimi dhe këndimi i mevludit në gjuhën shqipe kanë bërë që të nxirret nga përdorimi këndimi i mevludit në gjuhën turke





“*Vesiletu n-Nexhāt*” i autorit Sylejman Çelebiut.

Në anën tjetër, autorët e mevludeve, duke qenë fetarë dhe atdhetarë të dëshmuar, kanë synuar që bejtet e tyre, përveç frymëzimit fetar, të ngjallin edhe vetëdijen kombëtare.

Ja se si shkruan mevludshkornjësi ynë, hafëz Ali Korça i mirënjohur:

.....  
*Qante o vëllazër se po shkoj vatani  
 U shkull që nga rrënjët shkoj dini, imani  
 Nga ky shkak nuk quhej Mumin i vërtetë  
 Sikush që s'ka dhimbje për vatan' e vetë<sup>11</sup>  
 Ose:  
 “Zot! Le tëna rojë Atdhe' Kombësija  
 Aqë sa të rrojë edhe Gjithësia”<sup>12</sup>*

## SI PËRFUNDIM

Pejgamberi a.s. nuk la trashëgimi tjetër përveç Kuranit dhe Synetit, pra, Islamit dhe disa qindra mija myslimanë, për të arritur kjo shifër sot në mbi dy miliardë. Sot nuk ka vend

Autorët e mevludeve, duke qenë fetarë dhe atdhetarë të dëshmuar, kanë synuar që bejtet e tyre, përveç frymëzimit fetar, të ngjallin edhe vetëdijen kombëtare.

ose mjedis në tërë rruzullin tokësor e të mos ketë besimtarë islam, pasues të Muhamedit a.s.. Krahas faktit se ai përmendet dhe mbi të bien salavat miliarda myslimanë, mbi të gjitha, emrin e tij, Allahu e krahasoi me emrin e Vet. Është konstatim tashmë i pranuar botërisht nga ana e dijetarëve të mirëfilltë se manifestimi që e kanë organizuar myslimanët tanë, siç e përmendëm më sipër, përveç të tjerash, ka luajtur një rol me rëndësi për ruajtjen e identitetit tonë fetarë dhe atij kombëtar. Andaj:

*Vëllezër nga zjarri ndoni të shpëtoni*

*Me zemër të djekme “essalatu” thoni!*<sup>13</sup>

- 1 Kuran, El Bekare, 129. Pejgamberi a.s., teksa lexonte këtë ajet, pra lutjen e Ibrahimit, me një rast kishte thënë: “Unë jam ai për të cilin është lutur Ibrahim!”
- 2 Sadik Mehmeti, *Rëndësia e Mevludit për ruajtjen e vlerave fetare dhe të atyre kombëtare ndër shqiptarët*, botuar në Takvimi 2020, Kryesia e BI-së së Kosovës, Prishtinë.
- 3 Vlen të theksohet edhe qëndrimi i Qendrës Ndërkombëtare për Fetva të Al-Az'harit. (Qnfea) Lidhur me Mevludin, duke theksuar se festimi i ditëlindjes së Pejgamberit është legjitim me argumente të vërteta të mbështetura në Kuran dhe në Synet dhe me konsensus të dijetarëve të ymetit. Atë mund ta gjeni edhe në linkun: Al-Azhar Portal - فتوى دار الإفتاء - بوابة الأزهر - المصرية حول الاحتفال بالمولد النبوي
- 4 “Mevludi tek shqiptarët”, përmbledhje kumtesash, bot. Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2010, Prishtinë.
- 5 Rreth argumenteve që i kanë shënuar dijetarët islamë përkitazi me lejimin e Mevludit, më gjerësisht, shih: Mr. Taxhedin Bislimi te “Mevludi tek shqiptarët”, bot. i Kryesisë së BI-së të Kosovës, f. 58 e tutje. Gjithashtu dhe “Mevludi, historiku dhe dispozita e tij” me autor Mr. Taxhedin Bislimi, 2006, Shkup.
- 6 Kuran, Merjem, 15.
- 7 Kuran, Merjem, 33.
- 8 Për shtrirjen e mevludeve te shqiptarët, më gjerësisht tek Islam Dizdari për historikun dhe traditën e Mevludit te shqiptarët, botuar në “Mevludi tek shqiptarët” (përmbledhje kumtesash), Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2010.
- 9 Sadik Mehmeti, *Rëndësia ...*
- 10 Marrë nga Faik Luli e Islam Dizdari, *Mevludet në gjuhën shqipe*, 2002, Shkodër, f. 9.
- 11 Hafëz Ali Korça, “Mevludi dhe cilësitë e shenjta të Pejgamberit a.s.”, Tiranë, 1944, f. 15.
- 12 Hafëz Ali Korça, *Mevludi...* f. 24.
- 13 Hafiz Ali Korça, *Vepra 7 (Mevludi)*, Logos-A....

# Vështrim në një ngjarje, që nxit rivlerësimin e leximit të jetës së Pejgamberit a.s.

Muhamed Sytari

**“Është e vërtetë se Allahu u dha dhuratë të madhe besimtarëve, kur ndër ta nga mesi i tyre dërgoi një të dërguar që atyre t’u lexojë argumentet e Tij, t’i pastrojë ata, t’ua mësojë Librin dhe Urtësinë, edhe pse më parë ata ishin krejtësisht të humbur.”** (Ali Imran, 164)

Më 10 shevval, të vitit 8 hixhri, në luginën e Hunejnit, në mes Taifit dhe Mekës, ndodhi përballja e myslimanëve me dy fiset arabe, Thekif dhe Hevazin. 12 mijë myslimanë, nga myslimanët e rinj mekas, me rreth 30 mijë nga kundërshtarët.

Ibën Hishami tregon nga Ebu Said el Kuduriu se: “Kur Resulullahu a.s. u shpërndau kurejshëve dhe fiseve arabe, aq sa u shpërndau nga plaçkat e betejës së Hunejnit, ndërkohë që ensarëve nuk u dha asgjë prej tyre, disa nga banorët e lagjeve ensarite u ngushtuan disi në vetvete. Disa prej tyre e shprehën këtë me fjalë jo të mira, derisa, dikush prej tyre tha: “Resulullahu a.s. i dha popullit të vet!”

Pas kësaj, sahabiu Sad ibni Ubade r.a., shkoi te Resulullahu a.s. dhe i tha: “Ja Resulullah, kjo lagje ensarite janë ngushtuar disi prej teje, për shkak të veprimit tënd me plaçkën e betejës. I dhe popullit tënd dhe fiseve arabe dhe nuk u dha atyre asgjë?” Ia ktheu a.s.: “Po ti, o Sad, ku qëndron në tërë këtë mes?” Sadi i tha: “Ja Resulullah, unë jam pjesë e popullit tim!” Ai



a.s. tha: “M’i mblihdh popullin tënd në këtë stan!” Aty erdhën edhe disa muhaxhirë, që i lejoi, ndërsa disa të tjerë i ktheu pas. Ndërkohë, kur u tubuan banorët e lagjes ensarite, Sadi r.a. e lajmëroi të Dërguarin a.s..

Resulullahu a.s. doli në mes tyre, e falënderoi Allahun dhe e lartësoi me emrat e Tij të merituar, pastaj tha: “O ensarë, çfarë janë disa fjalë jo të mira prej jush dhe një kritikë që e patë të përshtatshme për mua në vetët tuaja? A nuk ju gjeta të devijuar, Allahu ju udhëzoi me mua! Ju gjeta të varfër, Allahu ju pasuroi me mua! Ju gjeta të armiqësuar, Allahu jua ngrohu zemrat me mua!” Thanë: “Pa dyshim, Allahu dhe i Dërguari i Tij janë bekim e mirësi për ne!” Tha a.s.: “A nuk më përgjigjeni, o ensarë?” Thanë: “Çfarë të përgjigjemi, ja Resulullah? Allahu dhe i Dërguari i Tij janë bekim e mirësi për ne!” Tha a.s.: “Pasha Allahun, po të doni, mund ta thoni, të vërtetën do ta thoni dhe do të miratoheni për të: Na erdhe i përgënjeshtruar, ne të vërtetuar (në thirrjen tënde)! I poshtëruar, ne të përkrahëm! I dëbuar, ne të strehuam! I varfër, ne të dhamë e të bëmë njërin prej nesh! A u mërzitët, o ensarë, për pak begati të kësaj bote, me të cilën ngroha zemrat e një populli që të bëhen myslimanë, ndërsa juve ju lashë në begatinë e Islamit tuaj! A nuk jeni razi, o ensarë, që njerëzit të shkojnë

me dhentë dhe bagëtitë e tyre, ndërsa ju të ktheheni me Resulullahun në shtëpitë tuaja? Pasha Atë, që e ka shpirtin e Muhamedit në dorën e Tij, sikur të mos ishte Hixhreti, do të isha një njeri nga mesi i ensarëve. Dhe, nëse njerëzit do të ndiqnin një shteg, unë do të ndiqja shtegun e ensarëve. O Allah, mëshiroji ensarët, edhe bijtë e ensarëve, edhe bijtë e bijve të ensarëve!”

Njerëzit nisën të qanin, aq sa u lagën mjekrat e tyre dhe thanë: “Jemi razi me Resulullahun tonë!” Pastaj Resulullahu u largua dhe njerëzit u shpërndanë!<sup>1</sup>

U ndala pak dhe mora frymë thellë. Është e mrekullueshme kjo pamje, ky rrëfim e kjo ngjarje, që duhet ta shkruajmë me shkronja të arta. Është e jashtëzakonshme urtësia, thjeshtësia, komunikimi i tejdukshëm dhe zemërgjerësia e Resulullahut tonë a.s. përballë shokëve të tij, edhe atyre, që për një moment e paragjykuan veprimin e tij të urtë e largpamës.

Kjo ngjarje me krejt detajet e saj, është në vetvete një shkollë besimi, tek e cila duhet të hyjmë, herë pas here, për të pyetur veten se ku qëndrojmë ne sot, me mësimet dhe thirrjen e Pejgamberit tonë a.s.?!

A jemi ne ensarë të sinqertë të Zotërisë së bijve të Ademit? A jemi përkrahës të traditave dhe udhëzimeve të tij, nëpërmjet të cilave na bëhet mburojë përballë sfidave të kohës; përballë injorancës, imoralitetit, ateizmit, abuzimit me shenjtëritë, tendencave përherë e më të pabesueshme të prishjes së familjes, fanatizmit të verbër gjithandej, cytjeve të egra e të pamëshirshme kundër tabanit e përqaimit tonë shekullor të këtij Islami madhështor, por jo vetëm?!

Është një mësim i jashtëzakonshëm, që na mëson se si të sillemi në mes vete, duke ruajtur ekuilibrin e vëllazërisë, miqësisë të thella, dashamirësisë e solidaritetit në komunitet, duke mos lejuar assesi paragjykimin e ngutjen në gjykim, për t’u kthyer në gjyqtarë të rreptë të ndarjes e përçarjes së pamerituar, krijimit të dallgëve artificiale që përmbysin ç’a të gjejnë para, edhe prej anijeve të vjetra e të qëndrueshme me krejt ekuipazhin e tyre!?

Është koha, që leximet e shumta nga jeta e të Dërguarit të Allahut, të na shërbejnë për të ndryshuar veten, duke u rritur me mësimet e Zotërisë sonë, me durim e vullnet të fortë! Është koha, që t’i qasemi me shumë seriozitet e korrektësi thelbit të asaj që rëndomtë i themi: “Syneti i Pejgamberit a.s.”,

Është koha, që teksa ndër ne, rikthehet Hana e bekuar e muajit rebiul evel, të tërhiqemi përherë e më shumë nga dashuria e ndjerë dhe ndjesitë e dëshmuara, në hak të Zotërisë sonë, për ta dëshmuar me të madhe, përherë e më shumë në realitetet e përditshmërisë sonë se ne, vërtet jemi vëllezër të Pejgamberit a.s.

për të kuptuar përherë e më shumë se “shembulli”, për të cilin bën fjalë Kurani famëlarhtë, teksa na tërheq vëmendjen për t’u lidhur përherë e më shumë me shëmbëlltërinë e Resulullahut tonë, nuk mund të jetë thjesht angazhimi, thuajse ekstrem, për të jashtmen dhe sipërfaqësoren, as tendenca për t’u izoluar nga shoqëria me pretekstin e fetarizmit, as krijimi i stereotipave të papranueshme në shoqëri, që shpesh ngjallin debate të panevojshme dhe shkaktojnë humbje energjie të pajustificuar, për thuajse asgjë!?

Është koha, që teksa ndër ne, rikthehet Hana e bekuar e muajit Rebiul evel, të tërhiqemi përherë e më shumë nga dashuria e ndjerë dhe ndjesitë e dëshmuara, në hak të Zotërisë sonë, për ta dëshmuar me të madhe, përherë e më shumë në realitetet e përditshmërisë sonë se ne, vërtet jemi vëllezër të Pejgamberit a.s. dhe sahabëve të tij, në rrugëtimin tonë krejt të natyrshëm drejt të jetuarit me dinjitet, veshur me pelerinën e pasimit të arsyeshëm e plot pathos, të Dërguarit mëshirë e dhuruar.

Për fund, le të meditojmë për pak në ajetin 69 të sures El Muminune, ku Allahu i Madhëruar na tërheq vëmendjen: “apo mos nuk e njohin të dërguarin e vet (Muhamedin), prandaj ata e refuzojnë atë?”

Në tefsirin e tij të këtij ajeti, dr. Muhamed Ratib en Nabulsi pyet: “A nuk e keni mësuar akoma vlerën e pejgamberit tuaj? A nuk e keni mësuar moralin e tij? A nuk e keni mësuar synetin e tij në jetë? A nuk e keni mësuar mirësjelljen e tij? ... Krejt plotësia

gjendet në qenien e tij, krejt besnikëria, krejt ndershmëria, krejt udhëzimi në rrugën e drejtë; krejt sinqeriteti, krejt vlerat, krejt mirësia dhe, akoma nuk e keni njohur? ... Deveja kërkoi mbrojtjen e tij, guri i dha selam, trangu i hurmës u përmallua për të dhe ju akoma nuk e keni njohur?!<sup>2</sup>

Koha është që të ndreqim sadopak rrëmujën e shkaktuar nga hutimi dhe keq leximi, keq shërbimi dhe keqinterpretimi i kësaj pasurie të paimagjinueshme të argumenteve që na afrojnë përherë e më shumë me shembullin e jetuar të gjurmëve konkrete të Resulullahut a.s., jo hijes së keqpërdorur të tyre!

1 Ibën Hisham, “Es Siretun Nebevije”, botimi i IV, Bejrut-Damask, 1999, vëll. i III, f. 112.

2 Dr. Muhamed Ratib en Nabulsi, *Tefsirun Nabulsi*, botimi i parë, 2016, Aman, Muesesetul-Fursan, vëll. 6, f. 49-50.

# Mrekullia juridike e legjislacionit islam (2)

Dr. Ejup Haziri

## LEGJISLACION HUMAN

Legjislacioni Islam veçohet nga humaniteti apo njerëzorja, që nënkupton se ky legjislacion është ligjësuar për shkak të njeriut, për të ngritur vlerat e tij si dhe për ta ruajtur nga denigrimi dhe prozhmimi. Si rrjedhojë e kësaj, u janë bërë legjitime njeriut disa rite që ta shuajnë etjen e tij shpirtërore, ngase njeriu nuk përbëhet vetëm nga ana trupore që e ngop ushqimi, pirja dhe marrëdhëniet seksuale, mirëpo krahas kësaj ai ka nevojë edhe për anën shpirtërore.<sup>1</sup>

Ky legjislacion është legjislacion human për mbarë njerëzimin, e jo vetëm për arabët siç pandehin disa skeptikë dhe injorantë, edhe pse i Dërguari Muhamed ishte arab dhe gjuha që zbriti ishte në gjuhën e popullit arab, por kjo nuk e bën këtë legjislacion lokal, por ai është mbarë njerëzor, edhe po të mos zbriste në gjuhën arabe, do të zbriste në ndonjë gjuhë tjetër: “Ai, që ia shpalli Furkanin (Kuranin, dallues të së vërtetës nga e pavërteta) robit të vet (Muhamedit) që të bëhet Pejgamber i botës (këshillues), është i madhëruar.” (Furkan, 1).

I Dërguari i Allahut u dërgua për mbarë njerëzimin, e jo për një popull të veçantë: “E Ne të dërguam ty (Muhamed) vetëm si mëshirë për të gjitha krijesat.” (Enbija, 107). Po ashtu thuhet: “Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i dërguari i Allahut te të gjithë ju...” (Araf, 158).

E, qëllimi me mocionin “legjislacion mbarë njerëzor” është trajtimi që ky legjislacion ia

Legjislacioni islam është legjislacion human për mbarë njerëzimin, e jo vetëm për arabët, siç pandehin disa skeptikë dhe injorantë, edhe pse i Dërguari Muhamed ishte arab dhe gjuha që zbriti ishte në gjuhën e popullit arab, por kjo nuk e bën këtë legjislacion lokal, por ai është mbarë njerëzor.

bënë banorëve të këtij rruzulli duke i paraqitur si një tërësi e përbashkët dhe e pandarë.<sup>2</sup>

Njerëzorja për të cilën jemi duke folur, buron nga elementi hyjnor, që legjislacionin hyjnor e bëri edhe njerëzor, të kapshëm dhe të praktikueshëm për njeriun, gjë që plotësisht përshtatet me natyrshmërinë e vetë njeriut.

Vetë urdhëresat e këtij legjislacioni janë humane dhe për njeriun, e këtu del në pah se ky legjislacion i kushton rëndësi të posaçme njeriut dhe aspektit njerëzor, ku shumë urdhëresa dhe obligime të legjislacionit kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërnjerëzore, të drejtën e individit, të drejtat e shoqërisë, të drejtat civile dhe të drejtat penale, që në kuptim të përgjithshëm janë raporte reciproke në mes njerëzimit.

Nëse për një çast ndalesh dhe mendon për njërin nga adhurimet e mëdha, siç është zekati, do të vësh se në esencë është adhurim ‘njerëzor’. Pra, merret prej njerëzve të pasur dhe u jepet hallexhinjve. Zekati, para së gjithash paraqet pastrim e dëlirësi, e më pas pasurim dhe lirim.<sup>3</sup>

Agjërimi është edukim i vullnetit të njeriut në durim dhe në ballafaqim me mundimet, është edukatë e të ndierit dhembjet e tjetrit dhe përpjekje për barazi. Për këtë arsye i Dërguari i Allahut këtë muaj e ka quajtur ‘Muaji i durimit’<sup>4</sup> dhe ‘Muaji i barazisë.’

Haxhi paraqet një kongres hyjnor-njerëzor në të cilin i Lartmadhëruari i ka ftuar robërit e vet besimtarë: “(Vijnë) Për të qenë të

pranishëm në dobitë e tyre dhe që ta përmendin Allahun në ato ditë të caktuara (në shenjë falënderimi) dhe për që i ka furnizuar me kafshë. Hani pra prej tyre (kurbaneve) dhe ushqeni të ngushtuarin e të varfrin.” (Haxh, 28).

Përveç kësaj, i Dërguari i Allahut çdo vepër të bërë nga besimtari e ka ngritur në pozitë të adhurimit nga i cili adhurim rrjedhin dobi fizike ose shpirtërore për vetë ata.<sup>5</sup>

Ky legjislacion e konsideron njeriun krijesë njerëzore-humane, e jo siç pandehin ideologji dhe filozofi të ndryshme ku njeriu humb vlerën e vet, saqë nganjëherë ai paraqitet hyjnor si zot, duke i atribuuar atij elemente hyjnore, e herë tjetër njeriu konsiderohet si kafshë produktive apo kafshë e civilizuar. Me fjalë të tjera, Legjislacioni Islam e konsideron njeriun ashtu siç është, duke mos e ngritur njeriun në gradë të hyjnitetit e as që e zbret atë në gradë të shtazës. Për këtë i Madhërishmi ka potencuar: “Vërtet, Ne e krijuam njeriun në formën më të bukur.” (Tin, 4).

Me urtësi të përsosur i Madhërishmi e ngriti krijesën njeri duke e bërë në formën më të bukur: “Ai krijoi qiejt dhe tokën me urtësi të përsosur dhe Ai juve u dha formën, e formën tuaj e bëri të bukur dhe vetëm te Ai është e ardhmja.” (Tegabun, 3).

### TA MBJELLIM HUMANIZMIN NË ZEMRAT TONA

Njeriu si qenia më e përsosur dhe më e dalluar në rruzullin tokësor duhet të marrë shkëndijat e humanizmit që dalin nga legjislacioni human, për t'i realizuar ato në jetën e tij, që të jetojë me ndershmëri si krijesë e privilegjuar.

Ky legjislacion e konsideron njeriun krijesë njerëzore-humane, e jo siç pandehin ideologji dhe filozofi të ndryshme ku njeriu humb vlerën e vet, saqë nganjëherë ai paraqitet hyjnor si zot, duke i atribuuar atij elemente hyjnore, e herë tjetër njeriu konsiderohet si kafshë produktive apo kafshë e civilizuar.

Kësaj krijese i Plotfuqishmi ia besoi mëkëmbësin në sipërfaqen e tokës, e që me të rezulton se kjo krijesë është fisnikëruese dhe e fisnikëruar: “(Përkujto Muhamed) Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë po krijoj (po përcaktoj) në tokë një zëvendës!” Ata thanë: “A do të vësh në të atë që bënë çrregullime dhe që derdh gjaqet, e ne të madhërojmë Ty me lavdërimin Tënd dhe plotësisht të adhurojmë!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini!” (Bekare, 30).

Akoma më fisnikëruese është fakti se kësaj krijese Allahu ia përueli dhe ia nënshtroi çdo gjë tjetër duke e bërë në shërbim të saj. E padyshim që ky ishte një nder i madh për këtë krijesë, e në lidhje me këtë i Madhërishmi ka përmendur: “Allahu është Ai, që për ju e nënshtroi detin që me lejen e Tij të lundrojnë anijet nëpër të, që të kërkon begatitë e tij; ndaj, falënderojeni. Dhe për ju nënshtroi gjithë ç'ka në qiej dhe ç'ka në tokë, njëmend për njerëzit që mendojnë thellë, në to ekzistojnë argumente.” (Xhathije, 12-13).

Krahas këtyre dhuntive, myslimani duhet të mendojë gjatë për këto mirësi të panumërta, por mbi të gjitha duhet të mundohet që të jetë i njerëzishëm në raport me njerëzit dhe me krijesat e tjera, e të mos jetë shkatërrimtar dhe injorant ndaj të tjerëve, pa marrë parasysh pozitën dhe statutin e tij. Ai duhet të jetë human dhe ndihmues ndaj të tjerëve sa herë që e kërkon nevoja, madje nëse e kërkon nevoja duhet të largojë edhe ferrën apo gurin që i pengon kalimtarët, ngase me këtë e tregon humanizmin e tij dhe shpërblimi për këtë vepër të vogël nuk do të mungojë, sikurse që duhet të tregohet i njerëzishëm në lëmshë ndaj nevojtarëve dhe skamnorëve, ndihmë ndaj atyre që kanë nevojë, pajtim në mes të ngatërruarve, urdhërim për të mirë e ndalim



nga e keqja, t'ia largojë brengat besimtarit, madje duhet të tregohet i njerëzishëm edhe atëherë kur ta takojë vëllain apo shokun e tij, të tregohet i buzëqeshur, ashtu siç potencoi i Dërguari i Allahut: “Buzëqeshja ndaj vëllait tënd është lëmoshë.”<sup>6</sup>

Me fjalë të tjera, duhet të jetë i mirë dhe i dobishëm për të tjerët, duke iu ndihmuar dhe lehtësuar atyre punët, e të mos jetë keqbërës dhe ngatërrimtar. Duhet të aplikojë urdhëresat njerëzore dhe humane në jetën e tij me qëllim që të jetojë i njerëzishëm me veten, familjen, rrethin dhe shoqërinë e vet. Islami mbolli humanizmin në zemrat e besimtarëve, duke kërkuar prej tyre që të jenë human në çdo fushë dhe në çdo segment prej jetës së tyre.


### LEGJISLACION EKUILIBRUES

Baraspesha është veçoria tjetër e legjislacionit islam që e bën atë mesatar dhe të qëndrueshëm konform dy dukurive të kundërta dhe ekstreme, apo mes dy poleve të kundërta, duke mos anuar kah njëri dhe duke mos i dhënë njërit më tepër sesa që i takon, duke mos e dëmtuar polin tjetër.<sup>7</sup> Me fjalë të tjera është një sistem mjaft i ekuilibruar, në të gjitha aspektet, duke eliminuar elementin e skajshmërisë, teprimit, ashpërsisë dhe ekstremitetit, e duke ofruar një sistem hyjnor të butë, mesatar, të natyrshëm dhe i cili përkon plotësisht me arsyen dhe natyrshmërinë e vetë njeriut. I Madhërishti ka potencuar: “Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkelni atë. Prandaj matni drejt e mos hani në peshë!” (Rahman, 7-9).

Me ekuilibrin nënkuptohet balanca apo baraspesha në secilën çështje, duke eliminuar skajin e tepricës apo pakësimit. Kjo është një baraspeshë precize që vetëm Ligjvënësi ka ditur ta përcaktojë, e që njeriu s'do të mundte asnjëherë të krijonte diçka të tillë, me gjithë arritjet dhe përpjekjet e tij, ngase ekuilibri në fakt i tejkalon mundësitë e njeriut, për faktin se njeriu është i kufizuar në shumë çështje të ndryshme, por edhe shpeshherë ai mund të ndikohet nga animet dhe prirjet vetjake, nga tiparet familjare, grupore, klimatike, racore etj.<sup>8</sup>

Në këtë botë që na rrethon e shohim natën dhe ditën, terrin dhe dritën, nxehtësinë dhe ftohtësinë, lagështinë dhe thatësinë, si dhe gazra të ndryshëm, të gjitha këto të caktuara me një baraspeshë dhe me një llogari të përkryer. Asgjë s'mund ta cenojë tjetrën e as që mund të dalë jashtë kufijve të caktuar. Dielli, hëna, yjet dhe konstelacionet kozmike notojnë e sillen në orbitën e vet (në hapësirën qiellore) pa u përplasur me tjetrin dhe pa dalë jashtë kornizave të caktuara.<sup>9</sup> Le të sjellim disa shembuj të këtij ekuilibri nga fjalët e të Madhëruarit: “Ne çdo send kemi krijuar me masë të caktuar.” (Kamer, 49).

Në një rast tjetër thotë: “Ai është që krijoi shtatë qiej palë mbi palë. Në krijimin e Mëshiruesit nuk mund të shohësh ndonjë kontrast, andaj drejto shikimin se a sheh ndonjë çarje?” (Mulk, 3).



Po ashtu thotë: “As dielli nuk mund ta arrijë hënën, e as nata paraditen po secili noton në një galaktikë.” (Ja Sin, 40).

Gjithashtu thotë: “Dielli dhe hëna udhëtojnë sipas një përcaktimi të saktë. Edhe yjet edhe bimët i bëjnë përulje (dëshirës së Rrahmanit). Ai e ngriti edhe qiellin dhe Ai vuri drejtësinë.” (Rahman, 5-7). Kjo për fenomenet e gjithësisë, ku shihet ekuilibri i baraspeshuar në mënyrën më të përpiktë, ndërsa edhe në aspektet e tjera vërehet qartë ekuilibri dhe baraspesha, që nga Krijuesi e deri te krijesa(t) dhe çdo gjë që ekziston mes tyre. Në Kuran thuhet: “A mos u krijuam prej asgjëse, apo ata vetë janë krijues? A mos ata i krijuan qiejt e tokën, jo, por ata nuk janë të bindur.” (Tur, 35-36).

Po ashtu thotë: “A mos morën ata zota prej toke që mund Të ringjallin (të vdekurit)? Sikur të kishte në to (në qiej e në tokë) zota pos Allahut, ato të dyja do të shkatërroheshin. Larg asaj që i përshkruajnë është Allahu, Zoti i Arshit. Ai nuk pyetet se çka punon, po ata, (njerëzit), pyeten.” (Enbija, 21-24).

Gjithashtu thotë: “Nga faktet (e fuqisë) e Tij është edhe ajo, se Ai ju krijoi prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat në) njerëz që veproni të shpërndarë. Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë. Nga argumentet e Tij është krijim i qiejve e i tokës, ndryshimi i gjuhëve tuaja dhe i ngjyrave tuaja. Edhe në këtë ka argumente për njerëz. Nga argumentet e Tij është edhe gumi juaj natën dhe ditën, edhe përpjekja juaj për të fituar nga të mirat e Tij. Në këtë ka argumente për popullin që dëgjon. Nga argumentet e Tij është edhe ajo që ua dëfton vetëtimën edhe si frikë edhe si shpresë, dhe nga qielli lëshon shi e me të e ngjall tokën pas vdekjes së saj. Në këtë ka argumente për një popull që di të mendojë. Nga argumentet e Tij është që me fuqinë e Tij bëri të qëndrojë (pa shtyllë) qielli e Toka, mandej kur t'ju thërret juve me një të thirrme prej tokës, ju menjëherë dilni.” (Rum, 20-25).

Pra, ekziston një ekuilibër i jashtëzakonshëm në çdo segment dhe pol të kësaj jete, saqë ai ekuilibër mahnit mendjen dhe arsyen tonë, dhe se ai ekuilibër vlen edhe për krijesat e tjera.<sup>10</sup>

## EKUILIBRI NË BESIM

Legjislacioni islam është sistem i ekuilibruar dhe mesatar në çdo pikëpamje, mesatar në mes materiales dhe shpirtërores.<sup>11</sup> Këtu nuk përjashtohen as adhurimet e obliguara, ngase adhurimet që kanë ardhur janë në formë të baraspeshuar dhe mjaft të ekuilibruara. Ato nuk përmbajnë elemente ekstreme dhe vija të ashpra. Ato janë ndërmjet ithtarëve të besëtytnive dhe religjioneve të ndryshme që shkojnë skajshmërisht dhe në vijën ekstreme në obligimet e tyre të ndryshme. Krishterët dhe çifutët shkuan në ekstrem kur thanë se Zoti ka djalë dhe fjalët e tyre rreth Isait dhe Uzejrit, e në raste tjera çifutët nga vija ekstreme u bënë tolerantë të butë, sikurse që ishte rasti me ndryshimin e librit të shenjtë dhe gjërave tjera. E ky legjislacion është mesatar në secilën pikëpamje, duke përjashtuar elementin e rreptësisë, skajshmërisë dhe teprimit. Nuk është si legjislacioni çifut që nuk ua lejon lutjet jashtë shtëpive dhe vendeve të kultit, që uji nuk i pastron nga papastërtitë, ku shumë ushqime ia kanë ndaluar vetes, e as si legjislacioni krishterë që për ta s'ka diçka të papastër, e as që ndalojnë diçka, por të gjitha i shohin në suaza të lejimit.<sup>12</sup> Për dallim nga këto, besimi islam është mesatar, i plotë, i drejtë dhe i natyrshëm për mendjen dhe logjikën e njeriut: *“Dhe ashtu (siç ju udhëzua në fenë islame) Ne u bëmë juve një popull të drejtë (një mes të zgjedhur) për të qenë ju dëshmitarë (në ditën e gjykimit) ndaj njerëzve, dhe për të qenë i dërguari dëshmitar ndaj jush...”* (Bekare, 143).

Legjislacioni islam është rrugë e mesit ndërmjet ateistëve të cilët nuk besojnë në Zot, të cilët ia zënë frymën natyrshmërisë që gjendet në gjoksin e tyre, të cilët e kundërshtojnë logjikën, dhe ndërmjet politeistëve që besojnë në shumë zota, të cilët i adhurojnë kafshët, idhujt, gurët, etj..

Islami fton të besohet në një Zot të vetëm i Cili nuk ka shok, i Cili nuk është i lindur e as që ka lindur dikë dhe i Cili nuk ka rival; proklamon të vërtetën se gjithçka jashtë Tij është krijesë e cila nuk mund të bëjë as dëm e as të sjellë dobi, as të marrë shpirt, as të dhurojë jetë e as të ringjallë dikë. Adhurimi i krijesave është idhujtari, padrejtësi dhe devijim i qartë: *“Kush është më i humbur se ai që pos Allahut lut diç që nuk i përgjigjet atij deri në kiamet, pse ata (që luten) janë gafilë ndaj lutjes së tyre.”* (Ahkaf, 6).

Islami paraqet mesin ndërmjet atyre të cilët konsiderojnë se universi është ekzistenca e vetme e vërtetë, kurse gjithçka tjetër që s'është dot nga syri dhe s'preket nga dora është legjendë dhe ëndërr, dhe atyre që gjithësinë e konsiderojnë iluzion dhe vegim.<sup>13</sup>

Islami është mes ndërmjet atyre që e hyjnizojnë njeriun dhe i përshkruajnë atij attribute hyjnore, konsiderojnë se mund të bëjë ç'të dojë, dhe atyre që janë bërë robër të determinizmit ose fatalizmit ekonomik, shoqëror ose fetar, të cilët veten e konsiderojnë pëlhurë ose marionetë, penjtë e së cilës i luan shoqëria, ekonomia ose fati.

Njeriu në botëkuptimin islam është krijesë e ngarkuar me detyra, krijesë që do të japë përgjegjësi, zotëri i gjithësisë, rob i Allahut, i aftë ta ndryshojë atë që e rrethon në korrelacion me ndryshimin e vetvetes: *“...Allahu nuk e prish gjendjen e një populli (nuk ua largon të mirat) përderisa ata ta ndryshojnë veten e tyre...”* (Rad, 11).

Islami është mes ndërmjet atyre që i shenjtërojnë pejsamberët, madje i ngrenë në pozitë të Zotit ose bijve të Zotit dhe atyre që i përgënjeshtrojnë dhe i akuzojnë ata.

Islami është mes ndërmjet atyre që besojnë në arsyen si burim i vetëm i njohurisë mbi ekzistencën dhe atyre që i besojnë vetëm shpalljes dhe frymëzimit, dhe të cilët arsyen nuk e konsiderojnë për udhëheqës në sferën e mohimit ose të vërtetimit.<sup>14</sup>

## PËRFUNDIM

Islami ka sjellë këtë legjislacion duke i dhënë edhe atributet që e dallojnë nga legjislacionet njerëzore, ngase ekzistenca e tij është nga Allahu dhe buron nga elementi hyjnor, e jo nga ai njerëzor!

Ndonëse ky legjislacion është hyjnor, Allahu e bëri atë human e të përshtatshëm për njeriun si krijesën më të ndritur në univers dhe ligjet e tij i bëri plotësisht të përshtatshme me vetë natyrshmërinë e njeriut. E kompletoi në formën më të mirë duke mos lënë vend për njeriun që të shtojë apo të heq ndonjë pjesë. Mbi të gjitha, këtë legjislacion e bëri realist si në ligjëvënie, ashtu edhe në sferën e adhurimeve.

Ndonëse këtu kemi përmendur vetëm disa nga këto segmente, e kemi lënë shumë segmente të tjera pa trokitur në derën e tyre.

1 Kardavi, Jusuf, *Med'hal Lidiraseti-sh-Sheriati-l Islamijeh*, fq. 132.

2 Po aty, fq. 134.

3 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 76.

4 Shih: Ibni Maxhe në Sunen, nr. 1731.

5 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 77.

6 Ibën Hibani në Sahih, nr. i hadithit 475, 530.

7 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 137.

8 Op. Cit.:fq. 137.

9 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 138.

10 Për më tepër ktheju librit: Kutb, Sejid, *Hasaisu-t Tesavvur el-Islamij ve Mukavvematuhu*, fq. 117-124.

11 Ebu Sad, Muhamed ibën Muhamed, *Bejanu-l Hikmeti fi-t Teshrii-l Islamij*. Revista Mexheletu-l Buhuth el-Islamijetu, nr. 34, fq. 188.

12 Ismail, Hisham, *El Hasais el Mumejezeh Limenhexh Ehlu-Suneti ve-l Xhemaati*. Revista Bejan, nr. 32, fq. 9.

13 Kardavi, Jusuf, *Veçoritë e përgjithshme të islamit*, fq. 145-146.

14 Op. Cit.:fq. 147.

# Shkolla, vendi ku mund të jetësohet urdhri i parë hyjnor

Mr. Sead Paqarizi

Islami si fe, në fokusin e tij ka njeriun, laftësimin e tij për jetën e kësaj dhe botës tjetër, mësimin e tij për Krijuesin, krijesat e Tij dhe gjithçka që e rrethon në këtë botë. Kjo mund të arrihet përmes mëimit, edukimit dhe dijes, të cilat arrihen në shkollë.

## ÇFARË ËSHTË SHKOLLA?

Shkolla është një institucion edukativo-arsimor, ku nxënësit marrin mësim dhe arsimim nga mësimdhënësit në lëndë të ndryshme shkencore, akademike, shoqërore dhe kulturore. Andaj shkolla është vendi ku nxënësit zhvillojnë aftësi dhe njohuri që u nevojiten për jetën dhe përgatitjen e tyre për të ardhmen. Shkolla ka një strukturë të caktuar organizative dhe ndjek një kurrikulë të caktuar, e cila përcakton çfarë mësimesh dhe me çfarë metoda do të veprohet. Në aspektin social, shkolla vlerësohet si një institucion social në të cilin funksionon një komunitet i pavarur, ku rolet u shpërndahen atyre që duan të marrin pjesë në jetën e të rriturve dhe të tillat janë të diferencuara për të kryer këto aktivitete.

## HISTORIKU

Shkollat më të vjetra të njohura në histori gjenden në Mesopotami, ku u shpik shkrimi.

Xhamia e Pejgamberit a.s. në Medine së bashku me mësonjëtoaren Suffe ishte qendra e parë institucionale e shkollimit të besimtarëve.

Aty u gjetën mbetje ndërtesash me stola prej guri ose qerpiçi për t'u ulur nxënësit. Dokumentet kuneiforme përmbajnë informacione të ndryshme për lëndë të ndryshme, si dhe metodat dhe nivelet e mësimdhënies së këtyre shkollave, marrëdhëniet nxënës-mësues, prind-mësues dhe tema të ngjashme.<sup>1</sup> Në histori arabët përgjithësisht janë njohur si një shoqëri analfabete, për shkak të pamundësisë së ndërtimit të një institucioni shkollor, si shoqëri që jetonin një jetë nomade. Gjatë epokës së injorancës, nuk ka asnjë informacion për ekzistencën e shkollave që mësojnë lexim dhe shkrim në qytetet si Meka dhe Medina. Po ashtu edhe individët të cilët dinin shkrim-lexim ishin të pakët, kryesisht që kishin mësuar jashtë këtyre vendeve.

## URDHRI I PARË HYJNOR

Shpallja e fundit që i zbriti Muhamedit a.s. ishte përmbyllje e të gjitha shpalljeve të mëparshme, njëkohësisht edhe shpallje, e cila do i përgjigjej nevojave të të gjithë njerëzve, duke qenë kandil ndriçues dhe burim i njohurive deri në ditën e fundit. Kjo dëshmohet edhe me atë që shpallja filloi me zbritjen e urdhrit të parë, që ishte LEXO. Allahu xh.sh. shpalljen e filloi me zbritjen e ajeteve të para të sures Alek, ku thotë: “Lexo



*me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar! Është Ai që ua mësoi pendën. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.” (Alek, 1-5).*

Muhamedit a.s., i cili ishte i zgjedhuri i Allahut për misionin më të rëndësishëm, sa të privilegjuar, po aq edhe me përgjegjësi, por që nuk dinte shkrim-lexim, ju bë e ditur që tani po fillonte një epokë, ngritja dhe zhvillimi i së cilës do të bazohej në lexim, dije, meditim, hulumtim, kërkime e studime.<sup>2</sup> Po ashtu kjo nënkuptonte që tanimë kishte përfunduar edhe zbulesa hyjnore përmes shfaqjes që mrekullive për të qetësuar apo kënaqur zemrat, siç kishte ndodhur të shumë popuj dhe pejgamberë paraprak.

Fillimi i shpalljes me urdhrin hyjnor për të lexuar në emër të Zotit, ishte një indikacion që do të orientonte besimtarët drejt zhvillimit dhe arritjeve përmes dijes. Këtu fshihej urtësia e zanafillës së shkollës, vendit ku mësimi, edukimi, arsimimi dhe dija do të lulëzonin, e që njëkohësisht kjo do të jetësonte urdhrin e parë hyjnor.

Meqë Shpallja filloi me urdhrin për lexim, edhe Pejgamberi a.s., praktikat e tij i kishte të fokusuar në jetësimin e këtij urdhri. Kështu edhe besimtarët e parë, duke parë kërkesën hyjnore dhe nxitjen e Pejgamberit a.s. për lexim, që në vitet e para të Islamit, i dhanë prioritet të veçantë mësimi, studimit, edukimit dhe arsimimit. Në fillim ishin të fokusuar për të njohur dhe mësuar obligimet fetare, ndërsa për të praktikuar këto obligime si namazin, agjërimit, zekatin etj., besimtarët duhet të mësonin edhe disiplinat e tjera shkencore si gjeografi, astronomi, mjekësi etj.. Andaj mund të

konkludohet që këto ishin edhe arsyet e para që nxitën besimtarët të rrisin dhe zgjerojnë aktivitetin e përvetësimit të njohurive të disiplinave të ndryshme fetare dhe shkencore.

## MËSONJËTORJA E PARË

Pejgamberi a.s. ishte shembulli më i mirë i mësuesit, me përkushtimin e tij të jashtëzakonshëm u përkujdes për sahabët që të mësojnë dhe përvetësojnë njohuritë fetare, shkencore, sociale etj.. Kështu ai caktoi shtëpinë e Erkam b. Erkamit si mësonjëtorë, në të cilën sahabëve fillimisht ju mësonte Kuranin dhe rregullat parimore të Islamit. Duke pasur parasysh që ishin duke kaluar momente të vështira të trysnisë së mushrikëve, në këtë “shkollë”, sabahët i edukonte që krahas përvetësimit të Kuranit, të mësonin edhe besimin, qëndrueshmërinë dhe durimin përball sfidave të kohës. Po ashtu Pejgamberi a.s. kishte dërguar Musab b. Umejrin në Medine si mësues të njohurive fetare.

## HIXHRETI DHE SHKOLLA

Pas hixhretit në Medine vërehen celulat e institucionit të parë shkollor. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për vendndodhjen, flitet për një mësonjëtorë në të cilën kanë mësuar individ të ndryshëm.<sup>3</sup> Po ashtu është më se i njohur edhe rasti, kur në luftën e Bedrit, Pejgamberi a.s. urdhëroi të lirohen robërit e luftës në këmbim të mësimi të shkrim-leximit të dhjetë fëmijëve mysliman. Ali bin Muhamed el Huzai përcjell se ishte formuar një mësonjëtorë në të cilën një jobesimtar ua mësonte shkrim-leximin fëmijëve të myslimanëve. Sipas disa të dhënave tregohet që edhe shkruesi i



njohur i shpalljes Zejd b. Thabit, ishte njëri prej këtyre që kishte marrë mësim në këtë mësonjëtorë.<sup>4</sup>

Urdhri i Pejgamberit a.s. për lirimim e robërve, të cilët ua mësojnë shkrim-leximin dhjetë fëmijëve myslimanë, është një dëshmi tjetër e fuqishme që tregon vendosmërinë e jetësimit të urdhrin të parë hyjnor. Me ndërtimin e xhamisë në Medine, pranë saj ishte improvizuar një vend nën hije për mësim, e quajtur Suffe dhe kështu kishte filluar edhe mësimi dhe edukimi i rregullt i besimtarëve.<sup>5</sup> Andaj Xhamia e Pejgamberit a.s. në Medine së bashku me mësonjëtorin Suffe ishte qendra e parë institucionale e shkollimit të besimtarëve. Përveç kësaj, në lagje kishin filluar të ndërtoheshin shkolla të veçanta për fëmijë të quajtura Kuttab. Me kalimin e kohës këto shkolla ju bashkëngjiten xhamive të lagjeve.<sup>6</sup>

### SHKOLLA PAS VDEKJES SË PEJGAMBERIT A.S.

Me përhapjen e Islamit në vende të ndryshme, filloi edhe ndërtimi i xhamive, të cilat në të njëjtën kohë ofronin hapësirë për mësim dhe shkollim. Në kohën e udhëheqësve të drejtë, përveç njohurive fetare, duke u mbështetur në porositë pejgamberike, filloi edhe mësimi i notit, kalërimit, gjuajtjes etj.. Xhamia e Amër b. Asit në Kajro dhe Xhamia Emevi në Damask janë shembulli adekuat i funksionimit të tyre edhe si shkolla, në të cilat u mësuan edhe lëmi të ndryshme shkencore. Përveç xhamive, pas një periudhe, filloi mësimi special i fëmijëve edhe na pallate. Kryesisht këtu mësoheshin lëmi të veçanta për vijuesit, sipas pozitës dhe përgjegjësisë që do të merrnin në të ardhmen.

Gjatë shekujve të parë, metodat e mësimin, shkollat dhe mësonjëtorët u zhvilluan dhe avancuan në dritën e urdhrin të parë hyjnor. Në kohën e abasitëve, arsimimi dhe edukimi filloi të institucionalizohet dhe xhamitë vazhduan të funksionin si qendra të mësimin dhe arsimin. Me intensifikimin e përkthimeve dhe rritjen e interesimit për veprat klasike helene, hinduse etj., në Bagdad u themelua qendra kërkimore Bejtulhikme, e cila në periudhën e Memunit u shndërrua në një institucion të lartë shkollor dhe edukativ.<sup>7</sup>

Me rritjen e hallkave të mësimin dhe studimit, lindi nevoja e themelimit të shkollave të ndara nga xhamitë, me qëllim që mos të pengohej kryerja e ibadeteve në xhami. Krahas kësaj u themeluan edhe librari dhe kuranoteka, të cilat ndihmuan edhe më shumë jetësimin e urdhrin të parë hyjnor. Në periudhën e fatimive, në Kajro u ndërtua xhamia e Ezherit, e

Edhe në periudhën emevite në Andaluzi (umajadëve andaluzian), në Kurtuba ishin hapur shkolla të shumta, në të cilat, ndër të tjera, mund të veçohet lulëzimi i gjuhës dhe letërsisë.

cila ishte qendra e parë për arsimim dhe edukim, e pasuar me ndërtimin e Darulhikme, që po ashtu ishte një institucion i veçantë, ku krahas mësimin fetare, filluan të mësoheshin edhe shkencat e tjera, si politika, astronomia, gjeometria etj..<sup>8</sup> Me kalimin e kohës në këtë shkollë filloi të dominoi doktrina fatimite, e që shkaktoi që këto qendra të shndërrohen në qendra të propagandës shiite.

Edhe në periudhën e selçukëve, shkolla ishte në epiqendër të vëmendjes, ku u ndër-tuan medrese të reja, e që mund të veçohen për shkak të rolit të tyre, siç është Medreseja Nizamije e Bagdatit,<sup>9</sup> e ndërtuar në kohën e Alparslanit, funksionimi i së cilës ishte i mbështetur përmes vakëfeve. Mësimi i detajuar i fraksioneve, ndarja e degëve shkencore dhe mësimi i disiplinave dhe degëve të shumta shkencore, reflektojnë më së miri në jetësimin e urdhrin të parë hyjnor në këto shkolla, numri i së cilave u rrit me shpejtësi.<sup>10</sup>

Edhe në periudhën emevite në Andaluzi (umajadëve andaluzian), në Kurtuba ishin hapur shkolla të shumta, në të cilat, ndër të tjera, mund të veçohet lulëzimi i gjuhës dhe letërsisë. Medreseja e Kurtubasë, ishte shkolla më e rëndësishme e kësaj periudhe, në të cilën mësuan shumë nxënës nga Perëndimi, Afrika dhe Azia, myslimanë dhe jomyslimanë.

### OSMANËT, SHKOLLA DHE URDHRI I PARË HYJNOR

Në Perandorinë Osmane, arsimit dhe edukimi ishin në fokusin e secilit udhëheqës, të cilët u kujdesen për ndërtimin e shkollave pranë çdo xhamie dhe qendrave të tjera të rëndësishme në vendet ku udhëhiqnin. Osmanët vazhduan aktivitetet e tyre arsimore në medrese me mbështetjen e vakëfeve. Dijetarët vlerësoheshin dhe gëzonin autoritetet te masa e gjerë, gjë që bëri shumë studiues dhe admirues të dijes nga Irani, Horasani, India, Buhara, Halepi, Egjipti etj., të dynden në Stamboll dhe Stambolli për një kohë të shkurtër u bë qendër e studimeve shkencore të botës islame.<sup>11</sup> Në territorin e Perandorisë Osmane, krahas medreseve, të cilat vepronin në dritën e urdhrin të parë hyjnor dhe karakterizoheshin me mësimin e lëndëve fetare dhe jo vetëm, ishin hapur edhe shkolla të tjera, si: Iptidaje (shkolla fillore), Rushdije (gjimnaze të ulëta), Idadije (gjimnaze), Darul-mualimin (shkolla normale) etj..<sup>12</sup>

Të gjitha këto zhvillime në fushën e edukimit dhe shkencës synonin ngritjen në nivelin më të lartë të shoqërisë njerëzore,



duke i mundësuar njeriut edhe njohjen dhe arritjen e synimeve të krijimit dhe jetësimin e urdhrin të parë, ikre-lexo.

### SFIDAT E SHKOLLËS NDËR SHEKUJ

Shkolla është një nga institucionet më të sfiduara gjatë zhvillimeve të rëndësishme historike. Shpikja e shkrimit, diversifikimi i sistemeve të mendimit, shpikja e energjisë elektrike dhe motorit me avull, zhvillimi i bujqësisë, revolucioni industrial, realizimi i shpikjeve të reja teknologjike etj., ndikuan në sistemet arsimore dhe për rrjedhojë edhe në institucionin shkollor. Edhe shkollat me karakter fetar apo ato të cilat kanë përvetësuar si mision të tyre jetësimin e urdhrin të parë hyjnor, nuk kanë qenë të amnistuara nga ngjarjet, ndryshimet dhe zhvillimet socio-kulturore përgjatë historisë. Ndikimi dhe instrumentalizimi politik, mungesa e mbështetjes së vazhdueshme profesionale dhe materiale, ndikimet ideologjike, mungesa e një sistemi unik dhe faktorë të ngjashëm, mund të numërohen si disa prej sfidave të shkollave ndër shekuj.

### SHKOLLA, BURIM I ATDHEDASHURISË

Çdo shoqëri synon arritjen e më të mirës, të cilën mund ta mësojë përmes dijes dhe studimit. Kjo ka nxitur që në çdo periudhë shkollat të luajnë një rol të pazëvendësueshëm në shoqëri.

Edhe shoqëria jonë shqiptare, duke qenë pjesë e një pozite të rëndësishme gjeostrategjike mes Lindjes dhe Perëndimit, përgjatë historisë është ndikuar dhe ka përvetësuar metodat dhe praktikatat nga shkollat dhe qendrat shkencore të Lindjes dhe Perëndimit. Shkollat fetare, si: medresetë, mejtepet dhe mektebet kanë funksionuar që nga e kaluara dhe vazhdojnë edhe sot të kontribuojnë për mësimin dhe studimin e njohurive fetare, sociale, kulturore dhe kombëtare. Këto shkolla kanë dëshmuar kontributin e gjithanshëm për

kombin dhe vendin tonë, veçanërisht për atdhedashurinë, duke mundësuar mësimin e historisë dhe gjuhës shqipe në periudhat më të vështira të sundimit famëkeq slavo-serb, dhunës dhe luftës së tyre ndaj çdo elementi kombëtar e fetar shqiptar, periudha në të cilat ka qenë e ndaluar mësimi i gjuhës shqipe etj.<sup>13</sup>

### PËRFUNDIM

Çdo krijesë ka qëllimin e krijimit, duke përfshirë edhe njeriun si krijesa më e përsosur dhe privilegjuar, që ka për qëllim të krijimit njohjen dhe adhurimin e Krijuesit, përmes zhvillimit intelektual, ngritjes shpirtërore dhe shkencore dhe leximit e dijes. Kjo vërtetohet edhe në tekstet fetare,<sup>14</sup> gjegjësisht përmes urdhrin të parë hyjnor dhe jo vetëm. Andaj shkollat janë ato vende që më së miri mund të jetësohet urdhrin i parë hyjnor dhe qëllimi esencial i krijimit të krijesës së dalluar dhe privilegjuar me intelekt. Roli i shkollave në jetësimin e urdhrin të parë hyjnor vërehet në çdo periudhë dhe etapë gjatë historisë. Sa më të avancuara shkollat dhe institucionet e arsimit dhe edukimit, po aq do të mundësohet jetësimi i tërësishëm i urdhrin të parë hyjnor dhe parimeve të tjera fetare, të cilat nxisin përgatitjen e individit dhe shoqërisë të mirëformuar dhe stolitur me dije dhe njohuri, të cilat e avancojnë në këtë botë dhe sigurojnë lumturinë edhe në botën tjetër. Perfeksionimi i institucioneve shkollore të të gjitha niveleve, siguron shoqëri me prosperitet dhe gjenerata, të cilat do të kontribuojnë për fe dhe atdhe. Andaj shkolla do të vazhdojë deri në kataklizëm të jetë vendi kryesor i jetësimin të urdhrin të parë hyjnor.

- 1 Tugba Ateş, *21. yzylda Eğitimde Dönüşüm ve Okullar*, Shtëpia Botuese Neu, Konya 2020, f.18.
- 2 Dr. Ejup Haziri, "Lexo", *Urdhri i parë hyjnor që ngriti civilizimin islam*, Dituria Islame, nr.394, shtator 2023, f.6.
- 3 Nebi Bozkurt, *Mektep*, DIA, v.29, Ankara 2004, f.5
- 4 Shih Nebih Bozkurt, f.6.
- 5 Mustafa Baktır, *Suffe*, DIA, v.37, Stamboll 2009, f.439.
- 6 Hasan Dam, *Camilerde Din Eğitimi ve Sorunları*, 2018, f.275
- 7 Mahmut Kaya, *Beytulhikme*, DIA, v.6, Stamboll 1992, f.89.
- 8 Mahmut Kaya, *Darulhikme*, DIA, v.8, Stamboll 1993, f.537.
- 9 Kjo është prej medreseve më të njohura, e cila kishte klasë, dhoma të veçanta për mësuesit dhe nxënësit, mesxhidin, librari, bujtinën, mensën, hamamin etj.. Afër saj ishte ndërtuar një pazar, fitimi i të cilit përdorej për nevoja të kësaj medreseje (shih: Abdulkarim Ozaydan, *Nizamiye Medresesi*, DIA, İstanbul 2007, v.33).
- 10 Ziya Kazıcı, Ayhan Halis, *Talim ve Terbiye*, DIA, Stamboll 2010, f.518.
- 11 Kemal Karpat, *Politizimi i Islamit*, Tiranë 2016, f.140-141.
- 12 Aliriza Selmani, *Shkollat Fetare Islame në Kazanë e Gjilanit*, Prishtinë 1995, f.435.
- 13 Resul Rexhepi, *Medreseja e Mesme "Alauddin" në shtratin e traditës dhe roli i saj për shkollimin e kuadrin fetar*, Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptar, Prishtinë 1995, s.553-555; Po ashtu shih: (Zani i Naltë – Kontributi i medresesë "Alauddin" për arsimin fetar dhe kauzën kombëtare gjate viteve 1985-1995 (zaninalte.al).
- 14 Kurani Kerim, 51:56.

# Familja ideale në këndvështrimin kuranor

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Familja, fillet e së cilës nisin me njeriun dhe pejgamberin e parë, si institucioni më i fuqishëm që ka ekzistuar deri në ditët e sotme, në kohën e fundit fatkeqësisht është duke u përballur me kërcënime të ndryshme. Një ndër më të dukshmet është rritja e shkallës së divorcit për arsye të ndryshme. Po ashtu mungesa e mjedisit familjar dhe rritja e brezave nga lidhjet jashtëmartesore janë kërcënime të tjera për familjen. Këto kërcënime ndaj familjes janë në fakt kërcënime për të gjithë njerëzimin. Prandaj duhet kërkuar rrugën e ekzistencës cilësore të njeriut, përtej ekzistencës së tij ontologjike/biologjike, e cila vije në shprehje përmes një martese të ligjshme dhe familjes së krijuar nga kjo martesë.

Familja si institucion i shenjtë përmendet në shumë ajete kuranore, e në veçanti vihet në theks familja e Ibrahimit a.s.,<sup>1</sup> e cila për shkak të cilësive edukative, mbrojtëse dhe udhëheqëse është trajtuar si tip ideal i familjes. Po ashtu

familja e Ademit a.s. dhe Muhamedit a.s. janë trajtuar si familje shembullore për shkak të sakrificës, përkushtimit, sinqeritetit, pastërtisë, dhe të ngjashme që përmbanin ato. Pra, shembulli institucional i familjes në Kuran pasqyrohet përmes familjeve të tilla shembullore.

## KONCEPTI I FAMILJES

Familja është institucioni i vetëm që ekziston me vetë njeriun e parë dhe që me të është për qëllim bashkimi dhe afrimi i njerëzve në mes vete. Struktura biologjike e njeriut, nevoja e tij/saj për mbrojtjen dhe ruajtjen e vazhdimësisë kërkon ekzistencën e një qenie njerëzore të shoqëruar. F.v., Ademi a.s. me bashkëshorten e tij formuan familjen e parë në historinë njerëzore. Prandaj, njeriu/individit është konsideruar si blloku ndërtues i shoqërisë, ndërsa familja është parë si institucioni më themelor i saj. Në këtë aspekt, familja është pranuar gjithashtu si burimi i civilizimit. Siç dihet, njeriu i parë është krijuar me rolin e halifes (mëkëmbësit) duke qenë përgjegjës për zhvillimin e jetës në tokë, dhe duke u ngarkuar me detyrën për të mbajtur rrjetin e tij shumëdimensional të marrëdhënieve me Zotin e tij, me shoqërinë dhe me gjërat e tjera në bazë të drejtësisë. Gjithashtu, është informuar për ekzistencën e një sërë të drejtash dhe përgjegjësisë ndaj vetes dhe të tjerëve. Theksohet se hz. Ademi i ka edukuar fëmijët e tij brenda kornizës së këtyre të drejtave dhe përgjegjësisë.

Megjithatë, sa herë që njeriu e ka shkelur këtë kornizë të përcaktuar, Zoti i Madhërisëm dërgoi vazhdimisht pejgamberë për ta rikthyer atë në natyrshmëri, pra në rrugën e drejtë.<sup>2</sup> Ky ligj hyjnor ka vazhduar deri tek i Dërguari i fundit, Muhamedi a.s., për të cilin në Kuran thuhet: “O ti Pejgamber, Ne të dërguam ty dëshmuar, lajmëtar përgjësues e qortues dhe me urdhrin e Allahut, thirrës për në rrugën e Tij dhe pishtar



*ndriçues.*<sup>3</sup> Si rrjedhojë, ndër temat kryesore të kësaj shpalljeje po ashtu është përcaktimi i kornizës së këtyre të drejtave dhe përgjegjësive të cilat janë përcjellë herë pas herë nga çdo pejgamber. Kjo kornizë, përveçse përcakton kufijtë e lirisë së vërtetë të njeriut, gjithashtu cakton edhe kufijtë e së drejtës së tij për të ekzistuar. Në këtë kontekst, familja është pothuajse një miniaturë e formës së parë të ekzistencës së njeriut në shoqëri ku ai lind si individ dhe fiton një kuptim shoqëror.

### FAMILJA NË DITËT E SOTME

Në ditët e sotme ku ndryshimi sekular në sistemet e marrëdhënies që ndodhin qoftë në nivel kombëtar ose global ka ndikuar në fushat teknologjike, ekonomike, sociale dhe kulturore, bashkë me këto edhe industrializimi, urbanizimi i shpejtë dhe valët e brendshme dhe të jashtme të emigracionit kanë dobësuar karakterin e familjes si një institucion mbrojtës dhe gjithëpërfshirës. Familja tradicionale është shpërbërë, divorci është rritur dhe familjet e ndara me një prind janë shtuar me shpejtësi në emër të një “familjeje moderne/bashkëkohore.” Po ashtu rritja serioze e varësisë nga droga, devijimet seksuale dhe krimet e tjera të zakonshme që kanë përfshirë të rinjtë, janë tregues të konsumimit dhe zhdukjes së vlerave që duhet të mbizotërojnë në familje.<sup>4</sup> Sistemet e komunikimit, mediat masive të zhveshura nga vlerat familjare, luhatjet ekonomike dhe varfëria që ndodhin në nivel kombëtar dhe global njashtu kanë sjellë me vete degradim moral dhe kulturor dhe po dobësojnë gjithnjë e më shumë institucionin e familjes.

Struktura familjare, e cila dita-ditës po humb ndikimin e sistemit të vlerave fetare dhe morale dhe gjithnjë e më shumë po i ngjan modelit të familjes perëndimore, po i nënshtrohet ndryshimeve të shpejta strukturore dhe formale duke marrë forma të ndryshme të cilat janë shkaktare të humbjes së madhe të vlerave të saj. Roli social dhe statusi i gruas, që përbën shtyllën kurrizore të familjes, janë bërë të pakuptueshme nga lëvizjet feministe, duke kufizuar institucionin e familjes në diskutime për epërsinë e burrit apo të gruas. Si rezultat i të gjitha këtyre, “familja moderne/bashkëkohore” ka humbur në masë të madhe funksionet e saj të mbrojtjes dhe gjithëpërfshirjes, që janë thelbësore për

Rikthimi i familjes në një kala të fortë, është i mundur duke mbushur boshllëqet, duke rifituar karakteristikat e saj tradicionale, mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse, duke u bërë më rezistente ndaj fuqive dhe rrethanave globale, duke u bërë dinamike dhe funksionale, dhe duke e rikthyer sistemin e vlerave shpirtërore që e mbështetin atë.

institucionin e familjes. Andaj, familja në shekullin XXI vazhdon të jetë në qendër të shumë diskutimeve biologjike, sociologjike, ekonomike dhe politike. Mirëpo rikthimi i familjes në një kala të fortë, është i mundur duke mbushur boshllëqet që ka lënë, duke rifituar karakteristikat e saj tradicionale, mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse, duke u bërë më rezistente ndaj fuqive dhe rrethanave globale, duke u bërë dinamike dhe funksionale, dhe duke e rikthyer sistemin e vlerave shpirtërore që e mbështetin atë. Po ashtu përmbushja e të drejtave dhe përgjegjësive të ndërsjella midis burrit dhe gruas dhe anëtarëve të tjerë të familjes të përcaktuara në Islam përmbajnë një rol të pakontestueshëm në ruajtjen dhe vazhdimësinë e sistemit të lartë familjar.

### FAMILJA NË KËNDVËSHTRIMIN KURANOR

Në Kuran, familja përmendet me disa shprehje dhe terma që theksojnë rëndësinë e institucionit të saj, bashkëjetesës dhe përgjegjësive të ndërsjella midis anëtarëve të familjes brenda një hapësire të përbashkët. Si rrjedhojë termi “ehl-i bejt” përmendet tre herë në Kuran në ajetet në vazhdim: “*Ata i thanë: “Si, mos po çuditesh me caktimin e Zotit?” Mëshira e Allahut dhe bekimi i Tij qoftë me ju o familje e shtëpisë.*” (Hud, 73); dhe “*Allahu ka si qëllim që nga ju, o familje e shtëpisë të largojë ndyrësinë e mëkateve dhe t’ju pastrojë deri në skaj.*” (Ahzab, 33). Ky term është përdorur për të shprehur bashkëshortet dhe familjet e Ibrahimit a.s. dhe Muhamedit a.s., kurse në kaptinën El Kasas, me këtë term është shënuar gruaja si

figura më e rëndësishme e familjes, roli i nënës dhe familja si mjedisi i parë i rritjes së fëmijës<sup>5</sup> duke thënë: “*Ndërsa Ne ia patëm ndaluar atij më parë thithjen e gjirit, e ajo (motra e Musait) tha: “A doni t’ju tregoj për një familje, që do të kujdeset për të dhe që do të jenë të sinqertë ndaj tij?”*” (Kasas, 12).

Në Kuran, konceptit familje i referohet edhe shprehja “al” e cila është përdorur në njëzetepesë ajete kuranore<sup>6</sup> ku në katërmbëdhjetë prej tyre i referohet familjes së Faraonit, të afërmeve, mbështetësve dhe atyre që janë në fenë e tij,<sup>7</sup> ndërsa një tjetër kontekst në të cilin përdoret fjala “al” në Kuran është përshkrimi i familjeve të veçanta, siç janë familja e Lutit a.s.,<sup>8</sup> Ibrahimit a.s.,<sup>9</sup> familja e Imranit a.s.,<sup>10</sup> Jakubit a.s.,<sup>11</sup> Davudit a.s.<sup>12</sup> dhe Musait a.s.<sup>13</sup>

## SHEMBUJ TË FAMILJEVE IDEALE NË KURAN

Metoda e sjelljes së shembujve në Kuran është një teknikë didaktike e përdorur për të ilustruar mësimet dhe për të ndihmuar në kuptimin e mesazheve të tij. Këta shembuj ndihmojnë në përvetësimin dhe aplikimin e mësimave të Kuranit në jetën e përditshme, duke e bërë më të lehtë për besimtarët të kuptojnë dhe të praktikojnë atë në formën e duhur. Të këtillë janë edhe shembujt mbi pejgamberët të sjellë në formë të pasazheve në Kuranin famëlartë. Pa dyshim që pejgamberët luajnë rol të rëndësishëm dhe udhëheqës në çdo fazë të jetës në shoqëritë nga të cilat vijnë dhe për këtë përmenden edhe në Kuran. Mirëpo siç kërkohet stili i veçantë i Kuranit, ai nuk e përshkruan strukturën dhe stilin e jetesës së një familjeje pejgamberike në tërësi, por përqendrohet në cilësitë dhe tiparet ideale që dallohen te pejgamberët e ndryshëm.

Pa dyshim kur renditen familjet e përmendura në Kuran, familja e Ademit a.s. me bashkëshorten Havën zënë vendin e parë, ngase ai si njeriu dhe pejgamberi i parë së bashku me bashkëshorten e tij janë krijuar me të gjitha aftësitë dhe përgatitjet e nevojshme për të kryer rolin e zhvillimit, menaxhimit dhe udhëheqësisë së familjes. Në këtë kontekst, në Kuran përmendet që Zoti i Madhërishëm pasi e krijoi dhe i dha formën më të bukur (A'la, 2-3) Ademit a.s., i mësoi atij emrin e të gjitha gjërave dhe e pajisi atë me aftësinë për të menduar (Bekare, 31), për të shpjeguar atë që kishte mësuar (Rrahman, 4), dhe për të shkruar me pendë (Alek, 4). Nga e gjithë kjo kuptohet që Ademi a.s. është pajisur me potencialin për të ndikuar në zhvillimin e jetës në tokë dhe është edukuar dhe përgatitur në frymën e një udhëheqësi, mäkëmbësi dhe kryefamiljari. Siç theksohet edhe në ajetin kuranor: *“Burrat janë përgjegjës për gratë, sepse Allahu ka graduar disa mbi disa të tjerët”* (Nisa, 34), që thekson se epërsia e burrave ndaj grave nuk është epërsi komanduese, por detyrë përgjegjëse dhe aftësi për të përmbushur këtë përgjegjësi me përkujdesje dhe plotësim të të gjitha nevojave, mbikëqyrjes dhe mbrojtjes së saj.<sup>14</sup> Po ashtu, Kurani vë në pah krijimin e Ademit a.s. dhe Havës dhe strukturën familjare që ata formuan (A'raf, 189) dhe thekson se si do të vazhdojë brezi i njerëzimit (Nisa, 1). Pastaj përmend se ata u vendosën në Xhenet dhe më pas u nxorën që andej (A'raf, 19). Pas daljes dhe takimit të tij me bashkëshorten e tij Havën, ata filluan të zhvillojnë jetën në tokë duke ndërtuar shtëpinë e parë të quajtur bejtu'l-ma'mur/Qabenë e bekuar. Në këtë mënyrë, Ademi a.s., si arkitekti i parë i tokës, bëhet një shembull ideal për fëmijët e tij dhe për gjithë njerëzimin në fushën e ndërtimit dhe qytetërimit. Kurse Hava, si bashkëshortja e pejgamberit të parë, është edhe gruaja e parë që kontribuoi në ndërtimin e tokës. Ajo është nëna e gjithë njerëzimit dhe themeluesja e jetës së parë familjare në tokë. Për sa i përket përgjegjësisë që mban, personalitetit dhe veprave të saj ajo është një shembull ideal



për të gjithë njerëzimin. Nisur nga këtu, edhe pse fëmijët e tyre shfaqen disa sjellje negative, familja e Ademit a.s. brenda një mjedisi familjar na paraqet mesazhet kryesore dhe shembullin që duhet të marrë familja e sotme.

Në Kuran si familja ideale përmendet edhe ajo e Ibrahimit a.s.. Edhe pse një kaptinë kuranore përmban emrin e tij, aty nuk gjenden shumë informacione lidhur me të dhe jetën e tij, ngase ato janë të shpërndara në njëzetepesë kaptina të ndryshme kuranore, ku shtatëmbëdhjetë prej tyre janë mekase dhe tetë janë medinase. Prej këtu kuptohet se në pothuajse çdo fazë të procesit njëzetetë vjeçar të shpalljes, shembulli i Ibrahimit a.s., në një aspekt ose periudhë të jetës së tij, është mbajtur vazhdimisht në qendër të vëmendjes duke dhënë njohuri mbi fëmijërinë, rininë, jetën martesore, bashkëshortet, fëmijët, babanë e hz. Ibrahimit dhe dialogun e tij me të. Po ashtu flitet mbi martesën e Ibrahimit a.s. me Sarën (Hud, 71-72; Dharijat, 29) dhe pas një kohe dhe me Haxheren dhe bindjen<sup>15</sup> e saj ndaj bashkëshortit, kur ai me urdhrin e Zotit e dërgoi atë dhe birin e saj Ismailin në një vend të largët të pa jetuar më herët.<sup>16</sup> Përpjekjet e shumta të Haxheres dhe Ismailit në këto kushte të vështira, kërkimi i ujit për të birin, dhënia e ujit të Zemzemit nga Allahu i Madhërishëm, dalja e këtij burimi të fshehtë në shkretëtirë në një mënyrë të ngjashme me identitetin e Haxheres, rindërtimi i Qabesë nga Ibrahimit a.s. dhe Ismaili, kanë ndryshuar rolin dhe pozicionin historik të Mekës, pra të një qyteti që ishte i pa jetuar. Nisur nga këtu, familja e Ibrahimit, ku Haxherja si nënë kishte një rol dominues, kishte themeluar qytetin mëmë të Mekës, i cili është vendlindja e Muhamedit a.s., pra është një vend i pazëvendësueshëm dhe i shenjtë për myslimanët anëmbanë botës. Po ashtu Ismaili a.s., i rritur nën

kujdesin dhe edukimin e një nëne mësuese, ofron një model për marrëdhënien që duhet të ekzistojë mes një babai dhe një djali dhe përfaqëson një shembull të një besimi, bindjeje dhe dorëzimi të pakrahasueshëm. Në lidhje me këtë thuhet: *“Përkujtoju në këtë Libër Ismailin! Ai ka qenë shumë besnik në premtim (premtoi të bëhet kurban) dhe i dërguar, peygamber. Ai urdhëronte familjen e vet me faljen e namazit dhe me zeqat, dhe ishte shumë i pranishëm te Zoti i tij.”* (Merjem, 54-55). Kur shihen si një familje ideale në tërësi, përpjekjet e babait - Ibrahimit, nënës - Sarës, nënës - Haxheres, djalit - Ismailit dhe djalit - Ishakut si një familje dhe si individ, tregojnë se familja e Ibrahimit a.s. ka arritur kulmin e dorëzimit ndaj Zotit, durimit dhe mbështetjes tek Allahu i Madhërishtëm. Në këto dhe shumë aspekte, ata shërbejnë si një shembull për të gjithë njerëzimin deri në Ditën e Gjykimit.

Në Kuran ndër familjet ideale, por në veçanti me shprehjen “ehl-i Bejt” përmendet edhe ajo e vulës së gjithë peygamberëve dhe të dërguarit si mëshirë për gjithë njerëzimin (Enbija, 107) pra Muhamedit a.s. “Ehli bejt” – familja e tij zakonisht përkufizohet me gratë, fëmijët dhe ata që ai i kishte marrë nën mbrojtjen e tij. Shembulli i tij si individ dhe si kryefamiljar në Kuran shprehet: *“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut.”* (Ahzab, 21). Taberiu, në interpretimin e këtij ajeti kuranor, shton se ky ajet u zbrit për të qortuar ata nga besimtarët që kundërshtonin Peygamberin a.s. dhe se Allahu xh.sh. me këtë ajet urdhëron që të merret Muhamedi a.s. si shembull në çdo aspekt.<sup>17</sup> Peygamberi a.s. përveç që ishte shembull si individ, ai gjithashtu ishte dhe model në sjelljen e tij me bashkëshortet dhe fëmijët e tij, të cilët janë shtylla e një familjeje të shëndoshë. Për këtë arsye, Kurani shpesh jep informacione në lidhje me bashkëshortet e Muhamedit dhe marrëdhëniet e tyre me të Dërguarin (Ahzab, 32), duke theksuar faktin se misioni i ngarkuar i bashkëshorteve të tij është që, duke zbatuar ajetet e Allahut, të jenë modele të mira për gratë e ymetit në mësimin dhe edukimin e tyre. Ngjarjet që lidhen me familjen e Muhamedit a.s. tregojnë shembullin e tij personal në shumë fusha të jetës dhe ofrojnë një gamë të gjerë përvojash dhe shembujsh (Ahzab, 28-30; Nur, 12-20). Peygamberi a.s. ishte njeriu që ia mësoi dhe rikujtoi njerëzimit se gruaja ishte me të vërtetë qenie njerëzore, asaj i dha krenari, respekt dhe nder, duke ia rikthyer nderin, dinjitetin dhe ndjenjat e shenjtë të dëlirësisë. Marrëdhëniet mes burrit dhe gruas ai i tregoi duke e sjellë veten e tij si shembull në fjalë dhe në vepra, pra ishte personaliteti i tij, i cili hartonte shembuj të ndryshëm pozitivë që do të trashëgoheshin pas shumë shekujve. Kurse bashkëshortet e Peygamberit a.s., duke iu bindur urdhrave të

**Familja ka një rëndësi thelbësore në Kuran, pasi është themeli i shoqërisë dhe një institucion kyç për zhvillimin e besimit dhe moralit.**

Zotit dhe duke qëndruar pranë të Dërguarit përherë, zgjodhën botën e përjetshme dhe të mirat e saj në vend të kësaj bote. Ato me besimin, sjelljet dhe veprat e tyre dhanë një mesazh dhe një shembull për të gjitha kohërat dhe shoqëritë ku dominon materializmi dhe idhujtaria e kapitalit, duke treguar se si duhet të ndërtohet një familje ideale dhe cilat duhet të jenë zgjedhjet dhe bazat e saj.

Familja e Peygamberit a.s. ishte gjithmonë një familje e lumtur, e qetë dhe paqësore, meqë në këtë çerdhe mbizotëronin: vlerat, drejtësia, barazia, toleranca, dashuria, respekti, mirësjellja, siguria, krenaria, dinjiteti, liria, respektimi ndaj të drejtave, durimi dhe sakrificat, simpatia, butësia dhe hatri i ndërsjellë ndaj anëtarëve të familjes. Enesi r.a., një kohë të gjatë kishte qëndruar pranë të Dërguarit dhe raportet e tij familjare i përshkruan në mënyrën më të shkurtër dhe më përfshirëse duke thënë: *“Nuk kam parë*

*njeri më të mëshirshëm se Muhamedi a.s. me anëtarët e familjes së tij.”*<sup>18</sup> Kurse vetë Peygamberi a.s. ka thënë: *“Më i miri prej jush është ai i cili është më i mirë ndaj familjes së tij. Po të merrni shembull prej meje, unë jam më i miri prej jush ndaj familjes sime.”*<sup>19</sup>

Familja ka një rëndësi thelbësore në Kuran, pasi është themeli i shoqërisë dhe një institucion kyç për zhvillimin e besimit dhe moralit. Kurani, përmes shembujve të ndryshëm thekson se një familje e mirë ndihmon në ruajtjen e rendit shoqëror dhe promovon vlera të tilla si dashuria, respekti dhe mbështetja reciproke. Familja është vendi ku bëhet edukimi dhe formimi i karakterit të fëmijëve dhe një burim për forcimin e besimit dhe lidhjeve shpirtërore. Si rrjedhojë, një familje e shëndoshë është e domosdoshme për mirëqenien e individëve dhe shoqërisë në përgjithësi.

- 1 Ali Imran, 33; Nisa, 54.
- 2 Nahl, 36.
- 3 Ahzab, 45-46.
- 4 Kabaklı Çimen, *Türk Töresinde Kadın ve Aile*, 21.
- 5 Ez Zexhxhaxh, *Me'ani'l-Kur'an*, IV/226.
- 6 Ez Zexhxhaxh, *Me'ani'l-Kur'an*, I/130.
- 7 Bekare, 49, 50; Ali Imran, 11; Araf, 130 etj.. (14 ajete kuranore)
- 8 Hixhr, 59-61; Neml, 56; Kamer, 34.
- 9 Ali Imran, 33; Nisa 54.
- 10 Ali Imran, 33.
- 11 Jusuf, 6.
- 12 Sebe, 13.
- 13 Bekare, 248
- 14 Ibën Kethiri, *Tefsiru'l-Kur'ani'l-Adhim*, II/33.
- 15 Taberiu, *Xhamiu'l-Bejan*, 17/24-25.
- 16 Ibrahim, 37.
- 17 Taberiu, *Xhamiu'l-Bejan*, 20/235.
- 18 Muslimi, *“Fedail”*, f. 63
- 19 Ibën Maxhe, *“Nikahu”*, f. 50.

# Deizmi, besim apo arsyetim?

Mr. Adnan Shala

Deizmi lindi në shekullin e XVII dhe XVIII, gjatë periudhës së Iluminizmit, një epokë që vlerësonte arsyen dhe shkencën mbi të ashtuquajturën dogmatizëm fetar.

## HYRJE

Deizmi është një koncept filozofiko-teologjik, që ka dalë në pah gjatë periudhës së Iluminizmit në Evropë. Si një qasje ndaj besimit fetar, deizmi mbështet idenë e një Krijuesi të gjithësisë që nuk ndërhyr në çështjet e përditshme të njerëzve. Ky koncept ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në mendimin filozofik dhe politik të kohës kur është shfaqur dhe vazhdon të luajë një rol të rëndësishëm në diskutimet moderne mbi religionin dhe shkencën, duke u konsideruar si një besim alternativ.

## HISTORIA DHE ZHVILLIMI I DEIZMIT

Deizmi rrjedh nga fjala latine “deus” që do të thotë “Zot” dhe ka të njëjtin kuptim si teizmi, që vjen nga “theos” që do të thotë “Zot” në greqisht. Megjithatë, me debatet filozofike dhe teologjike që filluan në botën e krishterë nga shekulli i XVI, termi teizëm filloi të përdoret për njerëzit që mbronin besimet ortodokse dhe deizmi për mendimtarët që devijuan nga besimet tradicionale. Një nga përdorimet e para të fjalës deizëm e hasim të Pierre Viret. Viret foli për një grup filozofesh dhe letrarësh që morën emrin deistë për t’u dalluar





nga ateistët dhe i akuzoi këta njerëz si ateistë që mohonin Jezhu Krishtin dhe doktrinat e krishterimit, megjithëse ata besuan Zotin dhe besuan se Ai e krijoi botën.<sup>1</sup>

Vendi ku deizmi ishte më i përhapur në Evropë ishte Anglia. Lordi Herbert Cherbury, i cili konsiderohet babai i deizmit anglez, besonte në Zot dhe në jetën tjetër, por kishte dyshime serioze për saktësinë e shkrimeve të shenjta, kritikoi ashpër institucionin e klerit dhe gjithashtu argumentoi se arsyeja do të mjaftonte për të kuptuar të vërtetat universale. Kjo qasje ishte pothuajse revolucionare për arsye se për herë të parë në botën perëndimore mund të pretendohet se e vërteta mund të njihet edhe pa ndërmjetësimin e Kishës dhe klerit.

Deizmi lindi në shekullin e XVII dhe XVIII, gjatë periudhës së Iluminizmit, një epokë që vlerësonte arsyen dhe shkencën mbi të ashtuquajturën dogmatizëm fetar. Figura të njohura si Voltaire, John Locke dhe Thomas Paine ishin disa nga mbështetësit kryesorë të deizmit. Në veprat e tyre, ata promovuan idenë se universi është krijuar nga një Krijues i gjithëdijshëm, por ky Krijues nuk ndërhyr në punët e përditshme të njerëzimit.

## PARIMET KRYESORE TË DEIZMIT

Deizmi ka disa ngjashmëri me teizmin dhe besimet e feve tradicionale si Islami dhe Krishterimi, por gjithashtu ka disa dallime të rëndësishme. Ai mbështetet në disa parime themelore:

**Besimi në një Krijues:** Deistët pranojnë ekzistencën e një Krijuesi që ka krijuar botën dhe universin, por më pas e ka lënë që ky të funksionojë sipas ligjeve natyrore pa ndërhyrje të mëtejshme. Në këtë kuptim, deizmi e pranon rolin e Zotit si krijues, por nuk ofron një përgjigje të qartë për fillimshmerinë e universit, duke lënë hapësirë për interpretimet e ndryshme në lidhje me krijimin e tij që çdo fe e ka versionin e saj.

**Natyrallizmi:** Deizmi thekson rëndësinë e arsyes dhe shkencës në kuptimin e botës dhe refuzon idenë e ndërhyrjeve hyjnore apo mrekullive. Me fjalë të tjera, Zoti nuk ka një lidhje të vazhdueshme me universin apo me

njerëzit. Universi është në lumin e determinizmit pa mundësi shmangieje.

**Distancimi nga dogmatizmi:** Deistët janë shfaqur si një kundërshtim ndaj religjioneve të organizuara dhe dogmave të tyre, duke promovuar një qasje më personale dhe racionale ndaj besimit. Deizmi duhet të kuptohet në kontekstin e përplasjeve me krishterimin që ishte aplikuar në mesjetë.

## DEIZMI DHE KRITIKA E RELIGJIONEVE TRADICIONALE

Deistët kanë shprehur kritika ndaj religjioneve dhe feve, veçanërisht në lidhje me dogmat dhe ritualet e tyre. Ata kanë sfiduar autoritetin e shkrimeve të shenjta dhe pretendimet për ndërhyrje hyjnore, duke promovuar një qasje më racionale dhe skeptike ndaj këtyre temave. Polemikë mes deistëve dhe teologëve tradicionalë kanë qenë të shumta dhe të thella, duke pasqyruar tensionin e vazhdueshëm mes arsyes dhe besimit.

Deizmi beson në një Zot që fillimisht e krijoi botën, por më pas nuk ndërhyr më në të.<sup>2</sup> Zoti e ka krijuar universin në mënyrë të përsosur. Në univers mbizotërojnë ligjet natyrore të vendosura nga Zoti. Zoti nuk ndërhyr në këto ligje natyrore që Ai vetë i ka vendosur. Nëse Zoti do të ndërhynte në këto ligje të vendosura prej Tij, atëherë kjo do të nënkuptonte që universi dhe ligjet që mbizotërojnë në të nuk janë krijuar në mënyrë të përsosur.<sup>3</sup> Mirëpo të mendosh se rendi dhe rregulli i mrekullueshëm që shohim me admirim në univers është i shkëputur nga Allahu dhe i pavarur prej Tij, është një mospërputhje e rëndë. Sepse është e pamundur që ky rend të vazhdojë vetvetiu pa mbështetjen e një qenieje që ka dituri, vullnet dhe fuqi. Pa dyshim, qenia që ka diturinë absolute, vullnetin dhe fuqinë që e ka vendosur këtë rend, është Allahu. Zoti është i pa të meta dhe i përkryer, mirëpo ky univers nuk është i tillë dhe s'mundet të vazhdojë ekzistencën duke qenë jo i përsosur. Nëse ne e mohojmë raportin ndërmjet Zotit dhe universit ne e kemi definiuar Zotin si të pa aftë për të menaxhuar me atë që është jo e përsosur sado që deistët pretendojnë që ky univers është i pa të meta.

Deistët kanë shprehur kritika ndaj religjioneve dhe feve, veçanërisht në lidhje me dogmat dhe ritualet e tyre. Ata kanë sfiduar autoritetin e shkrimeve të shenjta dhe pretendimet për ndërhyrje hyjnore, duke promovuar një qasje më racionale dhe skeptike ndaj këtyre temave.

Shumë nga deklaratat e deizmit janë ndërtuar mbi kritikën ndaj besimtarëve dhe feve ekzistuese, apo më mirë të themi ndaj krishterimit. Ndërsa në anën tjetër, vetë deizmi nuk ka qenë i suksesshëm në shpjegimin dhe bazimin e këtyre problemeve. Madje, për shumë çështje nuk ka ofruar asnjë rrugëdalje. Deizmi është një tendencë e mohimit të fesë duke besuar Zotin, duke e liruar njeriun nga të gjitha kufizimet, të cilat kanë bazë hyjnore.

Zoti, përveç me universin ka raport dhe mirëmban edhe jetën e krijesave të tjera edhe pse ne mund të mos e kuptojmë këtë raport me mendje nëse nuk mbështetet me shpallje. Sipas fesë islame, asgjë në univers nuk është krijuar pa kuptim, pa urtësi dhe pa qëllim. Ajetet si: “Vallë, a mendon njeriu se do të mbetet pa përgjegjshmëri?” (Kijame, 36), i rikujtojnë njeriut se ai nuk është lënë kurrë i papërgjegjshëm dhe se ai ka një qëllim në krijimin e tij. Ky qëllim mund të shprehet si njohja dhe besimi në Krijuesin e tij, Zotin, dhe të jetuarit e një jete morale dhe të virtutshme. Për të realizuar këtë qëllim, mbështetja e njeriut nga Zoti me shpallje (vahjit) pasi i ka dhënë mendjen është krejtësisht e arsyeshme dhe një shprehje e mëshirës dhe mirësisë së Tij. Refuzimi i deistëve për t'u kthyer te Kurani dhe mospranimi i këtyre të vërtetave hyjnore tregon se ata nuk e kanë kuptuar plotësisht qëllimin e krijimit të njeriut.<sup>4</sup>

Sipas deizmit, njeriu nuk ka ndonjë përgjegjësi që buron nga Zoti, sepse Zoti nuk kërkon diçka të palogjikshme nga njeriu. Zoti, në natyrën e Tij, është i lumtur dhe i dashur ndaj mirësisë. Ai nuk ndjen nevojën të kërkojë diçka që e bën të lumtur dhe të kënaqur nga krijesat e Tij. Gjërat që njerëzit bëjnë për të lumturuar Zotin nuk e rrisin ose pakësojnë lumturinë e Tij. Pra me një fjalë Zoti nuk preokupohet me veprimet e njerëzve dhe me ibadetet e tyre. Njeriu sipas deistëve duhet të veprojë sipas mendjes së tij dhe jo sipas kërkesave të ndonjë feje të caktuar.

Sipas deistëve, për të gjithë njerëzit ekziston vetëm një fe, dhe ajo është deizmi. Përcaktuesi dhe rregulluesi i vetëm i kësaj feje është arsyeja. Fillimisht, feja e vetme dhe e përbashkët e të gjithë njerëzve ishte deizmi, por më vonë, njerëzit kanë shpikur fe të tjera për të sunduar mbi të tjerët dhe për t'i mbajtur nën kontroll. Sipas deistëve, të gjitha fetë janë shpikje të njerëzve. Madje, sipas tyre, nëse ekzistonte dikush si Ademi, ai duhej të ishte krijuar si deist. Mosmarrëveshjet mes njerëzve burojnë nga shtesat që kanë bërë në këtë fe natyrore të besimit në një Zot të vetëm. Nëse do të shfaqej përsëri një fe universale, kjo nuk do të ishte një fe e re. Njerëzit do të ktheheshin tek ajo që kanë besuar fillimisht dhe do të bashkoheshin nën ombrellën e deizmit.

Në kundërshtim me pretendimet e deistëve, koncepti i fesë universale dhe te natyrshmes

në fakt i përket Islamit. Lidhur me këtë temë, mund të citojmë ajetet e mëposhtme: “Feja e pranueshme tek Allahu është Islami.” (Ali Imran, 19); “E kush kërkon fe tjetër përveç fesë islame, atij kursesi nuk do t'i pranohet dhe ai në botën tjetër është nga të dëshpëruarit.” (Ali Imran, 85).

### KRITIKAT NDAJ DEIZMIT

Deizmi ka qenë subjekt i kritikave të shumta. Teologët tradicionalë e kanë sfiduar këtë filozofi, duke theksuar se ajo zvogëlon rolin e Zotit dhe ndërhyrjes hyjnore në jetën e përditshme. Ata gjithashtu kanë kundërshtuar idenë se arsyeja dhe shkenca janë të mjaftueshme për të kuptuar të gjitha aspektet e ekzistencës njerëzore. Kjo jo për faktin që ne ende nuk e kemi të zhvilluar sa duhet shkencën, por që arsyeja njerëzore është e paaftë ta bëjë këtë. Disa filozofë e kanë kritikuar deizmin për hapjen e shumë çështjeve të cilave nuk ka mund t'u jap përgjigje dhe për kufizimin e mundësive të njeriut për të gjetur kuptim dhe qëllim e tij në jetë.

Deizmi si koncept filozofiko-teologjik ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit modern. Duke promovuar një qasje racionale dhe shkencore ndaj besimit, deizmi ka sfiduar dogmatizmin dhe ka ndihmuar në formimin e shoqërive sekulare. Megjithatë, ai nuk ka mbetur pa kritika, dhe debati mbi rolin e arsyes dhe besimit vazhdon të jetë i rëndësishëm në mendimin bashkëkohor. Deizmi mbetet një temë e pasur për studim dhe reflektim në fushën e filozofisë dhe teologjisë.<sup>5</sup>

Ndër idetë më të rëndësishme të theksuara ishin: përpjekja për racionalizim deri në mohimin e mrekullive, dyshime serioze për vërtetësinë e shkrimeve të shenjta, mohimi i autoritetit shpirtëror të klerikëve dhe pretendimi se arsyeja mund të arrijë tek ideja e Zotit, të vërtetojë ekzistencën e tij dhe të vendosë rregulla morale që çojnë në shpëtim. Ndërkohë, deistët hodhën idenë se themeli i besimit duhet të jetë arsyeja dhe jo shkrimet e shenjta që kanë kaluar përmes falsifikimeve historike dhe hodhën poshtë hierarkinë e klerikëve që pretendojnë të kenë të drejtën për të interpretuar këto shkrime, duke argumentuar se arsyeja është një standard



universal i përbashkët për të gjithë. Shumë nga deklaratat e deizmit janë ndërtuar mbi kritikën ndaj besimtarëve dhe feve ekzistuese, apo më mirë të themi ndaj krishterimit. Ndërsa në anën tjetër, vetë deizmi nuk ka qenë i suksesshëm në shpjegimin dhe bazimin e këtyre problemeve. Madje, për shumë çështje nuk ka ofruar asnjë rrugëdalje. Deizmi është një tendencë e mohimit të fesë duke besuar Zotin, duke e liruar njeriun nga të gjitha kufizimet, të cilat kanë bazë hyjnore.

Deistët gjithashtu, duke u nisur nga ideja se te njeriu ekziston një ndjenjë natyrore fetare e cila është natyrshme e tij, kanë rënë në iluzionin se Zoti nuk ka dërguar asnjë shpallje. Megjithatë, Kurani i shenjtë thotë se njeriu, nëse përdor arsyen dhe vëzhgon botën e tij të brendshme dhe universin, do të kuptojë se shpallja është vetë e vërteta. Kjo është shprehur qartë në Kuran: *“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta. Vallë, a nuk të mjafton ty që, Zoti yt është Dëshmuar i çdo gjëje?!”* (Fusilet, 53).

### KONKLUZIONE

Deizmi siç e pamë edhe me lartë është një besim që pretendon në një Krijues duke mohuar në çdo mënyrë mundësinë që ky Zot krijues të kërkojë përgjegjësi nga krijesat të cilat i ka krijuar. Pra deizmi sikur e shfrytëzon Zotin për një histori rreth krijimit të universit dhe pastaj e largon konceptin e Zotit nga jeta e vet e përditshme. Jemi përballë një mendësie ku pretendon që njeriu përballë me një determinizëm fatal dhe brenda kësaj nuk ka vend për Zotin dhe detyrimet e mundshme që dalin nga Ai. Sipas deistëve, njeriut i mjafton të besojë Zotin si krijues dhe se ai ekziston mirëpo feja, shpallja, pejsamberët, mrekullitë etj., janë në kundërshtim me arsyen njerëzore dhe si të tilla nuk duhet të zënë vend në diskutimin intelektual të njerëzve. Të jesh intelektual do të thotë t’i marrësh mbi supë përgjegjësitë e asaj ide të cilën ti e kultivon dhe e mbron. Me pak fjalë deizmi është një fe, Zoti i të cilës është produkt i mendjes dhe arsyes dhe ku ky Zot s’ka asnjë raport me krijesat e tij të cilat nuk mbajnë asnjë përgjegjësi për besimin e tyre.

- 1 Hüsameddin Erdem, “Deizm”, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (İstanbul: TDV Yayınları, 1994), 9/109.
- 2 Leslie Stevenson, “Deism”, *Eighteen Takes on God*, 53-58 (Oxford University Press, 2019), f. 53.
- 3 Bozkurt, Mustafa, and Mehmet Kuyucu. “Tanrı-İnsan İlişkisi Bağlamında Deizm’in Temel İddialarının Eleştirisi.” *Mesned İlahiyat Araştırmaları Dergisi* 11.2: 441-469.
- 4 Bozkurt, Mustafa, and Mehmet Kuyucu. f.448
- 5 Hüsameddin Erdem, “Deizm”, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (İstanbul: TDV Yayınları, 1994), 9/109.

# Obskurantizmi social dhe alegoria e shpellës

Granit Sadiku

Hafidh ibën Kethir, në librin e tij mbi historinë e të dërguarve të Allahut, përshkruan se njerëzit kishin filluar që pasionet e tyre për njerëzit e mëdhenj t'i shndërronin në piktura. Ato imazhe fillimisht atyre ua shkaktonin një kënaqësi të madhe, për vetë formën se si i luteshin Zotit përmes tyre dhe ua ngjallnin shpresat për pranimin e lutjeve.

**N**e jemi ashtu si mendojmë. E ne mendojmë ashtu si dhe sa i marrim informatat nga jashtë-brenda, përmes shqisave. Shpeshherë mund ta gjejmë veten si pre e lajmeve të rreme dhe e informatave të pasakta, pikërisht për shkak të asaj që janë mësuar shqisat ta perceptojnë e mendja ta kuptojë. Mendjen ia dhuroi Zoti njeriut, për ta dalluar atë nga krijesat e tjera, që nuk mund t'i kenë aftësitë si ai. Dhe kështu, njerëzit

ndahen pastaj në njerëz që kanë zgjedhur ta përdorin për qëllime pozitive potencialin e tyre, dhe në njerëz që nuk kanë zgjedhur asnjëherë ta ruajnë të çmuarën e tyre – mendjen, por e kanë përdorur për qëllime djallëzore. Nisur nga kjo cilësi njerëzore për t'i parë gjërat gjithmonë më ndryshe sesa që janë në të vërtetë, që nga koha e krijimit të njeriut të parë e qindra mijëra vjet më pas, njerëzimi kishte pësuar devijim të plotë. Njerëzit kishin



filluar me kalimin e kohës që të adhuronin elemente të natyrës, si: gurin, drurin, diellin, hënën, etj.. Për ta përmirësuar gjendjen e tyre të mjeruar sociale, Zoti ka dërguar herë pas here pejgamberë nga populli i tyre, në mënyrë që t'i këshillonin ata për të mos bërë thëllimin e gabimit. Mirëpo, qasja e njerëzve ndaj mësimëve profetike nuk ishte aspak e duhura, përveç në pak raste. Siç mund ta marrim rastin e Nuhut a.s., që përmendet në Kuran si profet i dalluar me një punë të gjatë aktive (më se 950 vjet) në thirrjen islame, në thirrjen për besim në një Zot të Vetëm. Ndërsa, Nuhut a.s., Zoti përmend në Kuran se: *“...nuk kishin besuar me të, përveç një pakice.”* (Hud, 40).

Gjendja e mjeruar psiko-fizike e njerëzve kishte rënë në një stad të frikshëm. Ata kishin filluar ta harrojnë madje edhe vetë idenë e besimit në Zot. Hafidh ibën Kethir, në librin e tij mbi historinë e të dërguarve të Allahut, përshkruan se njerëzit kishin filluar që pasionet e tyre për njerëzit e mëdhenj t'i shndërronin në piktura. Ato imazhe fillimisht atyre ua shkaktonin një kënaqësi të madhe, për vetë formën se si i luteshin Zotit përmes tyre dhe ua ngjallnin shpresat për pranimin e lutjeve. Pastaj, me kalimin e kohës, ato piktura dhe imazhe filluan të shndërroheshin në statuja të gurta, të cilat njerëzit filluan t'i admironin aq shumë sa që dikur nisën edhe t'i adhuronin. Adhurimi i tyre kishte bërë që gjeneratë pas gjenerate njerëzit ta harronin krejtësisht realitetin e burimit të ekzistencës njerëzore, që është Zoti Një dhe i Vetmi.<sup>1</sup> Në mendjen e tyre ishte krijuar një obskurë, një errësirë e plotë penguese, që i pengonte ata të largoheshin nga errësira në dritë e ta shihnin realitetin. Kjo fazë nuk ishte e përkohshme. Ajo me kalimin e kohës u bë etapë, pastaj periudhë kohore, e dikur fatkeqësisht epokë.

### KALIMI NËPËR CIVILIZIME

Ndër mëkatet e para të njeriut në këtë botë, ishte vrasja. Vajzën që i përkiste Habilit e donte Kabili, dhe kështu Zoti i urdhëroi ata që të bëjnë të dy nga një sakrificë për hir të Tij, dhe atij që do t'i pranohej sakrifica do t'i takonte vajza për grua. Kur e bënë sakrificën, Zoti e kishte pranuar atë të Habilit, ndërsa të Kabilit jo. Si ndodh që mes dy bijve të një njeriu aq të mirë, të një pejgamberi, të ndodh një vrasje e tillë! Këtu, sipas mendimit tonë, zë fill civilizimi mbarë botëror. Ngase me këtë vrasje, e cila nuk ishte vdekje e natyrshme, njeriu ia hapi vetes derën e eliminimit të tjetrit. Ia hapi vetes

Sa e sa vrasje,  
luftëra, e krime  
monstruoze  
kanë ndodhur  
që nga Kabili e  
deri më sot?!  
Dhe arsyeja pse  
ndodhën ishte  
eliminimi i  
dikujt për të  
dominuar  
dikush tjetër.  
Dëbimi i dikujt  
nga shtëpia e tij,  
për t'ia marrë  
atë tjetri.

mundësinë që ta shkoqisë idenë e tij të brendshme në refleksion të jashtëm, dhe përkundër ndalesës nga Zoti për vrasjen e njëri-tjetrit, ai prapëseprapë ta vrasë vëllain e tij. Kjo do të thotë fillim i konflikteve, i vrasjeve, i dëbimeve e i luftërave. Sa e sa vrasje, luftëra, e krime monstruoze kanë ndodhur që nga Kabili e deri më sot?! Dhe arsyeja pse ndodhën ishte eliminimi i dikujt për të dominuar dikush tjetër. Dëbimi i dikujt nga shtëpia e tij, për t'ia marrë atë tjetri. E ky motiv i ka rrënjët te vrasja e parë e historisë së njerëzimit, vrasja e Habilit nga Kabili. Për këtë konstatim shërbehemi edhe me hadithin e Muhamedit, a.s., i cili thotë: *“Nuk mbytet asnjë njeri mizorisht e në atë mëkat të mos marrë pjesë edhe biri i Ademit, ngase ai ishte i pari që filloi vrasjen.”*

Në një vend shkretinor të quajtur Ahkaf, ku sot nuk ka vend për jetë, dikur kishte qenë i njohur një qytetërim i kohës nga një fis që quhej Ad. Ky fis kishte pasur të dërguar Hudin a.s., i cili ua kishte shfaqur atyre argumentet e qarta të ekzistencës së një Zoti të Vetëm. Ndërsa ky popull, si i vetëkënaqur, arrogant e mendjemadh, e kishte injoruar çdo përpjekje të Hudit për t'ua mësuat atyre realitetin. *“Ata thanë: “O Hud, ti nuk na solle*

*ndonjë argument, e ne nuk i braktisim zotat tanë për fjalën tënde, dhe ne nuk të besojmë ty. Ne nuk themi tjetër vetëm se dikush prej zotave tanë të ka goditur me çmendje.” Ai tha: “Unë e kam Allahun dëshmitar, e ju dëshmoni se unë jam larg nga ajo çka ju i shoqëroni!”* (Hud, 53-54). Pastaj, dihet dënimi që tregohet edhe në suren El Hakka, ku Allahu tregon për erën e fuqishme që i kishte dënuar me të atë popull për shtatë net e tetë ditë rresht. Obskura e tyre në këtë rast nuk ishte motivi për vrasje, por ishte thjesht krenaria e tepruar, e cila zakonisht i shkakton dëm njeriut. Kjo krenari, e cila tek ata kishte marrë primatin e arrogancës e mendjemadhësisë, kishte bërë që ata ndonëse e kishin parë realitetin me sytë e ballit, *“sytë e mendjes”* – ata që iu kishin errësuar, nuk ua kishin pranuar atë.<sup>2</sup>

Salihu a.s. ishte profet i cili po ashtu tentoi ta trasonte rrugën e Hudit, duke e thirrur fisin Themud në rrugën e besimit në Zot. Fisi Themud ishte aq mosbesues, sa që nuk i besonin dot as atyre fakteve e argumenteve të gjalla që me forcën e Zotit, Salihu a.s. ua sillte përballë. Ashtu si kishte ndodhur me devenë, që kishte qenë një mrekulli për ta nga ana e Zotit, një grup prej tyre, nga urretja e madhe – e cila është një hap që e çon njeriun drejt errësirës së injorancës – e kishte mbytur devenë. Kur ky popull e kishte tepruar me

mëkate dhe injorancë, Zoti ua kishte zbritur dënimin me zërin e tmerrshëm që kishte ardhur nga qielli dhe që ua kishte marrë shpirtin me tmerr e lemeri.<sup>3</sup>

Nga këto shoqëri të hershme njerëzore, si dhe nga ato që erdhën më pas, arrijmë të shohim mënyrën se si njerëzit kishin devijuar nga rruga e drejtë dhe se si kishin krijuar në mendjet e tyre një bllokadë, përtej së cilës ata s'mund të largoheshin. Bllokadë që në latinisht është

quajtur "*obscura*". Të kalojmë tani në civilizimin më të vonshëm, që ishte para kohës së Muhamedit a.s. në territorin e Hixhazit (Mekës dhe Medinës)! Arabët, para ardhjes së Pejgamberit a.s. ishin të shthurur totalisht, si nga aspekti i moralit, si nga aspekti i besimit. Ata nuk e kishin mohuar ekzistencën e Zotin, por e kishin pohuar dhe kishin besuar se i gjendet shok në adhurim. Dhe ky politeizëm i tyre ishte beteja e madhe me të cilën do të ballafaqohet profeti për 13 vjet me radhë. Para kohës profetike në Mekë, fisi Kurejsh e kishte epitetin e një fisi të lartë. Ata kishin caktuar për vete disa të drejta që nuk i kishin arabët e tjerë. Ata gëzonin një lloj dominimi ndaj arabëve të tjerë. E ndalonin rreptësishtë bërjen e haxhit me veshje. Kështu i detyronin njerëzit që t'i hiqnin të gjitha rrobat e trupit dhe tavafin rreth Qabesë ta bënë të zhveshur.<sup>4</sup>

Arabët e kësaj periudhe ishin racistë dhe fenomeni i dallueshmërisë së klasave (fiseve) në mesin e tyre bëhej përmes gjakut (prejardhjes). Ai që kishte prejardhje të udhëheqësve bëhej edhe vetë udhëheqës, ani pse mund të ketë qenë totalisht i paaftë për pozitën përkatëse. Njësoj mund të përmendim edhe civilizimin e Perandorisë Perse. Mbretërit persë besonin dhe predikonin se gjaku në venat e tyre ishte gjak hyjnor, e kësajsoj ata ishin të vetmit që duhet



**Civilizimi i njohur i Perandorisë Romake, i njohur botërisht për rekordin e thyerjes së gjitha tabuve morale e etike, idenë e vrasjeve mes njerëzve e kishte shndërruar në pasion. Në amfiteatrin e madh të Romës, Koloseun, qindra mijëra njerëz shikonin ndeshjen e gladiatorëve mes vete dhe argëtoheshin teksa shihnin se si një ushtar vriste një tjetër.**

ta udhëhiqnin vendin. Prandaj kishte ndodhur, në formë absurde, që një fëmijë shtatë vjeç të bëhet mbret i vendit – meqë nuk kishte të tjerë meshkuj nga familja mbretërore dhe ai ishte i vetmi.<sup>5</sup> Ndalohej çdo formë e përzjerjes mes klasave, asaj të popullatës së thjeshtë dhe asaj mbretërore. Një qytetari pers i ndalohej madje edhe blerja e ndonjë sendi nga njerëzit që ishin nëpunës të strukturave shtetërore.

Pastaj, e kemi civilizimin hindas. Kasta pushtuese e udhëheqëse në Indi ishte kasta fetare – është fjala për civilizimin që kishte lulëzuar në Indi tre shekuj para erës sonë. Civilizimi Brahmanian do të bëhej autoritet dhe të krijonte ligjin e ndarjes së klasave në masat popullore. Në bazë të këtij ligji – me përmasa tejet veçuese e diskriminuese – klasat të cilat renditeshin në hierarki ishin kësajsoj: 1. Brahmanët – kasta e predikuesve fetarë (piftërinjve), 2. Kashtrinjtë – luftëtarët, 3. Vajshajsët – bujqit, tregtarët, zejtarët, dhe 4. Shudratë – shërbëtorët. Autori i vetë këtij ligji, që quhet Manu, thotë se, gjoja se, Zoti i ka krijuar në interes të botës Brahmanët – nga goja e tij, Kshatrinjtë – nga duart e tij, Vajshajsët – nga kofsha e tij, ndërsa Shudratë – nga këmba e tij. Pra, përmes këtij përkufizimi fizik të pjesëve të trupit, atyre iu caktuan edhe detyrat specifike: Brahmanët – t'i mësojnë Vedatë<sup>6</sup> njerëzve dhe të ofrojnë sakrificë për Perëndinë, Kashtrinjtë – ta mbrojnë popullin në raste rreziku apo lufte, Vajshajsët – t'i kullojnë bagëtinë, të merren me bujqësi e tregti, dhe Shudratë – t'u shërbejnë tri klasave të sipërpërmendura.<sup>7</sup> Kjo ndarje e kastave iu jepte mundësi Brahmanëve që të ishin të zgjedhur e të veçuar nga të gjithë të tjerët. Ata nuk guxonte t'i cenonte askush. Edhe nëse një Brahman do ta meritonte vdekjen, ai assesi nuk duhej të vdiste nga uria. Ai kishte të drejtë t'i merrte çdo gjë skllavit të tij, ngase

sipas ligjit skllavi i takonte pronarit, e skllavit (Shudrasë) nuk i takonte asgjë. Edhe po të bënte krimet më monstrooze një Brahman, të vriste e priste qindra njerëz të pafajshëm, mjaftonte që t'i mësonte përmendësh "Vedatë" dhe t'i faleshin të gjitha mëkatet. Aq lart konsideroheshin Brahmanët në bazë të këtij ligji, sa që diferencimi mes tyre dhe Kshatrinjve arrin kulmin në principin "Brahmani 10 vjeçar është më superior sesa Kshatriu qindvjeçar."<sup>8</sup> E të mos flasim për Shudratë, që urreheshin më shumë se qenët e rrugëve. Shudratë kishin për detyrë të shërbenin pa kurrfarë kompensimi. Madje, edhe po të vritej Shudra nga kastat e larta mbi të, ajo vrasje konsiderohej si vrasje e ndonjë qeni apo të ndonjë brejtësi. Ky trajtim ishte çnjerëzor dhe i tmerrshëm. Kjo kastë i ka sjellë botës "dhuratën" më të keqe që mund të ekzistojë – racizmin. E në emër të racizmit më vonë, pasardhësit e kësaj forme të klasifikimit hierarkik njerëzor, do të bënin krimet më makabër: Leopoldi II i Belgjikës (15 milion vrasje), Adolf Hitler (17 milion vrasje), Josif Stalin (23 milion vrasje), Mao Ce Dun (78 milion vrasje).<sup>9</sup>

Civilizimi i njohur i Perandorisë Romake, i njohur botërisht për rekordin e thyerjes së gjitha tabuve morale e etike, idenë e vrasjeve mes njerëzve e kishte shndërruar në pasion. Në amfiteatrin e madh të Romës, Koloseun, qindra mijëra njerëz shikonin ndeshjen e gladiatorëve mes vete dhe argëtoheshin teksa shihnin se si një ushtar vriste një tjetër. Kishte një mori perandorësh që kishin afëra të ndryshme të dhunimeve të grave. Prej tyre edhe gra të shërbëtorëve besnikë të pallatit perandorak. Madje, aq e degjeneruar kishte qenë mendësia perandorake romake, sa që kishte ndodhur edhe martesë mes perandorit Kaligula dhe motrës së tij.

Kjo errësirë që e kishte kapluar njerëzimin prej kohësh, kishte marrë hov të madh sidomos në kohën kur profeti Muhamed kishte ardhur me qëllimin e qartë të tij. Me rastin e shpalljes së Muhamedit a.s. pejgamber, ai kishte filluar thirrjen nga të afërmit e tij. Natyrshëm dihet se si do të pritej një fe "e re" në mesin e arabëve shkurtpamës të asaj kohe. Një fe që nuk do t'ua lejonte kamatën, të cilën ata e kishin burimin kryesor të fitimit. Një fe që do t'ua ndalonte alkoolin, me të cilin ata bënin tregti dhe e përdornin tej mase. Një fe që do t'ua ndalonte glorifikimin e njeriut dhe të gurëve, por do t'ua mësonte lavdërimin dhe madhërimin e një Zoti të Vetëm. Deri në momentin që Muhamedi a.s. kishte qenë i heshtur dhe nuk ishte përzier në punët e tyre, ata e kishin quajtur atë "El Emin" – besnik. Ndërsa, në momentin që ai ua shfaqti realitetin para syve, dhe ua sulmoi rreptë obskurantizmin e tyre që ua kishte krijuar tërë atë injorancë, ata e quajtën atë "gënjeshhtar". Ata të cilët e kishin zemrën dhe mendjen e hapur për ta kuptuar vërtetësinë e asaj që iu shpall profetit të Zotit, i besuan atij dhe e pasuan. Ndërsa, ata që kishin interes pasurinë dhe autoritetin e kësaj bote, i cili në fakt u cenohej me ardhjen e fesë islame në mesin e tyre, nuk mundën të

besonin asnjëherë fjalën Hyjnore që i qe zbritur Muhamedit a.s.. E ka thënë mirë kush e ka thënë, se "dashuria qiellore dhe pasuria tokësore nuk mund të bashkëjetojnë në një zemër."<sup>10</sup> Efekti fillestar u arrit në Mekë, por jo fryti përfundimtar i ngadhënjimit të fesë. Pas shpërnguljes së myslimanëve në Medinë, u pa rezultati i përkushtimit dhe punës së tyre. Kjo punë arriti këtë rezultat të madh pikërisht për një arsye, ngase ishte krejtësisht vullnet i lirë i pa imponueshëm nga profeti i Zotit. Profeti i Zotit ua krijoi shokëve të tij një hapësirë aq të madhe e aq të këndshme, sa që ata ndjenin se secili ishte autoritet më vete. E kjo formë e krijimit të hapësirës përmes vullnetit të lirë qytetar, është forma më efikase e krijimit të një shoqërie vitale. Profeti i Zotit, me mençurinë e tij të madhe arriti që të mbjellë në zemrat e secilit prej besimtarëve ndjenjat e lirisë dhe trimërisë, e kështu ata me konfidencën e tyre ndaj profetit të Zotit arritën të krijonin një civilizim të tërë, që u quajt "Civilizimi islam". Politikën e ngjashme të formës së udhëheqjes së Pejgamberit, a.s. e gjejmë edhe te traktati i shkruar nga Rusoi, kur flet për idenë e qeverisjes. Ai thotë: "Çdo veprim i lirë ka dy shkaqe që ndihmojnë për ta përfutur: njëri është moral, domethënë vullneti që e përcakton veprimin; dhe tjetri është fizik, domethënë fuqia që e zbaton."<sup>11</sup>

## SFIDAT E ÇDO THIRRJEJE

Që në krye të herës kemi përmendur alegorinë e shpellës. Tani do të bëjmë fjalë për të përbashkëtën e të gjitha epokave historike të civilizimeve të ndryshme që nga koha e lashtë. Kemi përmendur vazhdimisht *obskur*-ën, errësirën e mendjes, kur kemi folur për fazat e ndryshme të historisë nëpër të cilat ka kaluar bota dhe sfidat që kanë pasur të dërguarit e Zotit për t'u marrë me to. Në fakt, cila mund të jetë sfida konkrete, shtrohet pyetja! Të gjithë ne e kemi të konkretizuar në mendje realitetin tonë. Ky realitet për dikë mund të jetë gënjeshhtë e plotë, ashtu si mund të jetë për ne gënjeshhtë e plotë realiteti i dikujt. Dhe kjo kundërshti, ky negacion, zgjat pa fund. Në analizën e të dyja aspekteve, realitetit dhe gënjeshtrës, na duhet të shërbehemi me forcën e argumentit. Argumentet mund të jenë lëndore – fizike, të cilat mund t'i shohim, t'i prekim, t'i kemi afër. Por mund të jenë edhe thjesht logjike, që ne jo detyrimisht mund t'i shohim e t'i prekim.

Një filozof i vjetër grek, konceptet dualiste të të cilit shpesh gjejmë përputhshmëri me disa koncepte islame, Platoni, në kapitullin e shtatë të veprës së tij të njohur "Republika" trajton temën e përvetësimit të shkencës. Mendja duhet të jetë e ndriçuar nga shkenca gjithësesi, pohon Platoni. Por si mund të ndodh që të arrihet deri te mësimi i shkencës, kur në botë ata që e kanë begatinë e diturisë së vërtetë janë pak! Platoni, në dialogun që zhvillon me Glaukonin, merr një shembull tejet interesant që na e përfytyron sfidën e thirrjes së një njeriu që predikon të vërtetën. Alegoria e shpellës është kësajsoj: le të imagjinojmë se ekziston diku një vend nëntokë

si lloj shpelle, në të cilën qëndrojnë disa njerëz. Këta njerëz janë aty që nga fëmijëria e tyre e hershme. Janë të lidhur me zinxhirë të rëndë në duar, në këmbë e në qafë dhe e kanë të pamundur kthimin e kokës mbrapa. Ndërkaq, drita e një zjarri të ndezur pas tyre shkëlqen. Dhe mes njerëzve dhe zjarrit qëndron një rrugë që ngjitet lart. Në këtë rrugë kalojnë kafshë e gjallesa të ndryshme, të cilët u reflektojnë si hije njerëzve brenda shpellës, dhe realiteti që ata shohin është hija. Po edhe zëri që dëgjojnë ata e kanë bindjen se vije nga gurët e shpellës, e assesi nga jashtë. Dhe nëse njërit do t'i jepej rasti një ditë që të zgjidhej nga zinxhirët e të dilte jashtë, pa dyshim se do ta kishte vështirë të ambientehej me dritën, me objektet reale, por dikur do ta kuptonte se realiteti është krejtësisht diçka tjetër në krahasim me atë që ata kishin ditur deri më atëherë. Dhe pasi e kupton thellësisht këtë gjë, ai vendos që të kthehet prapë në shpellë, për t'iu treguar njerëzve të tjerë me të cilët kishte jetuar se krejt njohuria e tyre kishte qenë gabim. Realiteti që ata e dinin ishte thjesht hije, ndërsa e vërteta është atje jashtë, në dritë. Ndërsa atyre, në vend që t'u zgjohej kureshtja për të kuptuar më mirë realitetin, ata ngulin këmbë në formën e tyre të të menduarit dhe e shpallin të çmendur njeriun i cili i fton ata në diçka tjetër në krahasim me atë që kishin qenë duke e bërë. Tani, vazhdova unë, i dashuri Glaukon, duhet që këtë imazh ta marrim të gjithë e ta përputhim me atë që kemi thënë pak më parë: duhet krahasuar bota e dukshme me atë që shikonim kur ishim në burgun e shpellës dhe dritën e zjarrit me të cilën ai ndriçoihej me efektin e diellit...<sup>12</sup>

A nuk duket kjo alegori çelësi i kuptimit të vështirësisë së një profeti, i cili e ka parë dritën (të vërtetën e Zotit) dhe mundohet që t'ua transmetojë atë njerëzve të tjerë nga populli i tij? Ndër të tjera, edhe Platoni pohon përmes kësaj alegorie se ne jemi pikërisht si rasti i të ngjuarve në shpellë, që presin të kalojë një hije e të mahniten nga ajo. I kemi përmendur disa profetë me radhë që nga Ademi a.s., e deri te Muhamedi a.s. A nuk është rast i ngjashëm me shpellorët populli i Nuhut, i cili nuk e besonte fare çështjen me të cilën qe ngarkuar Nuhu për ta shkoqitur te ta! Apo populli i Hudit, të cilët nuk arritën ta kuptonin se cila qe e vërteta, cila drita e cila errësira. E në fund, profeti Muhamed, a.s. a nuk është pikërisht sikur rasti i njeriut që del nga shpella – që për shkaqe rastësore të kësaj alegorie Muhamedit a.s. i erdhi shpallja pikërisht në shpellë – dhe që duke dashur t'ua tregonte “shpellorëve” të tjerë realitetin hasi në shumë vështirësi. U shpall i çmendur, magjistar, e sa e sa akuza të tjera të paturpshme, vetëm për faktin se ua tregonte syve të pastërvitur për realitetin dritën e madhe të Zotit, me të cilën ishte udhëzuar zemra e tij dhe zemra e të gjithë atyre që ndoqnë rrugën e tij.

Armiku më i madh i njeriut është injoranca. Por edhe në anën tjetër, armiku më i madh i injorancës është ai që di. Këto të dyja e luftojnë njëra-tjetrën vazhdimisht. Me alegorinë e

shpellës, Platoni kishte për qëllim dëftimin e rrugës dhe formës së kuptimit të shkencës. Por ajo i përputhet plotësisht debateve të vjetra nga profetët, e pastaj nga dijetarët islamë që vazhdojnë edhe sot e kësaj dite për qëllimin e vetëm që t'ua tregojnë njerëzve dallimin mes errësirës dhe dritës, mes gënjeshtres dhe realitetit.

Problemi i obskurantizmit vazhdon edhe sot e kësaj dite. Ajo që sot i bën njerëzit ta përbuzin dhe injorojnë me cinizëm Islamin, është pikërisht frika që kanë nga ndikimi i tij. Mendoni frikën që do ta kishin shpellorët po të largoheshin përgjithmonë nga “realiteti” i tyre i hijeve! E vetmja gjë që ata njohin janë hijet, e kësajsoj ata s'munden dot ta absorbojnë dritën e vërtetë, nga e cila merr kuptimin e saj gjithçka. Frika nga feja islame, që madje është shndërruar në fobi te disa (islamofobia) ka të bëjë pikërisht me çështjen e ndikimit. Një dijetar i madh islam, i cili vdiq tash vonë duke na lënë një sasi të madhe veprash pas, Jusuf el Kardavi, në një libër të tijin vërente drojën e perëndimit ndaj një civilizimi të ri islam, kur thoshte: “*Filozofët dhe strategët që kanë adoptuar teorinë e përplasjes së civilizimeve, kanë thënë se: “Qytetërimi islam është qytetërimi kryesor që vë në dyshim dhe frikëson të ardhmen e civilizimit perëndimor, prandaj duhet pasur kujdes prej tij dhe duhet përndjekur e sulmuar”*”<sup>13</sup> Pretendimet e hijeve për ta penguar dritën janë të pafuqishme, por edhe përpjekjet e dritës për t'i zhdukur ato janë të kota.

Obskurantizmi social sot ka kapluar njerëzimin në forma të ndryshme. Ndonëse dallon kohësisht nga ai që ishte më parë, ai thjesht është i përsëritur. Në kohën kur mik më i afërm se libri për njeriun është digjitalizimi, më e qasshme është bindja e gabuar sesa njohuria e fituar me argumente dhe shkencë, kur pretendohet ajo që s'dihet e lihet anash ajo që dihet e nuk zbatohet, kur njerëzit nga obskura e tyre janë të prirë ta shohin aspektin negativ të gjërave para se ta shohin aspektin pozitiv të tyre, na e mundësoftë Zoti që të dalim nga shpella!

1 Hafidh ibën Kethir, *Rrëfime për të Dërguarit e Allahut*, Gjurma, Prishtinë, 2011.

2 Po aty, f. 121.

3 Po aty, f. 138.

4 Sejid Kutub, *Kjo fe*, Sira, Prishtinë, 2019, f. 86 - 89.

5 Po aty, f. 87.

6 Libër i shenjtë i hindusëve, që ka kuptimin “dituri” dhe ndahet në katër pjesë: “Rigveda, Samaveda, Yajurveda dhe Atharvaveda”.

7 <https://www.bbc.com/news/world-asia-india>

8 Sejid Kutub, *Kjo fe*, Sira, Prishtinë, 2019, f. 91.

9 <https://www.readjuancarlos.com/top-ten-most-evil-dictators-of-all-time-in-order-of-kill-count/>

10 Metin Izeti, *Pasqyra estetike e traditës perenniale*, Shenja, Shkup, 2018, f. 29.

11 Jean-Jacques Rousseau, *Mbi kontratën shoqërore*, Pema, Prishtinë, 2018, f. 105.

12 Platoni, *Republika*, Plejad, Tiranë, 2017, f. 268.

13 Jusuf el Kardavi, *Islami për tek i cili ftojme*, Furkan, Shkup, 2022, f. 114.



# Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (6)

“EL NAFIË” I EBU’L KASIM SEMERKANDIT

Hazir D. Selmani

Në zinxhirin e shkrimeve për doracakët më të njohur të fikhut hanefi deri më tani u trajtuan Muhtesari i Tahaviut, Muhtesari i Kerhit, Muhtesari i Hakimit dhe Muhtesari i Kuduriut. Kronologjikisht radhën e ka Muhtesari i Ebu’l Kasim Semerkandit. Një doracak i plotë i hanefive që në qarkullim doli nga gjysma e parë e shekullit VI hixhri dhe me të madhe qe përhapur në mexhliset dhe medresetë e Transoksianës (ar.: Mavera-enehër) të periudhës së para pushtimit mongol.

## KUSH ËSHTË EBU’L KASIM SEMERKANDI?

Për jetën e këtij personaliteti të rëndësishëm të medhhebit hanefi ka fare pak të dhëna. Madje edhe mjaft ngatërtime, saqë Merashliu shënon se Kurashiu në “*El Xhevahir*” flet në katër vende kinse për katër persona, ndërsa realisht flitet për vetë Ebu’l Kasim Semerkandin.<sup>1</sup> Në literaturën hanefite njihet herë si Ebu’l Kasim Semerkandi dhe herë si Nasirudin Semerkandi e herë si autori i librit “*El Nafië*”.

Kronikanët hanefi shënojnë se Ebu’l Kasim Semerkandi ishte vaiz i shquar, dijetar i tefsirit, hadithit dhe fikhut. Imam i dalluar dhe shumë i fuqishëm në dije, bile i pakrahasueshmi i vaktit të vet në edeb, si dhe muxhtehid i vaktit (shkallë shumë e lartë fikhere).



Ky doracak i hanefive për herë të parë nga bota dorëshkrimore u botua në Riad, në vitin 2000, kur qe botuar në tre vëllime të mëdhenj me gjithsej afër 1600 faqe.



Ai është Muhamed b. Jusuf el Alevij el Haseni. Me rëndësi është të kihet parasysh se kur citohet si Ebu'l Kasim Semerkandi, atëherë nuk duhet ngatërruar me Ebu'l Kasim Semerkandin (vdiq 342 hixhri) më të hershëm, nxënësin e Maturidiut.

Kronikanët hanefi shënojnë se Ebu'l Kasim Semerkandi

ishite vaiz i shquar, dijetar i tefsirit, hadithit dhe fikhut. Imam i dalluar dhe shumë i fuqishëm në dije, bile i pakrahasueshmi i vaktit të vet në edeb, si dhe muxhtehidi i vaktit (shkallë shumë e lartë fikhere).<sup>2</sup> Në shumë burime cilësohet si *es sejjid*, *el alevi*, *el shehid* dhe *el medenij*,<sup>3</sup> që do të shpjegohen në vijim. Dihet se ai pati ndërmarrë një udhëtim të gjatë të haxhit në periudhën 535-543 h., ku gjatë kësaj periudhe vizitoi dhe qëndroi në disa qendra islame, në mesin e të cilave ishte edhe Medina e ndritur dhe kjo gjë shpjegon edhe mbiemrin e tij të nderit *el medenij*. Ai kishte gjenezë fisnike nga trangu familjar i nipave të Pejgamberit a.s., prandaj thirrej *es sejjid* dhe *el alevij*.

Ndërsa cilësimi i fundit *el shehid* tregon përfundimin e tij, ku në disa burime përshkruhet se vdekja e tij qe me ekzekutim nga pushteti dhe se vdiq si një dëshmor durimmadh. Përmendet se shkak i kësaj vdekjeje qe se Ebu'l Kasim Semerkandi ishte prej atyre që e kishin të lëshuar gjuhën mbi prijësit (ar. *El eimeh*) dhe dijetarët (*el ulema*). Tani kjo fjali lë të kuptohet se ai, si një hatib-vaiz i shquar në hytbet e tij duhet të ketë qenë kritik i ashpër i pushtetarëve dhe disa figurave fetare të kohës së tij, që kanë qëndruar pranë prijësve e pushtetarëve, të cilët sipas këndvështrimit të tij ishin gabim. Pra, sigurisht kjo, e sidomos kritika e pushtetit e ka çuar në burg dhe pastaj edhe në vrasjen e tij atje. Mirëpo ky citim assesi nuk duhet të kuptohet si përbaltje e imamëve të mëdhenj islamë, ngase një dijetar i fillestar i fikhut e di shumë mirë se kjo gjë është e

ndaluar, e lëre më këtë ta ketë bërë një fakih i kalibrit të Ebu'l Kasim Semerkandit, që cilësohet si muxhtehidi i vaktit të tij. Për vitin e tij të vdekjes ka disa mendime dhe më së shumti mendohet të jetë viti 556. Edhe ky është nxënësi i Daririt dhe i Kerderiut h.<sup>4</sup> Për mësuesit dhe nxënësit e tij nuk dihet thuajse asgjë.

### VEPRAT E EBU'L KASIM SEMERKANDIT

Në bazë të burimeve bibliografike del se Ebu'l Kasim Semerkandi pati shkruar dhjetëra vepra, kryesisht në fushën e fikhut hanefi. Merashliu numëron 13.<sup>5</sup> Tani për tani prej veprave të tija janë botuar vetëm 3 edhe atë:

1. Koleksioni i tij i vogël me fetfa fikhere hanefite me titull "*El Multekat fi'l-Fetava'l Hanefijeh*" (shq.: "Libri" i mbledhur i fetfave hanefite) i botuar në një vëllim. Këtë vepër autori e pati shkruar në vitin 549 h., duke e shkurtuar nga koleksioni i tij i madh i fetfave me titull "*El Xhamiu'l-Kebir ve'l Fetava*" (shq.: Koleksioni i madh dhe fetfatë).<sup>6</sup> Për këtë koleksionin e madh në qarqet shkencore përfillet se ka ca kopje dorëshkrimore në Turqi, në Damask dhe në Saudi.<sup>7</sup>

2. Libri i tij i dytë i botuar është një trajtesë e vogël 50 faqesh me titull "*Fet'hu'l galek*" (shq.: Hapja e drynit) në të cilin ai mjeshhtërisht jep përgjigje akaidore rreth disa ajeteve dhe haditheve.

3. Libri i tretë i botuar i Ebu'l Kasim Semerkandit është vepra e tij më e famshme, pra doracaku i tij fikhor, për të cilin do të flitet në vijim.

### DORACAKU FIKHORI EBU'L KASIM SEMERKANDIT

Doracaku fikhor i Ebu'l Kasim Semerkandit mban titullin "*El Fikhu'n-Nafie*" (shq.: Fikhu i leverdishëm) ose shkurtimisht "*El Nafie*" (shq.: I leverdishmi). Libri mbulon të gjitha temat e fikhut dhe në fillim ka një hyrje të shkurtër. Gjuha e tij shkencore është e mirë kuptueshme sipërfaqësisht, porse e ngjeshur nga ana fikhere dhe kjo shfaqet kur lexohet bashkë me komentin e Nesefiut. Libri ka mjaftë argumente

kuranore dhe hadithore. Aty-këtu në literaturën e vonshme hanefite hasen ca citime prej kësaj vepre fikhore. Në tokat e Transoksianës, në periudhën para pushtimit mongol duket se ky doracak ishte libër shumë i famshëm. Lekneviu dhe para tij Kefeviu e përshkruajnë kështu: “*El Nafië është një doracak i bekuar në fikh. Allahu bëri që prej tij të përfitonin shumë njerëz.*”<sup>8</sup> Ebu’l Berakat Nesefiu, komentuesi më i madh i këtij doracaku ka thënë: “*Libri El Nafië për nga numri i madh i xhevahireve dhe perlave që ngërthen është si një det i pafund, si një qiell i shndritshëm e si bahçet e livadhshistës e thesaret e lumturisë...*”<sup>9</sup> Ndërsa për pozitën e tij në medhhebin hanefi flet Tashkuprizadeh, i cili në mesin e librave fikhor hanefi që gëzojnë konsideratë të lartë medhheboe (ar.: *el kutubu’l-mu’teberah*) numëron edhe këtë libër duke thënë kështu: “*Libri El Nafië në fikh, e që me leximet e tij janë shërbyer shumë (dijetarë) si dhe kanë bërë komentimin e tij.*”<sup>10</sup>

Vetë fakti që një dijetar i shquar i atyre trojeve si Nesefiu ndau disa vite nga koha e tij për të komentuar këtë manual-doracak fikhor tregon se sa libër i rëndësishëm qe në ato periudha kohore dhe se nxënësit e dijes, hoxhallarët dhe dijetarët kishin nevojë që dikush i nivelit të Nesefiut t’i rrekej komentimit të këtij doracaku dhe prej tij të shtrydhte mësimet e dobite, duke i shpalosur në tryezë për mbarë lexuesit. Tjetra, edhe numri i konsiderueshëm i dorëshkrimeve të kësaj vepre nëpër bibliotekat e vjetra është një tregues tjetër i rëndësisë së tij.

Ky doracak i hanefive për herë të parë nga bota dorëshkrimore u botua në Riad, në vitin 2000, kur qe botuar në tre vëllime të mëdhenj me gjithsej afër 1600 faqe. Në këtë botim, teksti i librit është ndarë në 1231 paragrafë fikhore të madhësive të ndryshme. Me gjithë kontributin e muhakikut, mangësia e këtij botimi padyshim mbetet stërmadhimi i vëllimit të tij, duke e mbushur tekstin me shënime margjinale që në shumicën e botimit margjinat e muhakikut zënë 70% të faqes. Në vitin 2023 ky doracak i hanefive ka pasur edhe një botim me redaktor tjetër, ku është botuar në një vëllim të madh me rreth 700 faqe. Në gjuhën shqipe prej këtij doracaku të hanefive deri më tani nuk ka asgjë të përkthyer.

## KOMENTET (EL SHURUH) E DORACAKUT FIKHOR TË EBU’L KASIM SEMERKANDIT

Për sa i përket numrit të komenteve të këtij manuali në burimet bibliografike vërehet një lëmsh mendimesh, si për autorësinë e këtyre komenteve, ashtu edhe në vetë titujt e tyre. Në “*Keshfu’dh Dhunun*” dhe burime të tjera janë regjistruar të paktën tre komente.<sup>11</sup> Sipas këtyre të dhënave mund të klasifikohet si doracak fikhor i komentuar nën-mesatarisht. Komentet në fjalë janë:

1. Komenti i Ahmed b. Omer Nesefiut (vd. pas 664 h.) me titull “*El Menafië fi Fevaidi’n Nafië*” (shq.: Përfitimet nga dobitë e të leverdishmit).

2. Komenti me titull “*El Hadi li’l badi ala Kitabi’n Nafië*” (shq.: Udhëzuesi për nismëtarin e librit El Nafië). Emri i autorit nuk është shumë i sigurt, diku thuhet se është Ebu Bekër Hameviu, e diku tjetër ai mendohet të jetë nxënësi i Daririt, një fakihut të madh hanefi që ishte i verbër. Nganjëherë ky koment i mëveshët edhe vetë Daririt, e që ndoshta nxënësi ka shkruar atë që ka diktuar mësuesi i tij i verbër dhe kështu dalin dy autorë.

3. dhe 4. Komenti i Ebu’l Berakat Nesefiut (vd. rreth 710 hixhri). Edhe ky është nxënës i Kerderiut. Tani për tani, komenti i tij është i vetmi i botuar dhe njëherësh edhe më i famshmi. Ai mban titullin “*El Mustesfa*” (shq.: I përzgjedhuri) dhe është botuar në Stamboll në vitin 2017 në tre vëllime me gjithsej rreth 1700 faqe. Është libër shumë i famshëm dhe citohet e haset bollshëm në librat e zgjeruar të fikhut hanefi. Bile, ky koment i Nesefiut duket se qe shkaku për jetëgjatësinë e vetë doracaku të Ebu’l Kasim Semerkandit dhe shpëtimin e tij nga zhdukja gjatë pushtimeve mongole. Në këtë koment ka ca shënime që japin të kuptohet se Nesefiu pati shkruar dy komente mbi këtë doracak, ku njëri ishte më i zgjeruar dhe tjetri më i shkurtër. Komenti i shkurtër del te jetë ky i botuari në tre vëllime.<sup>12</sup> (vijon)

- 1 Jusuf Abdurrahman el Mer’ashli, *Mesadiru’d Dirasati’l islamijeh el fikhu’l hanefiju furuan ve usulen*. (Bejrut: DKI, 2020), vëll. 1, fq. 282
- 2 Për jetën e tij shiko: Abdulkader Kurashi, *El Xhevahiru’l Mudijeh fi tabekati’l-hanefijeh*. (Hajderabad: mexhlisu dairati’l-mearif, 1914), vëll. 2, fq. 147, bio. nr. 451; Mulla Ali Lexuesi, *El Ethmaru’l-xhenijeh*. (Bagdad: Divan vakfi sunni, 2009), vëll. 2, fq. 638; Abdulhaj Leknevi, *El Fevaidu’l-Behijeh fi teraxhimi’l-hanefijeh*. (Kairo: daru’l-kitabi’l-islamij, 1924), fq. 220.
- 3 Shiko: *El Ethmaru’l xhenijeh*, vëll. 2, fq. 638; Kefevi, *Ketaibu Ealami’l ehjar min fukahai medhhebi’n Nu’mani’l-muhtar*. (Stamboll: Mektebetu’l-irshad, 2017, botimi I), vëll. 2, fq. 515; Omer Rida Kehaleh, *Mu’xhemu’l muelfinë*. (Bejrut: Muesesetu’r-risaleh, 1993, botimi I), vëll. 3, fq. 789 dhe *Mesadiru’d Dirasati’l islamijeh el-fikhu’l-hanefiju furuan ve usulen*, vëll. 1, fq. 282.
- 4 Për udhëtimin e haxhit, vitin e vdekjes dhe shkaku e vdekjes shiko: *El Xhevahiru’l Mudijeh fi tabekati’l hanefijeh*, vëll. 2, fq. 147 dhe *El Ethmaru’l xhenijeh*, vëll. 2, fq. 638
- 5 *Mesadiru’d Dirasati’l islamijeh el fikhu’l hanefiju furuan ve usulen*, vëll. 1, fq. 282-284.
- 6 Ebu’l Kasim Semerkandi, *El Multekat fi’l fetava’l hanefijeh*. (Bejrut: Dki, 2000), fq. 467.
- 7 Për vendndodhjen e këtyre pjesëve dorëshkrimore shiko: *Enciklopedinë e Dijanetit të Turqisë*, vëll. 36, fq. 479.
- 8 *El Fevaidu’l-Behijeh fi teraxhimi’l hanefijeh*, fq. 220 dhe *Ketaibu Ealami’l ehjar min fukahai medhhebi’n-Nu’mani’l muhtar*. (Stamboll: Mektebetu’l-irshad, 2017, botimi I), vëll. 2, fq. 515
- 9 Shiko: Ebu’l Berakat Nesefi, *El Mustesfa*. (Mekë: Universiteti Um el Kura, 2009, tezë doktorate e pabotuar e redaktuar nga Ahmed Gamidiu), vëll. 1, fq. 126.
- 10 Tashkuprizadeh, *Miftahu’s Saadeh*. (Bejrut: Dki, 1985), vëll. 2, fq. 257.
- 11 Katip Çelebi, *Keshfu’dh Dhunun an esamij el kutubi ve’l funun*. (Londër: Al Furqan Foundation, 2021), vëll. 7, fq. 357-358; Abdullah Habeshi, *Xhamiu’sh Shuruh ve’l havashi*. (Xhide: Daru’l-minhaxh, 2017, botimi I), vëll. 3, fq. 497.
- 12 Për më shumë shiko: Hazir Selmani, *Imam Ebu’l Berakat Nesefiu (jeta dhe vepra)*. (Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, punim diplome i pabotuar, 2014, mentori dr. Lulzim Esati), fq. 39-40.

# Këshilla në lidhje me sfidat e edukimit të fëmijëve

MSc. Zamira Bushati

Edukimin në Islam është “kujdesi për rritjen e njeriut në aspektet e tij fizike, mendore, gjuhësore, emocionale, sociale dhe fetare drejt ndryshimit dhe arritjes së shkallës së përsosmërisë dhe pjekurisë.”

Fëmijët janë një ndër dhuratat më të mëdha dhe më të çmuara që Allahu ua dhuroi prindërve. Ata përfaqësojnë gëzimin dhe begatinë në jetën e çdo familjeje, por njëkohësisht sjellin me vete edhe përgjegjësi të mëdha. Këto përgjegjësi nuk janë vetëm në aspektin e sigurimit të jetës së tyre fizike dhe materiale, por më e rëndësishmja në edukimin dhe formimin e tyre shpirtëror dhe moral.

Edukimi i fëmijëve si në rrafshin global, ashtu edhe për familjen dhe shoqërinë myslimane po përballet me një sërë sfidash të reja që kanë nevojë për vëmendje dhe përkushtim të veçantë nga ana e prindërve dhe edukatorëve. Globalizimi, teknologjia, ndryshimet kulturore e presionet sociale kanë ndikuar në mënyrën se si fëmijët perceptojnë vlerat dhe normat morale, fetare dhe sociale. Kohezioni dhe autoriteti i familjes po dobësohet çdo ditë e më shumë për shkak të shumë faktorëve, veçanërisht për shkak të lirisë kaotike, ku fëmija mund të zgjedhë çfarëdo prirje që i shfaqet, e cila i imponohet pa marrë parasysh traditat, moralet dhe vlerat mjedisore. Kjo ka sjellë efektet e dëmshme të saj, të cilat përfaqësohen nga devijimi i të rinjve në anomalitë e tyre intelektuale dhe morale, nga sjelljet e tyre jo korrekte, nga

dekadencia..., të cilat tashmë janë bërë norma të zakonshme në shoqërinë moderne. Megjithatë, për myslimanët, udhëzimet e Islamit mbeten një burim i pandryshueshëm për edukimin e fëmijëve, të cilat ofrojnë një bazë të fortë morale dhe shpirtërore për të përballuar sfida e ndryshme me të cilat përballen.

Në edukimin islam edukatori i vërtetë është Zoti i Plotfuqishëm, Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, Krijuesi i fitres dhe Dhuruesi i talenteve. Është Ai që na ka dhënë ligje për rritjen, përparimin dhe ndërveprimin e shpirtit njerëzor, gjithashtu ka vendosur metoda dhe mënyra për të arritur përsosmërinë, drejtësinë dhe lumturinë e njeriut. Ky edukim është një obligim për prindërit, mësuesit e shoqërinë dhe një amanet i bartur nga njëri brez te tjetri.

Për sa i përket kuptimit terminologjik të edukimit, që përputhet me edukimin në Islam është “kujdesi për rritjen e njeriut në aspektet e tij fizike, mendore, gjuhësore, emocionale, sociale dhe fetare drejt ndryshimit dhe arritjes së shkallës së përsosmërisë dhe pjekurisë.”<sup>1</sup>

Në kuptimin e tij të gjerë, edukimi në Islam nënkupton grupe procesesh dhe përpjekjesh të drejtuara, që arrijnë ndryshimin e dëshiruar në sjelljen e individëve në jetën, kushtet dhe rrethanat e shoqërive në të cilat jetojnë. Në

lidhje me individin, është ndryshimi i një procesi të shfaqjes dhe rritjes së aftësive të tij dhe i aspekteve të ndryshme të personalitetit të tij. Gjithashtu konsiderohet një proces i të mësuarit dhe përshtatjes me mjedisin, një proces normalizimi dhe socializimi shoqëror dhe një proces përgatitjeje për jetën në një shoqëri të caktuar.<sup>2</sup>

Edukimi islam karakterizohet nga fakti se qëllimi i tij është i lidhur me besimin, pra, jo vetëm me jetën e kësaj bote, por edhe me jetën e amshuar, ndryshe nga shumë vende të tjera në të cilat edukimi fokusohet vetëm në lidhje me jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj. Ky qëllim është edhe ndryshimi thelbësor, i cili sjell ndryshime në parime dhe metodologjinë e edukimit islam, sepse ai na urdhëron që ta shijojmë këtë botë sipas asaj që ka urdhëruar Zoti i Madhëruar, duke pasur si synim ahiretin. Allahu xh.sh thotë: *“Por përpiku me atë që të ka dhënë Allahu të fitosh jetën e botës së ardhshme duke mos harruar pjesën tënde në këtë botë...”* (El Kasas, 77).

Po t'i rikthem historisë islame do gjejmë shembuj të pafundmë ku myslimanët e hershëm e arritën këtë qëllim në shumë çështje për të mirën e fesë dhe botës së tyre. Ata ishin të interesuar të studionin shkencat e fesë, siç ishin të interesuar të studionin gjuhën (gjuhët), historinë, gjeografinë, kiminë, astronominë, mjekësinë, etj., e të cilët falë këtij edukimi gjithëpërfshirës mundën të ndërtonin një qytetërim të mrekullueshëm, që i siguroi botës një pasuri kulturore dhe shkencore, e cila është baza për zhvillimin e gjithë qytetërimit modern.

Edukimi në Islam është një proces i gjatë, i cili fillon para se të bëhesh prind, merr përgjegjësinë e plotë pasi bëhesh prind dhe vazhdon gjatë gjithë jetës. Rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe shkolla, shoqëria



Edukimi në Islam është një proces i gjatë, i cili fillon para se të bëhesh prind, merr përgjegjësinë e plotë pasi bëhesh prind dhe vazhdon gjatë gjithë jetës.

dhe mjedisi ku rritet fëmija, por përgjegjësia më e madhe bie mbi prindërit, si edukatorët e parë dhe më të rëndësishëm, veçanërisht deri në moshën e pjekurisë së fëmijës. Për këtë Allahu xh.sh. thotë: *“O ju që besoni! Ruani veten tuaj dhe familjet tuaja nga zjarri...”* (Et Tahrim, 6). Gjithashtu i Dërguari i Zotit, Muhamedi (paqja e Zotit qoftë mbi të), një transmetim të Ibën Omerit r.a. ka thënë: *“Secili prej jush është bari dhe përgjegjës për tufën e tij; prijësi i popullit është bari dhe përgjegjës për tufën e tij (popullin e tij), dhe burri është bari i familjes së tij dhe përgjegjës për të. Gruaja është bareshë e shtëpisë së*

*burrit dhe e fëmijëve të saj dhe përgjegjëse për ta...”*<sup>3</sup> (Buhariu, 5200 dhe Muslimi, 1829). Për ta përmbytur këtë rol, për të gjithë prindërit është thelbësore që ata të kenë një kuptim të thellë dhe të qartë të parimeve të edukimit, t'i njohin e t'i kuptojnë vetë këto parime dhe të jenë shembull i praktikimit të tyre në jetën e përditshme. Të kenë fëmijën si prioritetin kryesor e t'i kushtojnë vëmendjen e duhur, sidomos derisa fëmija ta kalojë moshën e adoleshencës, sepse në të kundërt, fëmija tenton që këtë vëmendje ta marrë nga të tjerët, e cila shpeshherë rezulton të jetë në dëm të tyre.

Siç u theksua më lart, edukimi i fëmijëve në ditët e sotme, përballet me një sërë sfidash, disa prej të cilave kanë lidhje me prindërit personalisht, p.sh. me komunikimin e tyre, sjelljen, përkushtimin, mbajtjen e përgjegjësive, etj., e disa të tjera lidhen me faktorë të jashtëm, por për nga pesha dhe rëndësia që mbartin kanë ndikim në edukim po aq sa vetë roli i prindërve. Në këtë shkrim do përmendi tri sfidat më kryesore e më të rëndësishme, që lidhen me faktorët e jashtëm, me të cilat përballet prindërit myslimanë në edukimin e fëmijëve të tyre dhe disa këshilla si mundësi për t'i përballuar ato.

## TEKNOLOGJIA DHE MEDIA SOCIALE

Një nga sfidat më të mëdha për prindërit e sotëm është ndikimi i teknologjisë dhe medias sociale në jetën e fëmijëve. Që kur hapin sytë fëmijët e sotëm rrethohen në çdo ambient nga teknologjia; prindër që përdorin smarphonët e tyre, fëmijë që lozin në celularë e tableta, televizorë gjigantë që transmetojnë çdo gjë nga interneti, etj.. Të gjitha këto krijojnë idenë se nuk mund të jetohet pa teknologji dhe se ajo është e pazëvendësueshme. Kjo teknologji, përveç lehtësimeve që sjell, mbart edhe pasoja shumë të dëmshme për të gjithë, e në veçanti për fëmijët. Disa nga këto pasoja lidhen me mungesën e komunikimit tradicional të drejtpërdrejtë me njerëzit, me krijimin e varësisë ndaj teknologjisë dhe me ekspozimin ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, rreziqeve dhe ndikimeve të dëmshme kulturore që përmbajnë. Fëmija me brishtësinë e vet nuk është i aftë të arrijë të përzgjedhë e të seleksionojë mundësitë që ofron kjo teknologji. Ai mund të bjerë shumë shpejt viktimë e saj.

Prandaj, prindërit duhen të jenë të vetëdijshëm për këto sfida dhe të vendosin rregulla të qarta për përdorimin e saj, duke filluar së pari me veten e tyre e më pas duke inkurajuar përdorimin e saj për qëllime pozitive dhe edukative. Duhet të gjejnë mënyrat e duhura për t'ua shpjeguar fëmijëve të tyre, se teknologjia siç ofron mundësi për edukim dhe zhvillim, mund të sjellë edhe rreziqe të mëdha. Duhet të vendosin

*“Njeriu është në fenë e mikut të tij, prandaj shikoni me kujdes kë e bëni mik.”*  
(Tirmidhiu, 2378).

rregulla për përdorimin e teknologjisë, si p.sh. kohë të kufizuara për përdorimin e telefonit ose tabletit, inkurajimi i fëmijëve të përdorin aplikacione edukative islame, etj.. Për shembull, në vend që të lejojnë fëmijët të shikojnë video të rastësishme në internet, mund t'i drejtojnë ata drejt videove edukative për historitë e profetëve, të mësojnë sure të ndryshme nga Kurani, shikimi i tregime të ndryshme nga sahabët, njohuri shkencore për të cilat flet Kurani, etj.. Gjithashtu shpjegimi dhe ndërgjegjësimi, se si çdo njeri ashtu edhe ne do japim llogari para Zotit për çdo gjë që shohim, flasim apo bëjmë në këtë botë. Për këtë na paralajmëron edhe Zoti në Kuran, i Cili thotë: *“Kur do të vijë afër zjarrit, kundër tyre do dëshmojnë veshët, sytë dhe lëkurat e tyre për atë që ata kanë bërë.”* (Fussilet, 20).

## SHOQËRIA DHE MJEDISI SOCIAL

Një tjetër sfidë në ndikimin e formimit të personalitetit të fëmijëve është shoqëria dhe mjedisi social. Në një botë ku normat morale dhe shoqërore mund të ndryshojnë nga një komunitet në tjetrin, është e rëndësishme që prindërit të tregojnë kujdes se me kë shoqërohet fëmija i tyre dhe në çfarë ambientesh sociale kalon një pjesë të kohës të tij. Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) duke treguar peshën dhe ndikimin që shoku/shoqja ka duke thënë: *“Njeriu është në fenë e mikut të tij, prandaj shikoni me kujdes kë e bëni mik.”*<sup>4</sup> (Tirmidhiu, 2378).



Prindërit duhet t'i inkurajojnë fëmijët e tyre të zgjedhin shoqëri që ndajnë vlera islame. Të marrin pjesë në aktivitete që promovojnë vlera pozitive, të cilat krijojnë një mjedis të shëndetshëm social dhe shpirtëror, i cili është thelbësor për zhvillimin e mirë të tyre. Të marrin pjesë me fëmijët e xhamisë, në komunitetet islame lokale ku ata mund të luajnë e të mësojnë së bashku, të cilat ndihmojnë në forcimin e identitetit islam të tyre.

## EDUKIMI NË SHKOLLA LAIKE

Prindërit shqiptarë përballen edhe me një sfidë tjetër, e cila është sfida e sistemit arsimor laik, ku shumica dërmuese e shkollave, në të cilat mësojnë fëmijët në trojet shqiptare janë laike, edhe pse mendoj se tashmë ka ardhur koha, që edhe ne të ndjekim eksperiencën e shteteve më të përparuara të Evropës, duke futur lëndën e “Edukatës fetare” në kurrikulën mësimore.

Po t'i hedhim një sy eksperiencës së shteteve të Evropës në lidhje me moralin dhe edukatën fetare në shkolla, do shohim se shumica e këtyre vendeve kanë përfshirë në sistemin arsimor dhe po zhvillojnë në shkollat e tyre mësimin e lëndës së “Edukatës fetare”. Në disa shtete ajo zhvillohet si lëndë e detyruar, e në disa të tjera si lëndë me zgjedhje.<sup>5</sup>

Në Gjermani, Luksemburg, Austri, Belgjikë e Holandë lënda e “Edukatës fetare” është lëndë e detyruar në programin arsimor, ndërsa në Irlandë zhvillohet si lëndë jo e detyrueshme. Në këto shtete, kjo lëndë, jo vetëm që jepet sipas përkatësisë fetare të shumicës së popullatës, por u jepet mundësia edhe pakicave kombëtare që të zhvillojnë këtë lëndë sipas besimit të tyre përkatës. Një eksperiencë të shkëlqyer në këtë fushë po e jep Austria dhe Belgjika ku si pjesë e “Edukatës Fetare” po jepet edhe lënda e “Edukatës Islame” për popullsinë myslimane.<sup>6</sup>

Duke iu kthyer realitet tonë shqiptar, shumica e fëmijëve tanë ndjekin shkollat laike. Ata janë të ekspozuar ndaj një sistemi arsimor, i cili jo vetëm që nuk përfshin mësim fetare, por shpeshherë përçon vlera ose tradita, që janë në kundërshtim me edukimin islam. Për shembull, në shumë shkolla shtetërore në Shqipëri më 31 tetor, festohet festa e Halloween-it, e cila nuk ka lidhje fare me asnjë traditë tonën kombëtare apo fetare. Situata të ngjashme krijojnë një hendek mes asaj që mësohet në shtëpi dhe asaj që mësohet në shkollë, por edhe ndikojnë negativisht te fëmijët me pasojat që sjellin, si dyzimi, etj.. Si rezultat, prindërit duhet të tregohen vigjilentë e të kujdesshëm për aktivitetet shkollore dhe jashtëshkollore, në cilat përfshihen fëmijët e tyre. Ata duhet të komunikojnë e të zhvillojnë biseda sqaruese e bindëse me fëmijët e tyre, për t'i ndërgjegjësuar për sfidat e mundshme që mund të hasin gjatë arsimimit në këto shkolla. Gjithashtu duhet të përpiqen maksimalisht për t'ia plotësuar mungesën e edukimit fetar në shkollë, me organizime të mësimave fetare shtesë në shtëpi

apo në xhami, duke i inkurajuar fëmijët të marrin pjesë në aktivitete dhe kurse fetare që zhvillohen gjatë fundjavës ose pushimeve, për të forcuar kështu besimin e tyre dhe për të siguruar një edukim të plotë shpirtëror, moral dhe intelektual të tyre.

Përballja me sfidat dhe përpjekja për të edukuar fëmijët sjell me vete edhe mundësi unike për secilin prind, për t'i udhëzuar fëmijët drejt një jete të devotshme e të përmbushur. Shpesh këto mundësi dhe zgjidhje janë edhe mësim për vetë prindërit. Këtu po përmendi disa këshilla të përgjithshme, të cilat duhen të kihen parasysh e që mund t'i vijnë në ndihmë prindërve gjatë rrugëtimit të edukimit të fëmijëve:

Prindër, duhen të jeni të sigurt se me çfarëdo dhe sado vështirësi e sfida të përballeni gjatë edukimit, mbështetja te Zoti i Madhërishtë është çelësi për zgjidhjen e çdo gjëje.

Duhet të ndërtoni një bazë të fortë fetare për veten, e cila këshillohet të merret para se të bëheni prindër.

Të përpiqeni për të praktikuar vetë atë që thoni, që të jeni model shembullor për fëmijën tuaj.

Këshillohuni me njerëz të ditur e kompetentë, jo vetëm në fushën e edukimit, por veçanërisht në atë fetare.

Komunikoni rregullisht me fëmijët për çdo problem apo situatë, krijoni ura lidhëse dhe besueshmëri, diskutoni për arsyet e veprimeve të tyre përpara se të merrni vendime.

Tregohuni të vëmendshëm që fëmijët tuaj të marrin njohuritë bazë fetare që duhet të ketë çdo njeri, ashtu siç kujdeseni për njohuritë e tjera.

Zgjidhni mjedisin dhe shoqërinë ku fëmija juaj do kalojë kohën e lirë.

Monitoroni dhe drejtoni përdorimin e teknologjisë nga ana e fëmijëve, e jo duke e ndaluar përdorimin e saj (siç veprojnë disa prindër). Etj., etj..

Allahu na bëftë prindër të përgjegjshëm, na ndihmoftë në kryerjen e kësaj detyre fisnike me përkushtim dhe devocion, në mënyrë që të rrisim e të edukojmë fëmijët dhe brezin e ri me moralin e bukur islam si besimtarë dhe qytetarë të mirë, të gatshëm për të përballuar çdo sfidë që u sjell jeta!

1 Shih: Muhamed H. Nasir dhe Haula Dervish, *Terbijetul atfali fi rihabil Islam*, (Xhiddde, Mektebetu Sevadi, Botimi III, 1994), fq.24.

2 Shih: Po aty, fq. 24.

3 Muhamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*. (Damask, Beirut, Dar Ibën Kethir, 2002), 1326. Muslim bin el Haxhxhaxh, *Sahih Muslim*. (Rijad, Dar Tajjibe, 2006), 886.

4 Muhamed bin Isa et Tirmidhi, *El Xhamiu el Kebir*. (Bejrut, Dar el Garb el Islami, 1996, vëll. IV), 187.

5 Bushati, Zamira, (Edukimi i brezit të ri me moralin fetar), *Etika, shkurt*, 2012, 47. <https://progresibotime.com/revista-etika/etika-47-shkurt-2012/>

6 Shih: Llorent-Vaquero, Mercedes, “Religious Education in Public Schools in Western Europe”. *International Education Studies*, Vëll. XI, Nr. 1, (2018) Published by Canadian Center of Science and Education. 158-160. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/EJ1165245.pdf>.

# Reciprociteti, kusht për ruajtjen e familjes

Mr. Artan Musliu

*“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji i palëve (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”*

(Er Rrum, 21).

Sot, kur bota është duke u përballur me një dinamikë të jetës, me ndikimet dhe trysnitë e shumta që vijnë nga faktorë të shumtë, siç janë: materializmi, rrjetet sociale, civilizimi, modernizmi, e shumë propaganda të tjera, që për synim primarë kanë shturjen dhe shkatërrimin e familjes, duhet që të jemi më vigjilent dhe më syhapur. Pra, duhet që të kthehemi dhe të gjejmë masat dhe mjetet mbrojtëse për të mbrojtur vetën dhe familjet tona nga rënia pre dhe viktimitë e tërë kësaj krahure, që është duke na u servirë në këtë kohë.

Prandaj, nëse kthehemi dhe i hedhim një sy citateve të Kuranit që flasin për familjen, shohim se strumbullari dhe themeli i ruajtjes së marrëdhënieve bashkëshortore në veçanti por, edhe i marrëdhënieve ndër njerëzore, në përgjithësi është reciprociteti.

Allahu xh.sh., në Kuran, tekta flet për marrëdhëniet ndërmjet dy bashkëshortëve, si themel bazë për krijimin e familjes, thotë: *“Dhe nga faktet (e madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji i palëve (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë.”*





Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” (Er Rrum, 21).

Pra, Allahu xh.sh. në këtë citat të Kuranit na tregon se mes bashkëshortëve ka krijuar dashuri dhe mëshirë. Por, padyshim se kjo do të jetë funksionale dhe do të japë frytet dhe efektet e saj pozitive vetëm nëse ndodh dhe nëse praktikohet në mënyrë reciproke mes dy bashkëshortëve.

Në këtë botë, asgjë nuk mund të funksionojë nëse ajo bëhet njëanshëm dhe asnjë iniciativë nuk mund të rezultojë pozitivisht nëse ajo vije vetëm nga njëra palë. Pavarësisht, nëse kjo iniciativë dhe kjo përpjekje vije nga mashkulli apo nga femra. Pra, nuk ka rëndësi nga kushdo që vije por, në momentin që është e njëanshme, ajo është e pavlerë dhe e padobishme. Kështu që, duhet të jetë vetëm në mënyrë reciproke për të dhënë efektin e duhur.

Sot, shohim se si mashkulli penalizohet nga iniciativa dhe përpjekja e tij për të ruajtur familjen e tij. Ky penalizim vije duke e nënçmuar dhe duke e nënvlerësuar rolin e tij, angazhimin e tij, punën e tij, përpjekjen e tij dhe çdo gjë që ofrohet nga ana e tij. E tërë kjo, bëhet gjoja në emër të lirisë dhe barazisë gjinore. E që në fakt, vetë barazia është padrejtësi në vetvete, ngase nuk mund të ketë barazi në mes të dy gjërave të ndryshme. Prandaj, përderisa femra dhe mashkulli dallojnë për nga natyrshmëria e krijimit të tyre atëherë, nuk mund të pretendohet se këto dy krijesa duhet që të kenë të drejta dhe pozita të barabarta. Ngase, kjo është padrejtësi.

Drejtësi e vërtetë dhe me plotë kuptimin e fjalës, do të ishte vetëm atëherë kur çdokush dhe çdo gjë merr atë që meriton, që përkon me nevojat e tij apo të saj. Prandaj, transmetohet se kur Pejgamberi a.s. kishte vëllazëruar në mes të ensarëve dhe muhaxhirë, ai a.s. kishte vëllazëruar në mes të Selman el Farisiut dhe Ebu Derdas, Allahu xh.sh., qoftë i kënaqur me ta. E ndërsa, Selman el Farisiu r.a. e kishte vizituar një ditë Ebu Derdan r.a. në shtëpinë e tij, ai r.a. e kishte parë bashkëshorten e Ebu Derdas r.a., që kishte hequr dorë nga kujdesi ndaj vetvetes. Ajo, ishte veshur me rroba të thjeshta dhe ngjasonte më shumë me një shërbëtoreshë sesa me një bashkëshorte dhe zonjë shtëpie. Selman el Farisiu r.a. e pyeti për arsyen e gjendjes së saj dhe bashkëshortja e Ebu Derdas i tregoi se vëllai i tij kishte hequr dorë nga nevojat e tij prej kësaj bote. Pra, ai i ishte përkushtuar vetëm adhurimit ndaj Zotit xh.sh. dhe nuk kishte nevojë për asgjë nga kjo botë. Selman el Farisiu atë natë qëndroi tek Ebu Derda r.a. dhe e

Drejtësi e vërtetë dhe me plotë kuptimin e fjalës, do të ishte vetëm atëherë kur çdokush dhe çdo gjë merr atë që meriton, që përkon me nevojat e tij apo të saj.

pa vetë gjendjen e tij. Ai r.a., me të vërtetë i ishte përkushtuar vetëm adhurimeve ndaj Zotit xh.sh. dhe kishte lënë pas dore familjen e tij. Në mëngjes, Selman el Farisiu r.a., i tha Ebu Derdas r.a.: “Me të vërtetë, ti ke obligime ndaj Allahut xh.sh., ndaj vetvetes tënde dhe ndaj familjes tënde. Andaj, jepja çdo kujt të drejtën e tij.” Në mëngjes, ata shkuan te Pejgamberi a.s. dhe i treguan se çfarë e kishte këshilluar Selman el Farisiu r.a., Ebu Derdan r.a., ndërsa, Pejgamberi a.s. i tha: “Me të vërtetë, Selmani e ka thënë të vërtetën.”<sup>1</sup>

Allahu xh.sh. në një citat tjetër të Kuranit, thotë: “... dhe mos dëmtoni njerëzit në gjësendet e tyre...” (Hud, 85). Pra, e shohim se fjala “gjësende” ka ardhur në trajtën e pashquar dhe si e tillë është në formën e përgjithësuar. Do të thotë përfshinë çdo gjë duke mos lënë anash as të drejtat e të tjerëve.

Kështu pra, njeriu duhet që të kujdeset që t’ua japë të drejtën meritore të gjithë njerëzve, duke filluar nga bashkëshortja apo bashkëshorti, prindërit, fëmijët, vëllezërit, motrat, farefisi, shoqëria dhe në përgjithësi njerëzit me të cilët rrethohet.

Por, a do të ishte e mjaftueshme që kjo përpjekje të jetë vetëm nga njëra palë...? Pra, do të jetë efektive dhe a do të arrinte qëllimet dhe synimet e saja nëse vije vetëm nga njëra anë...?

Assesi, çdo trajtesë dhe çdo përpjekje e njëanshme është e dështuar dhe është e padobishme. Prandaj, nëse bashkëshorti mundohet që me çdo kusht të ruaj familjen dhe të bëjë çmos për lumturinë dhe harmoninë e jetesës bashkëshortore ndërsa, bashkëshortja rri duarkryq atëherë kjo marrëdhënie bashkëshortore do të jetë e dështuar. E njëjta gjë, do të ndodh edhe nëse ndodh e kundërta. Pra, nëse bashkëshortja jep çdo gjë nga vetvetja e saj ndërsa bashkëshorti rri duarkryq atëherë, kjo lidhje bashkëshortore do të jetë e shkatërruar dhe e fundosur.

Allahu xh.sh., në një citat tjetër të Kuranit, thotë: “... ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato...” (El Bekare, 187). Pra, edhe një herë na dëshmohet shumë qartë se themeli i ruajtjes së një marrëdhënie ndër njerëzore, në përgjithësi, dhe i atyre ndër bashkëshortore, në veçanti, është reciprociteti.

Por, pyetja shtrohet se çfarë duhet të bëjmë në rast se mungon reciprociteti...?

Besimtari duhet që të mundohet me çdo kusht që të ruajë dhe të mbrojë vetveten e tij, familjen e tij, nderin dhe pasurinë e tij. Por, tërë këtë përpjekje duhet që ta bëjë brenda suazave të normales dhe pa e dëmtuar askënd dhe asgjë. E në rast se,



pas marrjes së të gjitha mundësive dhe të gjitha shkaqeve e gjen të kotë përpjekjen e tij dhe e sheh se nga pala tjetër nuk ka ndonjë reagim dhe nuk ka ndonjë përgjigje pozitive ndaj kësaj përpjekjeje atëherë, nuk duhet që të lejojë të dëmtojë vetveten e tij dhe të shkatërrojë vetveten e tij për hir të askujt dhe të asgjëje. Kjo, ngase asgjë dhe askush nuk ka vlerë dhe nuk ka të drejtë më të madhe ndaj tij, sesa ai ndaj vetvetes së tij.

Në këtë botë, çdo gjë është kalimtare dhe asgjë nuk është e përhershme. Prandaj, edhe raportet tona me njerëz por, edhe raportet tona familjare mund të jenë të destinuara që të shkojnë drejt fundit dhe drejt përfundimit. Ashtu, siç ka ardhur edhe në një prej transmetimeve ku Xhibrili a.s. kishte ardhur te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë: “O Muhamed, jeto sa të duash por, me të vërtetë, ti ke për të vdekur. Duaje kë të duash por, me të vërtetë, do të ndahesh prej tij. Vepro çfarë të duash por, me të vërtetë, do të shpërblehesh për të.” Pastaj, Xhibri a.s. i tha: “O Muhamed, nderi i besimtarit është

**Besimtari dhe besimtarja duhet që t’ua duan të tjerëve atë që duan për veten e tyre, duhet që të sillen me të tjerët ashtu siç duan që të sillen me ta, duhet që të respektojnë dhe të kujdesën për të tjerët ashtu siç duan që të respektohen dhe të kujdesën për ta.**

në namazin e natës dhe krenaria e tij është në mosvarësinë e tij ndaj njerëzve.”<sup>2</sup>

Prandaj, çdo lidhje dhe çdo marrëdhënie jona me të tjerët pavarësisht natyrës së saj, është e destinuar që të shkojë drejt fundit. E ky fund, mund të jetë për shkaqe të ndryshme por, më së shumti mund të ndodh për shkak të mungesës së reciprocitetit. Andaj, çdo kush që dëshiron të ruajë një marrëdhënie, qoftë bashkëshortore apo çfarëdo qoftë ajo, mes njerëzve duhet që të luftojë dhe të bëjë përpjekje për jetësimin dhe praktikimin e parimit të reciprocitetit. Në të kundërtën, çdo gjë do të jetë e dështuar dhe e kotë. E në raste të dështimit, më së shumti do të dëmtohet ai që ka bërë më së shumti përpjekje dhe që ka lidhur dhe ka varur çdo gjë tijen te pala tjetër. Përderisa, pala tjetër ka qëndruar indiferent dhe gjakftohtë ndaj këtyre raporteve dhe këtyre marrëdhënieve.

Besimtari dhe besimtarja duhet që t’ua duan të tjerëve atë që duan për veten e tyre, duhet që të sillen me të tjerët ashtu siç duan që të sillen me ta, duhet që të respektojnë dhe të kujdesën për të tjerët ashtu siç duan që të respektohen dhe të kujdesën për ta. Bashkëshorti dhe bashkëshortja, duhet që të duan, të respektojnë, të ruajnë, të kujdesen, të punojnë për tjetrin ashtu siç duan dhe kanë dëshirë që tjetri të jetë në raport me të. E në të kundërtën, le të bëhen gati të përballen me pasojat, qoftë në këtë botë por, po ashtu edhe në botën tjetër. E mos të befasohen nga asgjë, sepse çdo gjë vije si rezultat i veprave dhe punëve tona e asgjë nuk vije nga hiçi.

1 Këtë transmetim e transmeton Vehab ibën Abdullah es Sevajj, Ebu Huxhejve, ndërsa e shënon Imam Buhariu në Sahihun e tij, hadithi numër 1968.


2 Këtë transmetim e transmeton Sehel ibën Sad es Saidij, ndërsa e shënon Imam et Taberaniu në “*El Mu’xhem el Evsat*”, transmetimi 4278.

# Në kujtim të 40-vjetorit të përkthimit të Kuranit në gjuhën shqipe

Akad. Feti Mehdiu

Në “hatllat e mia” ka shumë qershore, ai i vitit 1964, qershori i vitit 1967, ai i vitit 1968 etj., por këtë herë po shpalos kujtimet për 40-vjetorin e përkthimit të Kuranit, 80-vjetorin e lindjes së përkthyesit dhe 120-vjetorin e vdekjes së Sami Frashërit. Përkthimi ra në duart e lexuesve shqiptarë në qershor të vitit 1985, ani pse unë, që në vitin 1984, e kisha përfunduar përkthimin.

Procedurat e radhës, si redaktimi gjuhësor, konsulta profesionale, procedura e lejes për



Lexoi disa faqe dhe brofi në këmbë! U vesh me kostumin që shkonte në punë, lidhi kravatën dhe i tha vetes: Veprat si kjo nuk lexohen në pozitën shtrirë!

botim, botuesi, vendi etj., vazhdonin, e që të gjitha këto më shtynë që këtë fletë ta shpalos tash, në qershorin e vitit 2024, kur bëhen 120-vjet nga vdekja e Sami Frashërit. Kjo në vete ngërthen edhe lidhjet Sami Frashër – Ibrahim Rugova dhe botimi i parë i komplet përkthimit të Kurani Kerimit.

**“KURANI DUHET LEXUAR ME KRAVATË” – MË THA IBRAHIMI NË VITIN 1984**

Me Ibrahim Rugovën njiheshim që nga viti 1973, në kohën kur ai punonte asistent në Institutin Albanologjik, tek barakat e vjetra të studentëve, ku tashmë gjendet Biblioteka Kombëtare e Kosovës. Atë kohë unë punoja në Entin e Historisë së Kosovës, tashmë Instituti i Historisë. Kur kalova në degën e Orientalistikës në Fakultetin Filozofik, shihemi më shpesh, kurse në vitin 1982, Sami Frashëri me romanin “Dashuria e Talatit dhe Fitnetit”, na afroi edhe më shumë. Arsyeja për këtë ishte se Mehdi Polisi e kishte përkthyer romanin e Sami Frashërit, dhe duke ndjekur procedurën e botimit, ia shpalosa këtë dr. Ibrahim Rugovës, me lutjen që ai t’ia hedhë një sy përkthimit dhe të vazhdojë procesi për shtyp. Romani i Sami Frashërit, “Dashuria e

Talatit dhe Fitnetit”, e kishte entuziazmuar kritikun letrar, dr. Ibrahim Rugova, dhe kur u takuam për këtë çështje, më tha: “Këtë, Feti, duhej lexuar me kravatë!”

I kërkova një sqarim për këtë shprehje, e ai ma shpjegoi, duke ma përmendur një shkrimtar botëror, që nuk e kujtoj dot emrin dhe rrëfimin e tij. Ai kishte blerë një libër, kalimthi, dhe kur shkoi në shtëpi, u përgatit për çlodhje dhe filloi ta shfletonte librin e porsa blerë. Lexoi disa faqe dhe brofi në këmbë! U vesh me kostumin që shkonte në punë, lidhi kravatën dhe i tha vetes: Veprat si kjo nuk lexohen në pozitën shtrirë!


Veprën e Samiut e lexova, jo me kravatë, por edhe i shtritë jo. I madh ka qenë dhe i madh mbetet Samiu, më tha.

Në vitin 1984, doli nga shtypi romani dhe vepra 7 (Kamusul-a`lam) e Sami Frashërit dhe kur ia dhashë, pasi më uroi, më pyeti edhe për çështjen e përkthimit të Kuranit. Ai e dinte se jam duke punuar në këtë përkthim. Kishim biseduar edhe më parë lidhur me këtë. Ai kishte lexuar përkthim të Kuranit në gjuhën frënge, kishte nxjerr disa përfundime me interes dhe kishte vlerësim të lartë për këtë. I tregova se e kam përfunduar dhe tashmë është në lekturë, duke ia shfaqur dëshirën time që, pas lekturës, t’ia hidhte një lexim me sy të estetit – Ibrahim Rugova ishte kritik letrat dhe estet i dalluar – por nuk pranoi. M’i përmendi disa arsye dhe unë u ngushtova më shumë. E para, më tha se kam angazhime në Institut – ishte duke përfunduar veprën “Kritika letrare shqipe” etj., madje ma përmendi edhe atë rastin e atij shkrimtarit: “Këtë duhet lexuar me kravatë!”

Kur i thash se botues, sipas të gjitha gjasave do të jetë Bashkësia Islame, ai më la këtë porosi: Ata do të kërkojnë leje për botim në Sekretariatit Krahinor për Informata, ku vepron Komisioni për Botime. Sapo ta dërgojnë kërkesën për leje, më informo menjëherë. Do të kërkoj që sa më shpejt të mblidhet Komisioni për Botime dhe që kjo procedurë mos të vonohet.

Unë nuk e dija se Ibrahim ishte në përbërje të atij organi me peshë në Sekretariatit Krahinor. Kështu i lamë fjalët dhe kështu veprova. Në shkurt të vitit 1985, e informova për këtë procedurë dhe Bashkësia Islame mori lejen e botimit, ashtu që në mars, apo prill, filloi procedura e shtypit në shtypshkronjën “Rilindja”. Në qershor të vitit 1958, Kurani arriti në duart e lexuesit shqiptar.

Kur doli nga shtypi, në shenjë mirënjohje, Ibrahim Rugovës, ia dhashë një kopje me një lutje. Nëse ke mundësi ta lexosh me laps në dorë - për ndonjë ribotim – më bën nder edhe mua edhe përkthimit. Ekzemplarin e lexuar me laps, do ta zëvendësojë me një ekzemplarë tjetër, i thash. Këto ishin përpjekjet tona, pa obligim, që ribotimi të jetë në shkallë më të lartë nga këndvështrimi letrar dhe estetik.



Koha eci në binarë të tjerë, dhe me Ibrahimin pas pasur edhe dy raste, që i kujtoj shpesh. Kur erdhi një delegacion i shkrimtarëve të Algerisë në vizitë te Shoqata e Shkrimtarëve të Kosovës, ai më kërkoi ndihmë për gjuhën arabe, për ligjëratën që mbajti në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, kryetari i delegacionit algerian, As Saihi, dhe një takim i shkurtër, në vitin 1991, kur ia përcolla një porosi nga Sarajeva.

Ai ishte destinuar të udhëheqë popullin e Kosovës drejt pavarësisë, por edhe lejen për botimin e përkthimit të Kuranit e realizoi ashtu siç më pati premtuar.

Ribotimet e këtij përkthimi kanë ndjekur rrugë të ndryshme: Prishtinë – Shkup – Stamboll – Prishtinë, dhe në vitin 2024, me përkrahjen financiare të Shoqatës “Zajazi” në Zvicër, doli edhe botimi i katërt, me çka kjo shoqatë, vlerësoi punën e bashkëvendësit të tyre, kujtoi 40-vjetorin e përkthimit dhe botimit të parë të Kuranit të plotë në gjuhën shqipe, që i bie në 80-vjetorin e lindjes së përkthyesit, Feti Mehdiu.

Është privilegj i rrallë kur përjetoj këso momente të jetës. Ndiej obligim e kënaqësi dhe nuk mund të kaloj pa e kujtuar lidhjen: Sami Frashëri – Ibrahim Rugova – botimi i parë i përkthimit të Kuranit, ku këta kanë hisen e vet në këtë rrugëtim. Duken të rastësishme, por Samiu me romanin e parë “Dashuria e Talatit dhe Fitnetit”, fortifikoi lidhjen: Kuran – Feti – Ibrahim.

Kur i Gjithëpushtetshmi do, edhe shkakun e krijon dhe suksesin e garanton.

# Kadare, një “Ismail”, kurban i komunizmit

Nada Dosti

**E** lindur në vitet e fundit të sistemit komunist më të ashpër në botë, dhe e rritur me ndikimin e realizmit socialist, si në letërsi ashtu dhe në kinematografi, me shkrimtarin përfaqësues të kësaj rryme artistike jam njohur që në vegjëli. Në një ndër tregimet e mia (Një fëmijëri me art), botuar në librin “Udhëtime dhe tregime” (LogosA, 2023), përshkruaj se si jam njohur me këtë shkrimtar të madh, librat e të cilit i lexoja fshehurazi edhe pse nuk ishin për moshën time. Kam pasur gjithmonë një marrëdhënie dashurie dhe urrejtje me të: dashuri për veprat, artin, dhe talentin e tij; urrejtje për ideologjitë mbi të cilat besonte dhe të cilat përfaqësonte dhe propagandonte.

Është shumë e vështirë të flitet për shkrimtarë e artistë që ende jetojnë, se nuk mund ta parashikosh dot kurrë se çfarë drejtimi mund të marrin: njerëzit janë gjithmonë të paparashikueshëm dhe deri në frymën e tyre të fundit nuk mund të jepet një verdikt mbi jetën dhe veprat e tyre. Është akoma dhe më e vështirë të flasësh për autorë, të cilët tashmë kanë ndërruar jetë dhe nuk kanë më mundësi të replikojnë apo vetëmbrohen. Megjithatë, në jetë marrim disa vendime, pozicionohemi në disa kahje, dhe pas nesh, me vdekjen tonë lëmë pas një trashëgimi vlerash ose anti-vlerash, që do dëshmojnë pro ose kundra nesh, në dobi ose në dëm të imazhit tonë. Dhe është shumë normale që

njerëzit të gjykojnë në bazë të të tilla vendimeve dhe pozicionimeve.

Kështu, edhe i madhi Kadare shkoi. La pas jo me dhjetëra, por me qindra vepra duke përfshirë këtu jo vetëm librat e tij, por edhe esetë, kritikë, parathënie librash, letër-këmbime e shumë e shumë të tjera. Shkoi me një ëndërr të parrealizuar siç ishte çmimi Nobel i letërsisë. Gjithë jetën vrapoi pas një ëndrre të cilën nuk arriti ta prekë.

## KADARE DHE REALIZMI SOCIALIST

Gjatë periudhës komuniste, artistë e shkrimtarë u ndanë në tri kategori të ndryshme: martirët, pra ata që u vranë dhe u quajtën disidentë për shkak se nuk iu bindën sistemit; abstenuesit, të cilët u përpoqën të bënin letërsi të fshehur duke vepruar gjatë sistemit komunist por duke dënuar atë në forma të tërthorta ose duke mos u marrë fare me sistemin, por duke abstenuar nga politika totalisht; si dhe të devotshmit e sistemit, ku dhe hyn shkrimtari për të cilin po e trajtojmë në këtë shkrim (edhe pse duhet ta pranojmë se, ka pasur disa nota pendese andej nga fundi i sistemit para ardhjes së demokracisë, me ç’rast kohët e fundit nisi ta kategorizonte veten mes llojit të parë dhe llojit të dytë të shkrimtarëve). Dikush mund të kundërshtojë dhe të thotë se Kadare s’ka pasur faj, se ashtu ka qenë sistemi dhe ai ka qenë i detyruar t’i bindej

Veprat që ai i shkroi në vitet 1990-2010, janë një deklaratë e fortë e kundërshtive dhe shndërrimeve që pësoi autori, të cilat lidhen kryesisht me dy arsye “me përpjekjet e Kadaresë për ta vizatuar veten si disident i regjimit komunist dhe së dyti përpjekjeje për të siguruar se shqiptarët janë gjenealogjikisht evropianë”.

sistemit për të shpëtuar kokën. Faji i Kadaresë qëndron te fakti se ai jo vetëm i shërbeu me përkushtim dhe devocion duke ia dedikuar partisë angazhimin e tij partiak dhe civil, duke qenë jo vetëm shkrimtar i realizmit socialist, por dhe teoricieni më i mirë i kësaj rryme.

“Realizmi socialist që nga lindja e vet si rrymë letrare ka qenë një rrymë e panatyrshme, sepse duke u imponuar nga ideologjia bolshevike dhe nga shteti totalitar sovjetik, në plan të parë e ka pasur imponimin e diktatit ideologjik mbi artin, e jo përjetimin dhe afirmimin e vlerave estetike”, shprehet profesori i komunikimit dhe shkrimtari Milazim Krasniqi. “Menjëherë pas instalimit të regjimit komunist në Shqipëri (1944), vendin e optimizmit militant të këngës partizane, e zuri vala e terrorit ideologjik e policor, me të cilën edhe u instaluan brutalisht konceptet e realizmit socialist mbi letërsinë shqipe”, shton ai.

Me të njëjtin mendim është edhe Jameson, i cili sipas tij “Si intelektual i këtyre anëve, ai është gjithmonë në një mënyrë apo në një tjetër, një intelektual politik, dhe Kadareja si i tillë, ka një krijimtari, e cila ka pasur një drejtim të qartë politik.” (Jameson 1986, fq. 65-88).

Ashtu si Sulstarova, i cili gjurmon rastin e orientalizmit të trajtuar në letërsinë propaganduese të Kadaresë, dhe më konkretisht rastin e turkut, në realitetin kadarjan. Ke Jing e sheh “tjetrin” në këtë univers, si ndërtues të identitetit të shqiptarëve nga një anë dhe ilustron se si letërsia përdoret si një mjet për t’i bërë njerëzit të besojnë se çfarë është apo nuk është kombi i tyre nga ana tjetër. (Jing, 2013. 39) Veprat që ai i shkroi në vitet 1990-2010, janë një deklaratë e fortë e kundërshtive dhe shndërrimeve që pësoi autori, të cilat lidhen kryesisht me dy arsye “me përpjekjet e Kadaresë për ta vizatuar veten si disident i regjimit komunist dhe së dyti përpjekjeje për të siguruar se shqiptarët janë gjenealogjikisht evropianë”. (Jing, 2013, fq. 24) Dhe nuk ka arsye tjetër përse Kadare ta ketë bërë këtë vazhdimisht me zell të madh përpos faktit se të qenit evropian e perëndimor vërteton për qasjen supermanciste se perëndimorët janë më të zhvilluar më të denjë, më superiorë sesa lindorët.

Moltgomer Berxhein, shpjegon se shkrimtari është një propagandues i përgjithshëm, domethënë se çdo shkrimtar bën të vetën një pikëpamje apo teori për jetën, e cila është vetë

Kadareja, i cili kaloi një jetë të tërë duke ndjekur një ëndërr që nuk arriti të realizonte – çmimin Nobel në letërsi – mbetet një figurë që do të diskutohet për dekada të tëra, për rolin e tij si shkrimtar i realizmit socialist dhe për përfaqësimin e ideologjisë dhe përplasjes së tij me vlerat e universalizmit dhe pluralizmit.

realiteti shoqëror dhe efekti i veprës së tij është gjithmonë që ta bindë lexuesin ta pranojë atë pikëpamje apo atë teori. Pikëpyetja e madhe mbetet nëse është lexuesi ndikohet nga ky efekt hipnotik duke ditur që atë e tërheq arti i paraqitjes së jetës dhe jo predikimi. Duke u bazuar kështu në këtë shpjegim të Berxheinit rreth një shkrimtari të thjeshtë, çfarë mund të themi atëherë për një shkrimtar të realizmit socialist në përgjithësi, dhe një aktivist-politikan-deputet i devotshëm i Hoxhës?


## KADARE DHE TURKOFobia

Së pari, Kadare ka përdorur dhe promovuar qasje ksenofobe, turkofobe dhe islamofobe. Por a ka qenë vallë i tillë, pra a mund ta akuzojmë atë si ksenofob e me radhë?

Në periudhën e sistemit komunist në Shqipëri, islamofobia u transmetua përmes përdorimit të temave orientalist në artin e realizmit socialist, duke demonizuar kështu bejlerët, agatë, kulakët, hoxhallarët, dervishët dhe të gjithë besimtarët myslimanë, duke i portretizuar ata si oportunistë dhe bashkëpunëtorë me armikun (osmanët), të cilët kishin dorë në shtypjen e natyrës “përparimtare” evropiane të kombit shqiptar. Lufta që regjimi komunist organizoi kundër Islamit në Shqipëri, e njohur si lufta kundër zakoneve prapanike (lufta kundër praktikave të vjetruara), luftoi traditat myslimane si veshja modeste (shami, perçe), abstenimi nga alkooli dhe mishi i dërrit, si dhe besimi në Zot dhe në ahiret.

Në artet dhe mediat e Shqipërisë komuniste, zyrtarët myslimanë dhe turq rëndom quheshin anadollakë (anatolianë), prapanikë (të prapambetur), tradhtarë, dallkaukë (idiotë), turqeli (turq të vegjël/ose gjysmë turq nga njëri prind), dylberë (homoseksualë), aziatikë, fanatikë, bixhozçinjtë, përdhunues dhe barbarët. Ata u portretizuan si një popull me një mision të keq, objektivi kryesor i të cilit ishte shpëputja e Shqipërisë nga Evropa dhe bërja e saj pjesë në Azinë feudale, nëpërmjet procesit të islamizimit. Siç ka treguar Enis Sulstarova, Ismail Kadare, arkitekti kryesor shqiptar i letërsisë kombëtare në Shqipërinë komuniste dhe të sotme; ka qenë dhe është një nga promovuesit më të rëndësishëm të islamofobisë kulturore dhe orientalizmit.

Kadare, periudhën e Perandorisë Osmane e quan “nata osmane”. E quan atë një fatkeqësi dhe një kohë infernale,



duke e shkëputur Ballkanin nga Evropa, merakun më të madh të Kadaresë.

Ndikimi osman, i cili nisi të jetë i dukshëm në aspekte të ndryshme, ka filluar të pushtojë edhe gjuhën shqipe me depërtime si “javashllëk” dhe “kismet”. Supermancia e Kadaresë shkon deri aty duke thënë se gjuha shqipe na qenka “sipëranë” e “tigrëshe në krahasim me turqishten”, po lodhej prej goditjes së shurdhër të bishtit të tjetrës, vetëm e vetëm sepse është e familjes indoevropiane, kurse turqishtja asaj kohe (osmanishtja) ishte më pak e denjë, vetëm e vetëm sepse përfaqësonte gjuhën e armikut dhe prej familjes së gjuhëve aziatike. Kadare në këtë rast e shan dhe sulmon osmanishten dhe e quan të dëshpëruar dhe mjerane përpjekjen për të bërë letërsi në shqip përmes alfabetit osman, por çon në piedestal përpjekjet e para për të shkruar në latinisht. Dhe pyetja lind këtu cili është dënimi më i madh për një gjuhë që të vazhdojë të jetojë nën alfabetin e një ndër gjuhëve më të pasura dhe të shenjta në botë apo të fshihet si frikacake në gjuhë të vdekur? Nga ana tjetër kur është pyetur në një intervistë se cili ka qenë ndikimi i turqishtes në shqipen, ai është përgjigjur “gati i papërfillshëm”.

Në përfundim, shqyrtimi i veprës dhe personalitetit të Ismail Kadaresë në kontekstin e komunizmit dhe turkofobisë na sjell para një figure komplekse dhe të diskutueshme. Kadare, si një nga shkrimtarët më të rëndësishëm të letërsisë shqipe, la një trashëgimi të madhe artistike që përfshin jo vetëm krijimet e tij letrare, por edhe ndikimin e tij në formësimin e identitetit kulturor dhe politik të Shqipërisë. Megjithatë, pozicionimi i tij ideologjik, sidomos gjatë regjimit komunist, dhe qasjet ksenofobe në disa prej veprave të tij, ngrenë pikëpyetje të mëdha mbi trashëgiminë e tij si një

figurë që kontribuoi në promovimin e një narrative të njëanshme dhe ndonjëherë të dëmshme ndaj elementeve të caktuara kulturore dhe fetare.

Kadareja, i cili kaloi një jetë të tërë duke ndjekur një ëndërr që nuk arriti të realizonte – çmimin Nobel në letërsi – mbetet një figurë që do të diskutohet për dekada të tëra, për rolin e tij si shkrimtar i realizmit socialist dhe për përfaqësimin e ideologjisë dhe përplasjes së tij me vlerat e universalizmit dhe pluralizmit. Me gjithë kundërshtitë dhe kritikët, kontributi i tij në letërsinë shqipe është i padiskutueshëm, por historia do të vazhdojë ta vlerësojë nëse ai ishte një martir i sistemit, apo një bashkëpunëtor i tij, dhe se si ky bashkëpunim ndikoi në formësimin e një identiteti të polarizuar kombëtar.

Dhe kështu iu dha lamtumira shkrimtarit të madh të letrave shqipe. Ismail Kadaresë, i biri i Halitit dhe jo i Ibrahimit, i cili vendosi ta bëjë vetën kurban për një ideal.

#### Burimet:

- ExLibris. (2021, January 30). *Kadare: Është e pakuptimtë ajo letërsi që qëndron jashtë kohës së vet*. ExLibris. <https://exlibris.al/kadare-eshte-e-pakuptimte-ajo-letersi-qe-qendron-jashte-kohes-se-vet/>
- ExLibris. (2024, July 16). *Kadare: Doja të mbetesh shkrimtar dhe i lirë*. ExLibris. <https://exlibris.al/kadare-doja-te-mbetesh-shkrimtar-dhe-i-lire/>
- Jing, K. (2013). *The four others in Ismail Kadare's eorok*.
- Kurti, B. (2014, December 30). *DOGÛ'DAN KAÇIŞ - Naimiden Kadareya'ya kadar Arnavut oryantlizmi*. <https://dergipark.org.tr/en/pub/bad1/issue/29500/316614>
- Milazim Krasniqi. (2017, April 13). *ISMAIL KADAREJA DHE REALIZMI SOCIALIST*.
- Myzeqari, I. (2015). *“Ligjërimiti feminist te kadare”* (1st ed.). UET Press. [https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2021/11/Irena\\_Myzeqari.pdf](https://uet.edu.al/ep-content/uploads/2021/11/Irena_Myzeqari.pdf)
- Sulstarova, E. (2016). *Arratisje nga Lindja : Orientalizmi shqiptar nga Naimi te Kadareja*. Pika pa sipërfaqe. <https://books.google.com.tr/oks?id=wHloQy9ELXMC&printsec=frontcover#v=onepage&q&f=false>

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM ANËTARIN E ASAMBLESE TË SHTETIT TË NJU JORKUT, Z. CHARLES D FALL

Më 3 gusht 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim anëtarin e Asamblesë së shtetit të Nju Jorkut, z. Charles D Fall, i cili shoqërohej nga anëtari i Këshillit të shtetit të Nju Jorkut, z. David Carr dhe nga veprimtari i njohur, z. Naser Kika.

Myftiu Tërnavë fillimisht u uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me historikun, misionin, punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë për kontributin e këtij institucioni në bashkëjetesën dhe tolerancën ndërfetare në vend. Ai tha se Bashkësia Islame e Kosovës, si institucioni më i madh fetar në Kosovë,

ndër vite ka luajtur një rol kyç në kultivimin e tolerancës dhe bashkëjetesës fetare dhe, ani pse jemi një vend i vogël, botës i japim shembullin më të mirë për këtë.

Nga ana e tij, z. Fall, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, duke çmuar kështu rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë për proceset që ka kaluar populli i Kosovës.



## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM PROFESORIN UNIVERSITAR NGA AMERIKA, Z. JONATHAN AC BROWN

Më 17 gusht 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim profesorin amerikan, z. Jonathan Andrew Cleveland Brown.

Myftiu Tërnavë fillimisht i uroi mirëseardhje në selinë e BIK-ut në Prishtinë,

e më pas e njohu atë me historinë, organizimin dhe aktivitetet e BIK-ut, njëherësh vlerësoi lart angazhimin e profesorit, veçanërisht punën që ai po bën këto ditë gjatë qëndrimit të tij në Ballkan.

Nga ana e tij, z. Jonathan, shprehu falënderime për mikpritjen nga Myftiu Tërnavë dhe BIK-un, si dhe çmoi vlerësimin e tij për prezantimin e librit “Trashëgimia e profetit Muhamed” dhe uroi që edhe në të ardhmen të ketë bashkëpunime të tilla.





## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E KUVENDIT TË KOSOVËS, Z. ENVER HOXHAJ

Më 28 gusht 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim nënkryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Enver Hoxhaj.

Gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që ta njoh mysafirin me punët dhe angazhimet e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, e të cilat nënkryetari Hoxhaj i vlerësoi si tejet të rëndësishme dhe me peshë për të mbarëvajtjen e jetës fetare në vend.

Myftiu Tërnavë tregoi gatishmërinë dhe përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës të treguar ndër vite për një harmoni dhe një bashkëpunim ndërmjet besimeve fetare në Kosovë.



Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe tema të tjera me rëndësi në të cilat po kalon vendi ynë, si dhe kontributin që duhet ta japim të gjithë për kapërcimin e sfidave me të cilat po përballet Kosova.

## U MBAJTI CEREMONI PËR HAFËZEN E PARË TË AKADEMISË SË KURANIT “HIFDH KIDS”

Më 26 gusht 2024, Akademia e Kuranit “Hifdh Kids”, e cila funksionon në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, organizoi ceremoni me rastin e përfundimit të hifzitet të nxënës Merjeme Shabani, e cila është edhe hafëzja e parë e kësaj Akademie. Ajo, para të pranishmëve recitoi pesë ajetet e fundit të hifzitet të saj, për ta kompletuar kështu tërë mësimin përmendsh të Kuranit fisnik.

Të pranishëm në këtë organizim qenë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, kryeimami Vedat ef. Sahiti, përfaqësuesja e Departamentit të Gruas, znj. Vaxhide Bunjaku, si dhe nxënës të kësaj Akademie.

Myftiu me këtë rast u shpreh i lumtur dhe krenar për të arriturën e këtij suksesi, duke e cilësuar atë si tejet madhor. Ai përgëzoi për punën e tyre madhore dhe përkushtimin e vazhdueshëm muhafizet Rineta Nitaj dhe Fatime Nitaj dhe hafëzen e re. Myftiu inkurajoi që kjo punë të vazhdohet

edhe më tej, me shpresën që Allahu ta lehtësojë këtë rrugëtim të artë, duke dhënë kështu përkrahjen e tij maksimale për mbarëvajtjen e mirëfilltë e të suksesshme të kësaj nisme madhore.

Muhafizet Nitaj, u shprehën tejet krenare për këtë sukses të arritur të nxënësës së tyre, duke lutur Allahun që

të ndihmojë dhe lehtësojë edhe më shumë këtë mision dhe thanë se këtë profesion e kanë zgjedhur me vullnetin më të madh, e të tillin do ta trajtojnë si amanet deri në fund.

Ceremonia u përmbyll me ndarje të certifikatës nxënësës dhe me dhurata motivuese me rastin e këtij organizimi.



## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KËSHILLIT TË RAJONIT TË GORËS, MUNAFIS EF. HOXHËN

Më 28 gusht 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryetarin e Këshillit të Rajonit të Gorës, Munafis ef. Hoxhën.

Gjatë këtij takimi Myftiu Tërnavë u njoh për së afërmi me punët, angazhimet dhe aktivitetet që po zhvillon Këshilli i Rajonit të Gorës, për të cilat ai ofroi mbështetjen dhe përkrahjen e vazhdueshme të tij dhe të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që ta përgëzojë kryetarin Hoxhë dhe imamët e këtij Këshilli për punën dhe angazhimet e tyre dhënë për besimtarët atje, duke u kërkuar që një gjë të tillë ta vazhdojnë edhe në të ardhmen, gjithnjë



duke ua kujtuar këtë si një amanet që e kemi marrë mbi supet tona, atë të transmetimit të porosive të Zotit dhe të të Dërguarit të tij.

## SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM IMAMIN DHE KAPELANIN, TAHIR EF. KUKAJ



Më 7 gusht 2024, sekretari i Përgjithshëm i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka pritur në takim imamin dhe kapelanin, Tahir ef. Kukaj dhe imamin dhe sekretarin e Qendrës Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork, Ferid ef. Bedrollin.

Gjatë këtij takimi, z. Sadriu shfrytëzoi rastin që t'i njoh mysafirët me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e BIK-ut që

të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.

Nga ana e tyre, imamët e nderuar, z. Kukaj dhe z. Bedrolli, fillimisht falënderuan për pritjen dhe më pas falënderuan për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur drejtori për Diasporë, z. Simnica dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me Qendrën Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork. Dy imamët e nderuar gjatë kësaj vizite

njoftuan për aktivitetet dhe të arriturat e tyre në këtë Qendër.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë dhe fushat ku mund të japë kontribut Qendra Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork.

Ata më pas përshëndeten dhe falënderuan Myftiun Tërnavë edhe pse nuk ishte prezent për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me Qendrën Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork.

## KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM DREJTORESHËN E SHOQATËS “AUTIZMI”, ZNJ. HATIXHE HOXHA

Më 13 gusht 2024, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim drejtoreshën e Shoqatës “AUTIZMI”, prof. dr. Hatixhe Hoxhën, nga e cila u njoh rreth punës së qendrës në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me autizëm, për sfidat me të cilat përballet kjo qendër dhe për mundësinë e bashkëpunimit reciprok.

Kryeimami Sahiti e përgëzoi znj. Hoxha për punën e Shoqatës, si dhe theksoi përkushtimin dhe gatishmërinë e Bashkësisë Islame të



Kosovës për të bashkëpunuar me fëmijëve me autizëm dhe familjarëve të tyre. Shoqatën e tyre, për t’u dalë në ndihmë të tyre.

## KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM DEKANIN E FAKULTETIT TË STUDIMEVE ISLAME TË SARAJEVËS, PROF. DR. MUSTAFA HASANI

Më 14 gusht 2024, kryeimami Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim dekanin e Fakultetit të Studimeve Islame në Sarajevë, prof. dr. Mustafa Hasani.

Kryeimami Sahiti pasi i shprehu mirëseardhje në selinë e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, e njohu dekanin Hasani për zhvillimin e jetës fetare dhe institucioneve fetare-arsimore të Bashkësisë Islame të Kosovës, Fakultetit të Studimeve Islame, Medresesë “Alauddin” me degët e saja, medreseve të hizfit të Kuranit, si dhe zhvillimin e mësim-besimit pranë xhamive në nivel vendi.

Dekani Hasani falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen e ngrohtë vëllazërore, ku më pas edhe përgëzoi Bashkësinë Islame për zhvillimin e jetës fetare e në veçanti zhvillimin e institucioneve fetare-arsimore në



Kosovë. Ai theksoi gatishmërinë e tij dhe të Fakultetit që drejton për avancimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve tona arsimore, si në shkëmbimin e përvojave, studentëve e profesorëve, po ashtu edhe për

zhvillimin e projekteve të përbashkëta hulumtuese me interes për dy vendet.

Vlen të theksohet se dekanin Mustafa Hasani është shqiptar me origjinë nga Kosova.

## KRYEIMAMI SAHITI MBËSHTETI FUSHATËN “FESTO ME ZEMËR, JO ME ARMË”

Më 20 gusht 2024, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në takimin e ftuar nga zëvendësministri i Brendshëm, respektivisht koordinatori Nacional për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta dhe Eksplozivëve, z. Blerim Gashani.

Ky takim u mbajt në kuadër të fushatës vetëdijësuese “Festo më zemër, jo me armë”, ku pjesë e takimit ishin edhe përfaqësues të bashkësive fetare të tjera në Kosovë. Kryeimami Sahiti, njoftoi të pranishmit mbi angazhimin dhe përkushtimin e

Bashkësisë Islame të Kosovës në vetëdijësimin e besimtarëve dhe qytetarëve për rrezikun e përdorimit të armëve përmes ligjëratave dhe këshillimeve fetare, të cilat i mbajnë imamët gjithandej vendit. Ai gjithashtu, gjatë



këtij takimi përgëzoi institucionet e vendit për realizimin e kësaj fushate.

Ndërkohë, zëvendësministri Gashani theksoi se takimi me bashkësitë fetare në këtë fushatë ka një rëndësi të veçantë, për kontributin që mund të japin në shpërndarjen e masazheve kyçe të

besimtarët e tyre, në mënyrë që të rritet vetëdija për rrezikun që vjen nga të shtënat festive, si dhe të ngritet numri i rasteve të raportimeve.

Fushata vetëdijësuese me moton “Festo me zemër, jo me armë”, ka për qëllim të reduktojë incidentet e

keqpërdorimit të AVL-ve, rritjen e kontrollit dhe parandalimin e të shtënave festive gjatë muajve të pushimeve verore dhe festimeve të fund vitit, keqpërdorimit të AVL-ve në dhunën në familje, dhunën në shkolla, etj..

### KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM PËRFAQËSUESET E ORGANIZATËS “SIT - QENDRA PËR KËSHILLIM, SHËRBIME SOCIALE DHE HULUMTIME”



Më 21 gusht 2024, kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim përfaqësueset e organizatës “SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime”, të kryesuar nga znj. Elma Berisha me bashkëpunëtore.

Në takim u diskutua për hulumtimin i cili po zhvillohet në kuadër të projektit “Këshillim për Parandalim” i përkrahur nga zyra e UNFPA-së në Kosovë, i cili për objekt hulumtimi,

studimi e analize ka fenomenin e dhunës me bazë gjinore.

Kryeimami Sahiti përgëzoi znj. Berisha dhe organizatën “SIT” për punën në hulumtimin dhe trajtimin e këtij fenomeni që po rëndon shoqërinë tonë, duke treguar edhe përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të luftuar këtë fenomen negativ përmes vetëdijesimit të besimtarëve nga ligjëratat, predikimet dhe këshillimet fetare. Një kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim do ta japë edhe Depar-

tamenti i Gruas, i cili me anë të teologeve të saja do të punojnë në luftën ndaj dhunës me bazë gjinore.

Bashkësia Islame e Kosovës shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me shoqërinë civile për të adresuar shkaqet e pasojat e dhunës në shoqërinë kosovare në përgjithësi e në veçanti të dhunës me bazë gjinore. Në këtë hulumtim do të integrohet edhe tema e rolit të fesë në parandalim të dhunës me bazë gjinore.

## KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM STUDENTËT E EKSELENCËS SË AKADEMISË STUDENTORE “BEŞIR AGA”

Më 23 gusht 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim studentët e ekselencës të Akademisë Studentore “Beşir Aga” të Myftinisë Fatih të Stambollit, të cilët qëndruan për një vizitë studimore në vendin tonë.

Studentët e Akademisë së Myftinisë Fatih, janë studentë të ekselencës të profileve të ndryshme të universiteteve më eminente të Stambollit. Kryeimami Sahiti pasi iu shprehu mirëseardhje, i njohu ata mbi organizimin e jetës fetare në Kosovë dhe institucioneve fetare-arsimore të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Studentët e akademisë gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë vizituan disa



qytete dhe kanë vizituar edhe monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë kulturore fetare në vendin tonë.

Gjatë vizitës studimore në Kosovë, studentët patën rastin të informohen

nga afër me aktivitetet e BIK-ut, si dhe jetën fetare e shoqërore në Kosovë. Akademia “Beşir Aga”, ka për qëllim që të vetëdijesojë elitën studentore me njohuri fetare.

## DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN, RIJAD EF. ALIUN

Më 6 gusht 2024, drejtori për Diasporë në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga kryeimami i BIK-ut, Vedat ef. Sahiti, pritën në takim Rijad ef. Aliu, imam në xhaminë “DITURIA” në Gjenevë të Zvicrës.

Gjatë këtij takimi, drejtori Simnica, fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit dhe më pas, shfrytëzoi rastin që ta njoh atë me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat Shqiptare Islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të Drejtorisë që ai drejton që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.



Nga ana e tij, imami Rijad ef. Aliu, fillimisht falënderoi për pritjen dhe më pas falënderoi drejtorin Simnica dhe kryeimamin Sahiti për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me xhaminë

“Dituria” në Gjenevë. Ai gjatë kësaj vizite, njoftoi për aktivitetet e tyre .

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për mundësitë dhe fushat ku mund të japë kontribut qendra islame shqiptare “Dituria” në Gjenevë.

## DREJTORI PËR DIASPORË PRITI NË TAKIM KRYETARIN E KMSHZ-SË, MEHAS EF. ALIJA

Më 6 gusht 2024, drejtori për Diasporë i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga kryeimami, Vedat ef. Sahiti, pritën në takim kryetarin e Komunitetit Mysliman Shqiptar të Zvicrës, njëherësh

imamin e xhamisë “El Hidaje”, Mehas ef. Alijan.

Drejtori Simnica e falënderoi z. Alijan për vizitën dhe për gjithë kontributin që janë duke dhënë ai dhe Komuniteti Mysliman Shqiptar në Zvicër për

mirëqenien e besimtarëve myslimanë shqiptarë atje. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të Drejtorisë që ai drejton që edhe më tej të vazhdohet dhe të intensifikohet bashkëpunimi ndërmjet këtyre dy institucioneve duke

vlerësuar lart angazhimin dhe punën e deritanishme të KMSHZ-së.

Nga ana e tij, kryetari Alija shprehu falënderimet e tij dhe të institucionit që ai drejton për bashkëpunimin dhe për ndihmën e ofruar nga Bashkësia Islame e Kosovës sa herë që është kërkuar një gjë e tillë.



### DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM IMAMIN FEHIM EF. ABAZIN

Më 12 gusht 2024, drejtori për Diasporë në Bashkësinë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga kryeimami i BIK-ut Vedat ef. Sahiti, pritën në takim Fehim ef. Abazi, nënkryetar i Komunitetit Mysliman Shqiptar në Zvicër, njëherësh imam në xhaminë “Qendra Shqiptare për Integrim, Kulturë dhe Religjion” në Lozanë të Zvicrës.

Gjatë këtij takimi, drejtori Simnica, fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit dhe më pas, shfrytëzoi rastin që ta njoh atë me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat shqiptare islame në diasporë. Ai edhe njëherë rikonfirmoi gatishmërinë e tij dhe të Drejtorisë që ai drejton që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë, aktualisht u bisedua me theks të veçantë rreth arritjes së një



memorandum bashkëpunimi në mes KMSHZ-së dhe BIK-ut.

Nga ana e tij, nënkryetari Abazi, fillimisht falënderoi për pritjen dhe më pas falënderoi drejtorin Simnica dhe kryeimamin Sahiti për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me KMSHZ-në dhe xhaminë “Qendra Shqiptare për

integrim, Kulturë dhe Religjion” në Lozanë të Zvicrës. Ai gjatë kësaj vizite, njoftoi për aktivitetet e tyre.

Drejtori për Diasporë, Ekrem ef. Simnica, shfrytëzoi nga rasti t’i dhuroi një komplet me libra dhe një fletëfalënderim në emrin e Qëndres së tyre në emër të ndihmës të grumbulluar me rastin e vitrave dhe kurbanit.

### U MBAJTËN GARAT E NJOHURIVE FETARE NË NIVEL VENDI

Më 24 gusht 2024, nën organizimin e Departamentit të Rinjve që funksionon në kuadër të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, në medresenë e mesme “Alauddin” në Prishtinë u mbajtën garat e njohurive fetare me nxënësit nga e gjithë Kosova.

Mbi 120 garues iu bashkuan kësaj gare për njohuritë e tyre në Kuran, Akid, Fikh dhe Histori Islame, ndërsa në fund fitues të kësaj gare u shpallën nxënësit nga Rahoveci, ndërsa vendin e dytë, respektivisht të tretin, e zunë nxënësit nga Prishtina dhe Ferizaji.

Kryeimami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, tha se për Bashkësinë Islame të Kosovës çështja e mësim-besimit është prioritet kryesor dhe nga puna me gjeneratat e reja varet edhe e ardhmja e Islamit në këtë vend.

Anëtar i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Burhan ef. Hashani,

tha se të rinjtë që po shpalosin dijen e tyre janë krenaria e çdo qyteti të Kosovës.

Gara e njohurive të përgjithshme fetare organizohet për vitin e dymbëdhjetë me radhë, ku marrin pjesë fëmijë nga i gjithë vendi, e të cilët më parë fitojnë në garat e nivelit komunal. Në fund të këtij organizimi, të gjithë garuesit morën mirënjohje, ndërsa fituesit u shpërblyen në mënyrë simbolike.



## IMAMËT KOSOVARË PJESË E TRAJNIMIT NJËJAVOR TË UNIONIT NDERKOMBËTAR TË DIJETARËVE MYSLIMANË



Nën organizimin e Unionit Ndërkombëtar të Dijetarëve Myslimanë me seli në Doha të Katarit dhe në marrëveshje me Bashkësinë Islame të Kosovës, njëzet imamë nga Kosova po marrin pjesë në Seminarin njëjavor të organizuar nga ky Union, i cili po mbahet në Stamboll të Turqisë.

Hapja e këtij Seminarit u bë të hënën, më 26 gusht 2024, gjatë së cilit prof. Hajredin ef. Hoxha, shpjegoi në pika të shkurtra programin e Seminarit, por edhe objektivat dhe synimet që ka Unioni Ndërkombëtar i Dijetarëve Myslimanë. Ai potencoi se prioritet i këtij Seminarit është ruajtja e frymës institucionale dhe respektimi i lider-

shipit fetar në vendet tona, për të cilat tha se Unioni këto vlera i ruan me një fanatizëm të madh.

Më pas, kryetari i Unionit të Dijetarëve Myslimanë, prof. dr. Ali Karadagi, mbajti një ligjëratë rreth konceptit të veçantë që ka ndërtuar me dekada jurisprudenca ekuilibruese (Fikhu el mizan), e për të cilën tha se ka qenë tejet e nevojshme, ngase keqkuptimet dhe keqinterpretimet e teksteve fetare ishin tejet të pranishme në mesin e besimtarëve.

Një ligjëratë që zgjoi kërkshërinë dhe interesin e të pranishmëve ishte edhe ajo e dr. Muhamed Ali Sallabit, i cili njëherësh është edhe zëvendëskryetar i

Unionit. Ai gjatë ligjërimit të tij theks të veçantë i kushtoi Kuranit, si burimi dhe referenca më e besueshme e dokumentimit të historisë njerëzore dhe jo vetëm. Ligjëratën e tij ai më pas e vazhdoi me tregimet e disa prej pejgamberëve të përmendur në Kuran, si dhe mësimet që nxjerrim nga jeta e tyre.

Imamët patën mundësi të dëgjojnë ligjëratat të ndryshme nga Kurani, tefsiri, fikhu, kultura dhe civilizimi, si dhe për kontributin e shqiptarëve myslimanë në komentimin e Kuranit.

Në këtë Seminar, përveç njëzetë imamëve nga Kosova, morën pjesë edhe dhjetë imamë nga Shqipëria, pesë nga Maqedonia e Veriut dhe tre nga Lugina e Preshevës.

## FYTYRA MË E BUKUR QË TOKA KA PARË

I erdhe botës si drita pas errësirës,  
në kohën kur e keqja, s'dallohej prej së mirës.  
I erdhe si shiu, pas diellit që përvëlon,  
erdhe dhe na e kumtove atë që shpirtrat qetëson.

Linde jetim e sa vështirësi ke kaluar,  
nuk u ndale dhe pse e dite se Xhenetin e ke të garantuar.  
Ti që shëmbëlltyrë për botën ke mbetur,  
shumë shekuj kaluan, e mësimet tua nuk janë tretur.

Sprovat tua të shumta kujtojmë,  
kur dhe ne nëpër sprova kalojmë.  
Eh sa selamet të dërgohen me lot në sy,  
ne nga e gjithë bota të pasojmë ty.

Shefatin tënd secili nga ne shpresë e ka,  
të kujtojmë me selavate ditë e natë pa ia nda.  
Me kënaqësi mësimet tua praktikojmë,  
sepse duam në Xhenetin Firdevs të takojmë.

Jemi ne ata për të cilët të lotuan ata sy,  
e kur të pyetën, iu ke thënë se qaj për të dashurit e mi.  
Vërtet nuk të kemi parë, po të duam me zemër,  
me shumë kënaqësi shqiptojmë më të bukurin emër.

Ti je Muhamed, më i dashuri i Allahut,  
sa me krenari thonë zemrat jemi pasues të Resulullahut.  
Nuk u takuam, por shpresojmë kurrë për të mos u ndarë,  
fytyra më e bukur që toka ka parë.

*Anita Gërguri*



**DITURIA ISLAME • Nr. 406 SHTATOR 2024**